



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Tepelenë

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë

të ushtruar në

BASHKINË TEPELENË

Tiranë, 2023

PËRMBAJTJA

SHKURTIME.....	3
I. PËRMbledhje Ekzekutive	4
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	4
2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore	4
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	18
II. Hyrje.....	21
1. Objekti i Auditimit.....	21
2. Qëllimi i auditimit.....	21
3. Identifikimi i çështjes.....	21
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	21
5. Përgjegjësitë e audituesve	22
6. Kriteret e vlerësimit	22
7. Standardet e auditimit	24
8. Metodat e auditimit	25
9. Dokumentimi i auditimit.....	26
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	27
1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Tepelenë	27
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	29
2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik	29
2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit	41
2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar.....	57
2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik	70
2.5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.....	89
2.6. Auditim mbi Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)	103
2.7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	107
2.8. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit	116
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	118
A. MASA ORGANIZATIVE	118
B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR	133
C. MASA DISIPLINORE	134
D. NJOFTIM PËR DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIN PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL	137

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditimi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet për një qeverisje të mirë, në përmbushje të objektivave të institucionit të Bashkisë Tepelenë dhe Ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga baza e të dhënave të thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 “paga”, 602 “shpenzime operative” dhe 230-231 “investime”, u audituan prokurimet publike të zhvilluara nga Bashkia Tepelenë nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022, etj.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 8 Akte Konstatimi dhe 2 Akte Verifikimi, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të audituar brenda afatit të përfundimit të auditimit.

2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2022 u konstatua se:</p> <p>a. Buxheti për vitin 2022 është realizuar 486,649 mijë lekë nga 512,088 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 95%. Në nivel zëri shpenzimesh me realizim më të ulët rezultoi zëri 602 “Shpenzime operative” në masën 89%, ndërsa zëri 230-231 “Shpenzime për investime”, pavarësisht se është realizuar si fonde në masën 93% në nivel projektesh nga 19 projekte të planifikuara nuk janë prokuruar, kontraktuar dhe realizuar 4 projekte investimesh.</p> <p>b. Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën 26,173,384 lekë ose në masën 6.94% të shpenzimeve të planifikuara, të cilat janë ulur krahasuar me fundvitin 2021, që ishin në shumë të konsiderueshme prej 39,180,517 lekë. Detyrimet e krijuara vetëm në vitin 2022 janë në vlerën 1,205,133 lekë. Detyrimet e papaguara rakordojnë me raportimin në MFE të vitit 2022, ndërsa me gjendjen prej 28,229,661 lekë të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të bilancit të vitit 2022 nuk rakordon për shumën 2,056,277 lekë, diferencë që përfaqëson detyrimet ndaj të treteve të krijuara në dhjetor të vitit ushtrimor 2022, që nuk u ka kaluar afati 30 ditor i pagesës.</p> <p>c. Gjithashtu konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën më të madhe prej 88.7% nga Buxheti i Shtetit (transferata e pakushtëzuar dhe transferata e kushtëzuar e transferata specifike) dhe 11.3% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifatat vendore</p>	<p>Pika 2.2., faqe 42-58</p>	E lartë	<p>Strukturat drejtuese të Bashkisë Tepelenë, nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe në bashkëpunim me Menaxherët e Programeve, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent të jenë sa më të argumentuara, si dhe të kujdesen për realizimin e projekteve të investimeve të planifikuara. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të palikuiduara të prapambetura dhe të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat që siguron njëzia vendore nga burime të tjera.</p> <p>Sa më sipër, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 43, paragrafi 4, nenet 47, 48, 52; Ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 40, germa h, neni 42; UMFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3.</p>			
2	<p>Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, u konstatua se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Vlera progresive e detyrimit që subjektet e biznesit dhe familjarët debitorë kanë ndaj Bashkisë Tepelenë për taksat dhe tarifavat vendore në datën 31.12.2021 është 17,431,036 lekë. Vlera e këtij detyrimi e krijuar vetëm gjatë vitit 2022 është 1,733,167 lekë. Në mënyrë progresive gjendja e debitorëve më 31.12.2022 ka vlerën 20,381,313 lekë, e përbërë nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Taksa e Tarifa vendore për Biznesin e Vogël në vlerën 8,836,111 lekë; - Taksa e Tarifa vendore për Biznesin e Madh në vlerën 10,922,734 lekë; - Taksa e Tarifa vendore për Institucione Shtetërore në vlerën 622,468 lekë. <p>Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.3, neni 35, Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106, “Për sistemin e taksave vendore”, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreu XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 89, 90, 91, 93 dhe 94, Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshime, neni 181, etj.</p>	Pika 2.2., faqe 42-58	E lartë	<p>Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Tepelenë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifavat vendore në fund të vitit 2022, në vlerën 20,381,313 lekë.</p> <p>Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Tepelenë, për moskalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë.</p> <p>Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.</p>
3	<p>Në Bashkinë Tepelenë aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, por nuk është hartuar regjistri i taksapaguesve familjarë. Sektori i Tatimeve nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e</p>	Pika 2.2., faqe 42-58	E lartë	<p>Bashkia Tepelenë nëpërmjet Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe NJA, të marrë masa për krijimin e regjistrat të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e kategorisë “familjare” me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>pritsmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve, që janë debitore ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet nuk ngarkohen për taksat dhe tarifatat e tjera vendore të miratuara me VKB, si taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifa e gjelbërimit. Bashkia Tepelenë ka si Agjent Tatimor për arkëtimin e tarifës së pastrimit dhe taksën e ndërtesës ShA Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë, e cila sipas aktrakordimit me Bashkinë Tepelenë për të ardhurat, rezulton se deri në fund të vitit 2022 ka mbetur pa u derdhur Bashkisë vlerën progresive prej 16,397,158 lekë nga vlera e deklaruar e maturimit prej 18,091,147 lekë. Ndërsa vetëm për vitin 2022 nga ShA Ujësjellës Kanalizime Tepelenë janë arkëtuar detyrime për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit në vlerën 4,169,582 lekë, e cila nuk është derdhur për llogari të Bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr. 74, datë 28.12.2018, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tepelenë” i ndryshuar, me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117.</p>			<p>për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore, që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të Bashkisë Tepelenë. Bashkia Tepelenë, bazuar në kontratën dypalëshe me agjentin tatimor UK Tepelenë SHA, të kërkojë prej këtij të fundit xhirimin e vlerës 16,397,158 lekë, në llogarinë përkatëse në degën e thesarit.</p>
4	<p>Nga auditimi u konstatua se taksa mbi tokën bujqësore është realizuar në vlerën 566 mijë lekë nga 721 mijë lekë e planifikuar ose në masën 78%. Për taksën mbi tokën bujqësore nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta për planifikimin e saj mbi baza reale. Në Bashkinë Tepelenë, familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore si dhe Sektori i Tatimeve nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve, që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqen e tokës bujqësore, që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet edhe kjo taksë. Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore, janë rastet kur qytetarët paraqiten në bashki në mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifatat vendore apo për të marrë shërbime, ku nga Sektori i Taksave dhe Tarifave ju mbahet edhe taksa e tokës me vlerë 1,100 lekë/ha/vit për tokë të kategorisë VII-X. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, Aneksi 1 dhe VKB nr. 74 datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, pika 4/4.</p>	<p>Pika 2.2., faqe 42-58</p>	E lartë	<p>Bashkia Tepelenë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë, të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve, referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Tepelenë.</p>
5	<p>Nga auditimi i dokumentacionit financiar të pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga</p>	<p>Pika 2.2.,</p>	E lartë	<p>Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Tepelenë të</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>legalizimet, rezulton se në Bashkinë Tepelenë ka detyrime të papaguara për objekte, të legalizuara që nga viti 2015 deri në 31.12.2021, në vlerën 1,942,139 lekë për 64 objekte. Nga korespondenca zyrtare e Bashkisë Tepelenë me ASHK për periudhën objekt auditimi, rezultoi se për vitin 2022 janë kryer 15 legalizime me vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë të përlllogaritur 545,206 lekë, ku janë debitorë 6 individë në vlerën 136,798 lekë, ndërsa deri në 31.12.2022 vlera progresive debitore për këtë taksë është 2,078,937 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, VKB nr. 74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, pika 2/b.</p>	<p>faqe 42-58</p>		<p>dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 70 debitorë në vlerën 10,620,347 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Tepelenë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen, si dhe të bëhen marrëveshje për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.</p>
6	<p>Bashkia Tepelenë për administrimin e asetëve në pronësi apo në përdorimin dhe krijimin e të ardhurave prej tyre, ka lidhur 30 kontrata për dhënien me qira të tyre. Nga të dhënat e nxjerra nga dokumentacioni i dosjeve dhe ai financiar, rezulton se në fund të vitit 2022 paraqiten 16 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në vlerën 3,708,676 lekë të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë. Detyrimi i krjuar i papaguar vetëm për vitin 2022 është 2,874,456 lekë. Gjithashtu, për qiramarrësit debitorë nuk janë përlllogaritur dhe nuk janë aplikuar kamatëvonesa prej 0.01% për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës. Nga strukturat e Bashkisë nuk janë kryer veprime të mjaftueshme për evidentimin e problematikave dhe ndërmarrjen e hapave për negociime me qiramarrësit debitorë për pagesat me këste apo marrjen e masave për anulimin e kontratave. Këto veprime janë në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enftëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkëtesë, neni 5 “Pagesa e tarifës së qirasë”.</p>	<p>Pika 2.2., faqe 42-58</p>	E lartë	<p>Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Tepelenë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës 3,708,676 lekë (principal dhe kamatëvonesa), e cila lind nga mospagesa e kontratave të qirasë për 16 subjekte qiramarrës, referuar kushteve të kontratave.</p>
7	<p>Nga auditimi, rezultoi se Bashkia Tepelenë ka</p>	<p>Pika</p>	E lartë	<p>Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>pajisur rast pas rasti me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitetet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe ka hartuar akt marrëveshje me to lidhur me pagesën e detyrimit për autorizimin. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Në territorin e Bashkisë Tepelenë për periudhën objekt auditimi kanë ushtuar aktivitetet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 6 subjekte nga të cilat 4 subjekte konstatohet se kanë detyrime të papaguara në vlerën 2,280,000 lekë, ku në 3 raste nuk kanë paguar në vlerë të plotë detyrimin e përcaktuar në dispozitat ligjore dhe në 1 rast (subjekti B. ShPK) nuk është pajisur me autorizim. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, nenet 4, 15 dhe 20 pikat 2 dhe 11 dhe me VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, Kreu II, pika 3.</p>	<p>2.2., faqe 42-58</p>		<p>Urbanistikës në Bashkinë Tepelenë të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitore për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 70 debitore në vlerën 10,620,347 lekë, si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Tepelenë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.</p>
8	<p>Gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se ka kontrata që kanë përfunduar si punime, por likuidimi është shtrirë në 2-3 vite ushtrimore, për të cilat janë kryer pagesa pjesore sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Nga auditimi i kontabilizimeve të veprimeve ekonomike për kontratat e investimeve me shtrirje kohore likuidimi përtej vitit ushtrimor, rezulton se llogaria 231 “Shpenzime për investime në proces” është debituar dhe kredituar për vlera pjesore të paguara, duke e mbyllur këtë llogari në mënyrë të gabuar pa u kapitalizuar aktivi deri në vlerë të plotë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, pasi në fund të vitit 2022, konstatohet se 11 kontrata investimesh kanë mbetur pa u financuar për vlerën 190,841,000 lekë, ndërsa vlera pjesore prej 245,018,000 lekë e financuar për këto projekte, duhet t’i përkiste gjendjes debitore të llogarisë 231 “Shpenzime për investime në proces”, në datën 31.12.2022.</p> <p>Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Aneksi 1, Pika 2, Klasa 2, si dhe Kreu I, pika 8, Kreu II, pika 15/a, b, c, 18/a,</p>	<p>Pika 2.3., faqe 58-71</p>	E lartë	<p>Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë, të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet t’i evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	b, Kreu III, pika 32.			
9	Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 111,655,654 lekë, e cila nuk rakordon për vlerën 898,083 lekë me gjendjen e debitorëve në llogaritë e klasës 4 në aktiv të bilancit në vlerën 110,757,571 lekë. Vlera prej 898,083 lekë nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson dhe i ka fillësat që në konsolidimin e PF të Bashkisë me Ish-Komunat nga Reforma administrative territoriale. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu II, pika 15/b, 59/a, Kreu III, pika 32, Aneksi 1, pika 3.3., “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”, nënpika 8.	Pika 2.3., faqe 58-71	E lartë	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë, të shqyrtojë veprimet kontabël të kryera në librat e kontabilitetit, për nxjerrjen e shkakut të deviacionit në vlerën 898,083 lekë të veprimeve ekonomike të ndodhura me debitorët në vite dhe më pas të kryhen sistemit e nevojshme në kontabilitet në llogaritë e klasës 4, duke i reflektuar përfundimisht në pasqyrat financiare të vitit 2023.
10	Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se, në 99 raste në vlerën 30,089,049 lekë, janë kryer pagesa të faturave për mallra, punë apo shërbime jashtë afatit 30 ditor nga momenti i mbërritjes së faturës, ku për 92 raste në vlerën 24,718,349 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura mallrash dhe shërbimesh në llogarinë 602 “Shpenzime operative” dhe në 7 raste në vlerën 5,370,700 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për investime në llogarinë 231 “Investime”, të cilat në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mbërritje me vonesë e faturave apo realizim me vonesë i punimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52 dhe Ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 44 “Kontrolli i shpenzimeve”.	Pika 2.3., faqe 58-71	E lartë	Bashkia Tepelenë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përfshijë kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim moskrijim borxhi për fatura të palikuiduara dhe krijimin e vështirësisë në aftësinë paguese.
11	Nga auditimi, u konstatua se gjatë vitit 2022 janë realizuar gjithsej 72 procedura prokurimi me fond limit 70,669.4 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 63,149 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 7,520.4 mijë lekë ose 10.6%. Këto procedura prokurimi kanë qenë të llojit: 1 procedurë “e hapur”, 4 procedura “e hapur e thjeshtuar” dhe 68 procedura “blerje e vogël”. Sipas llojit të aktivitetit, u konstatua se në fushën e ndërtimit (investime), është 1 procedurë me fond limit 13,122 mijë lekë ose 18.6% e kontratave të lidhura dhe kjo me fonde të deleguara nga buxheti i shtetit. Referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditimit vlerësoi për auditim 5	Pika 2.4., faqe 71-90	E lartë	Kryetari i Bashkisë Tepelenë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen e OE fitues të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për realizimin me sukses të kontratës.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>procedurat e llojit “e hapur” dhe “e hapur e thjeshtuar” dhe 6 procedura të llojit “Blerje e vogël”.</p> <p>1. Nga auditimi i 5 procedurave të llojit “e hapur” dhe “e hapur e thjeshtuar”, të zhvilluara gjatë vitit 2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar.</p> <p>2. Nga auditimi i procedurave si më sipër, janë konstatuar në shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, gjithsej në 3 procedura, ku OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DT të miratuara nga AK, në vlerën 23,910,718 lekë pa TVSH, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3 dhe neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.</p>			
12	<p>Nga auditimi, u konstatua se leja e ndërtimit për objektin “Strukturë akomoduese në funksion të turizmit”, miratuar me vendimin nr. LNM 311221, datë 14.02.2022, me zhvillues “E.Z.” ShPK, në qendër të qytetit Tepelenë, është miratuar pa miratuar më parë një leje zhvillimi për ndërtimin e një objekti të ri dhe në përputhje me parametrat urbanë të lejuar. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për “Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 38, “Leja e zhvillimit”, VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 9, “Leja e zhvillimit”, pika 1 dhe neni 14, “Kushtet për lëshimin e lejes së ndërtimit”, pika 1.</p>	Pika 2.5., faqe 90-104	E lartë	Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa miratuar më parë lejen e zhvillimit dhe përcaktimin e kushteve zhvillimore.
13	<p>Nga auditimi i dokumentacionit për objektin “Shtëpiza druri, kotec dhe ambiente për turizëm rural”, për të cilën është marrë vendimi nr. LZH260422 për leje zhvillimi, datë 10.06.2022 dhe vendimi për deklaratën paraprake nr. DP011222, datë 02.12.2022, me zhvillues A.R., në fshatin Rexhinë, Tepelenë, u konstatua se:</p> <p>- Leja e zhvillimit nuk është në përputhje me kushtet bazë të kontratës së marrë me qera për zhvillimin e parcelës, pasi parcela mbi të cilën është miratuar leja e zhvillimit është pasuri shtetërore në përdorim të bashkisë, me statusin arë. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar, VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës</p>	Pika 2.5., faqe 90-104	E lartë	<p>1. Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të ruajtur dhe mbrojtur tokën bujqësore nga ndërtimet që nuk janë në përputhshmëri me kushtet e kontratës dhe planin e biznesit të miratuar në dhënien me qera të tokës bujqësore të pandarë.</p> <p>2. Pas miratimit të lejes së zhvillimit, DPZHT Tepelenë të marrë masa për të vijuar me ndjekjen e fazave të tjera për aplikimin e lejes së ndërtimit dhe të mos miratojë deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve për objekte të cilat nuk përfshihen në këtë kategori aplikimi.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><i>tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit</i>”, në kushtet e kontratës tip për dhënien me qera të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, neni 2, pika vi.</p> <p>- Pas miratimit të lejes së zhvillimit është aplikuar për deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “<i>Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit</i>”, i ndryshuar, neni 39, “<i>Lejet e ndërtimit</i>”, VKM-në 408, datë 13.5.2015, “<i>Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit</i>”, i ndryshuar, Neni 11, “<i>Lejet e ndërtimit</i>” dhe neni 7, “<i>Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh</i>”.</p>			
14	<p>Nga auditimi, u konstatua se për objektet e mëposhtme nuk janë respektuar distancat ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës sipas kriteve të Rregullores së Zhvillimit të Territorit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. “<i>Strukturë akomoduese në funksion të turizmit</i>”, për të cilën është marrë vendimi nr. LNM 311221, datë 14.02.2022, me zhvillues “E.Z.” ShPK, në qendër të qytetit Tepelenë. 2. “<i>Banesë dy katëshe + një kat podrum në Progonat, Tepelenë</i>”, për të cilën është marrë vendimi nr. AQ-LN100622, datë 21.11.2022, me zhvillues A.Q., në Progonat, Tepelenë. 3. “<i>Bujtinë 2 kate + 1 kat nëntokë</i>”, për të cilën është miratuar çertifikata e përdorimit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues “G.A.” ShPK, në fshatin Dukaj, Tepelenë. 4. “<i>Objekt katër kate, me dy kate nën tokë, me destinacion bar-restorant dhe hoteleri</i>”, për të cilën është miratuar çertifikata e përdorimit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues B.I.H., në zonën e Ujit të ftohtë, Tepelenë. <p>Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “<i>Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit</i>”, i ndryshuar, Neni 35, “<i>Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës</i>”.</p>	Pika 2.5., faqe 90-104	E lartë	Nga DPZHT Tepelenë të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.
15	<p>Nga auditimi, u konstatua se për objektet e mëposhtme në planvendosje dhe në lejen e ndërtimit të miratuar, nuk pasqyrohej saktë numri i kateve dhe lartësia e objektit sipas projektit të ndërtimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. “<i>Banesë dy katëshe + një kat podrum në Progonat, Tepelenë</i>”, për të cilën është marrë vendimi nr. AQ-LN100622, datë 21.11.2022, me zhvillues A.Q., në Progonat, Tepelenë. 2. “<i>Bujtinë 2 kate + 1 kat nëntokë</i>”, për të cilën është miratuar çertifikata e përdorimit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues “G.A.” ShPK, në fshatin Dukaj, Tepelenë. 	Pika 2.5., faqe 90-104	E lartë	Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje të dhënat e paraqitura në planvendosje, në mënyrë që të jenë në përputhje me projektin e ndërtimit dhe të përcaktohet saktë lartësia dhe numri i kateve të objektit.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>3. “Objekt katër kate, me dy kate nën tokë, me destinacion bar-restorant dhe hoteleri”, për të cilën është miratuar çertifikata e përdorimit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues B.I.H., në zonën e ujit të ftohtë, Tepelenë. Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM-në datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 37, “Lartësia e ndërtimeve”.</p>			
16	<p>Nga auditimi i dokumentacionit për objektin “Banesë dy katëshe + një kat podrum në Progonat, Tepelenë”, për të cilën është marrë vendimi nr. AQ-LN100622, datë 21.11.2022, me zhvillues A.Q., në Progonat, Tepelenë u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leja e ndërtimit është miratuar në kategorinë për objekte deri në 250 m², duke shmangur e thjeshtësuar disa kriteret të tjera të cilat duhet të plotësohen për miratimin e lejes së ndërtimit sipas legjisllacionit në fuqi. Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 15, “Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi”. - Pas miratimit të lejes së ndërtimit dhe nga evidentimi në terren, u evidentua se objekti është ndërtuar pa deklaruar njoftim për fillim punimesh dhe është vënë në përdorim pa u pajisur me çertifikatë përdorimi. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 50, neni 51, “Inspektimi”, neni 52, pika g dhe f, “Përdorimi i objektit pa lëshimin e çertifikatës së përdorimit”, VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/2, “Mbikëqyrja e punimeve” dhe Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5, “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, neni 12, “Ushtrimi i kontrollit”. 	Pika 2.5., faqe 90-104 2.6., faqe 104-109	E lartë	<p>1. Pas miratimit të lejes së ndërtimit DPZHT Tepelenë të marrë masa për të zhvilluar mbikëqyrjen e punimeve dhe verifikime në terren të ndërtimit të objektit, për të verifikuar mbajtjen e akteve të kontrollit dhe të mos lejohet përdorimin e objekti pa u pajisur me çertifikatë përdorimi.</p> <p>2. Nga IVMT Tepelenë të merren masa për të zhvilluar kontrole të vazhdueshme në terren dhe të verifikojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe moslejimin e përdorimit të objektit pa u pajisur me çertifikatë përdorimi.</p>
17	<p>Nga auditimi, u konstatua se për objektin “Bujtinë 2 kate + 1 kat nëntokë”, për të cilën është miratuar çertifikata e përdorimit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues “G.A.” ShPK, në fshatin Dukaj, Tepelenë, në bazë të lejes së ndërtimit të miratuar me Vendimin nr. LN220720, datë 07.10.2020 dhe ndryshuar me Vendimin nr. LNP290521, datë 08.06.2021, Leja e parë e ndërtimit është miratuar për realizimin e një objekti me funksionin e bujtinës në lartësinë e dy kateve dhe 1 kati nëntokë. Pas fillimit të punimeve të ndërtimit është aplikuar për ndryshim projekti. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 42, “Çertifikata e</p>	Pika 2.5., faqe 90-104	E lartë	<p>Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të mos pajisur me çertifikatë përdorimi dhe miratuar ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit pa verifikuar më parë masën e ndryshimit të sipërfaqeve ndërtimore në projekt dhe duke verifikuar realizimin e zbatimit të punimeve në përputhje me projektin e ndërtimit të miratuar.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<i>përdorimit</i> ”, VKM-në 408, datë 13.5.2015, “ <i>Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit</i> ”, i ndryshuar, neni 17, pika e dhe nenet 27 dhe 27/1.			
18	Nga auditimi, u konstatua se për objektin “ <i>Objekt katër kate, me dy kate nën tokë, me destinacion bar-restorant dhe hoteleri</i> ”, për të cilin çertifikata e përdorimit është miratuar pas realizimit të sistemimit të jashtëm të objektit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues B.I.H., në zonën e Ujit të ftohtë, Tepelenë, në planvendosjen e miratuar në lejen e ndërtimit nuk pasqyrohet mënyra e aksesit në parcelën që është zhvilluar ndërtimi. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “ <i>Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit</i> ”, i ndryshuar, neni 42, “ <i>Çertifikata e përdorimit</i> ”, Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “ <i>Për pyjet</i> ”, neni 12, VKM-në 408, datë 13.5.2015, “ <i>Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit</i> ”, neni 27/1, pika 1, gërma dh, “ <i>Përfundimi i sistemimit të jashtëm</i> ”, neni 14, pika 2.	<i>Pika 2.5., faqe 90-104</i>	E lartë	Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të mos pajisur me çertifikatë përdorimi dhe miratuar leje ndërtimi pa konfirmuar më parë mënyrën e aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimi.
19	Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga drejtoria e burimeve njerëzore të Bashkisë Tepelenë, z. E.L., me pozicion inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, ka përfunduar arsimin e lartë ushtarak dhe nuk ka kualifikimin e duhur për pozicionin e punës, jo në përputhje me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “ <i>Për inspektimin e ndërtimit</i> ”, i ndryshuar me Ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014, neni 11.	<i>Pika 2.5., faqe 90-104</i>	E lartë	Nga Bashkisë Tepelenë të merren masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
20	Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga drejtoria e burimeve njerëzore të Bashkisë Tepelenë, në pozicionin e kryeinspektorit të IVMT-së është komanduar nga Kryetari i Bashkisë, për periudhën 31.01.2022-31.12.2022, z. G.M. i punësuar me kohë të plotë pranë Këshillit të Qarkut. Ushtrimi i detyrës si kryeinspektor, pa lidhur kontratën e punës për ushtrimin e detyrës së përcaktuar, nuk është në përputhje me Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 12, “ <i>Kontrata e punës</i> ”.	<i>Pika 2.5., faqe 90-104</i>	E lartë	Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për të lidhur kontratat e punës me punonjësit përpara ushtrimit të detyrës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
21	Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga IVMT-ja Tepelenë, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, nuk janë marrë vendime për prishje të ndërtimeve të cilat nuk janë pajisur me leje ndërtimi. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në Bashkinë Tepelenë nuk ka plotësuar detyrat funksionale, në mospërputhje me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “ <i>Për inspektimin e ndërtimit</i> ”, i ndryshuar, neni 5, “ <i>Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës</i> ”, neni 12, “ <i>Ushtrimi i kontrollit</i> ” dhe Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “ <i>Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit</i> ”, neni 51, “ <i>Inspektimi</i> ”.	<i>Pika 2.5., faqe 90-104</i>	E lartë	Nga IVMT të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren për të konstatuar ndërtimet informale dhe ato që nuk janë në përputhje me lejet e ndërtimit të miratuara, duke marrë vendime për prishje dhe duke i ekzekutuar ato, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
22	<p>Në bazë të verifikimeve për realizimin në terren të zhvillimit të territorit, u konstatuan 4 objekte të cilat janë ndërtuar pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklarata paraprake punimesh. Sa më sipër, është në mospërputhje me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, “Inspektimi”, Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5, “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, neni 12, “Ushtrimi i kontrollit”.</p>	<p>Pika 2.6., faqe 104-109</p>	<p>E lartë</p>	<p>Nga IVMT Tepelenë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi.</p>
23	<p>Në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronjat “a” dhe “b”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pazbatuara, për të cilat Bashkia Tepelenë ka detyrim zbatimin e tyre.</p> <p>Nga KLSH janë lënë gjithsej 24 rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht dhe ecuria e zbatimit të tyre është si më poshtë:</p> <p>a. 16 “Masa Organizative”, nga të cilat 7 masa janë në proces zbatimi, 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 8 masa janë pa zbatuar;</p> <p>b. 2 “Masa për shpërblim dëm”, në vlerën 438,362 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht dhe janë zbatuar.</p> <p>c. 6 “Masa për eliminimin e efekteve negative të shkaktuara në administrimin e fondeve publike në përputhje me parimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit”, në vlerën 6,171,030 lekë, nga të cilat 1 masa është zbatuar pjesërisht, për vlerën 580,000 dhe 5 masa janë pa zbatuar;</p> <p>d. Masa disiplinore, të cilat janë lënë në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë, i cili ka nxjerrë urdhërin nr. 43 prot., datë 02.03.2023 “Për ngritje të Komisionit të disiplinës”. Nga auditimi rezulton se nuk ka marë asnjë masë tjetër sipas parashikimeve të rekomandimit.</p> <p>Për punonjësit e atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të cilët vlerësohen për masa disiplinore, është lënë detyrë njoftimi i Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Për shkak të mosmarrjes së masave, këto institucione nuk janë njoftuar.</p>	<p>Pika 2.7., faqe 109-117</p>	<p>E lartë</p>	<p>Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkohet marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces.</p>
24	<p>Nga auditimi, u konstatua se për objektin “Strukturë akomoduese në funksion të turizmit”, për të cilën është marrë vendimi nr. LNM 311221, datë 14.02.2022, me zhvillues “E.Z.” ShPK, në qendër të qytetit, Tepelenë, metodologjia e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është e saktë, duke sjellë që kjo taksë të llogaritet më pak në vlerën</p>	<p>Pika 2.5., faqe 90-104</p>	<p>E lartë</p>	<p>Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 188,311 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë, si pasojë e përllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	188,311 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, Ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 46, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”.			
25	<p>Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm, u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:</p> <p><u>Mjedisi i kontrollit:</u> Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga auditimi rezulton se GMS nuk ka kryer detyrat si: Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e komisioneve të përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë, në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.</p> <p><u>Menaxhimi i Riskut:</u> Mungon Urdhëri për përcaktimin e grupit të punës për riskun. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë në arritjen e objektivave dhe pengojnë marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.</p> <p>Për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe të vendoset kuadri i përgjithshëm i procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.</p>	Pika 2.1., faqe 30-42	E mesme	Nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, me atributet e Kryetarit të GMS, si dhe Nëpunësit Autorizues dhe Koordinatorit të Riskut, të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryhen investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryhen procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimesh për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherë të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Të vendoset një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><u>Aktivitetet e Kontrollit:</u> Bashkia Tepelenë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (<i>back-up</i>) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të IT si instalimin e softuerit, programimin e testimit etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të IT të miratuar nga Kryetari, si dhe nuk ka qenë fushë drejtimi auditimi nga AB.</p> <p>Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.</p> <p>Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsisë, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme.</p> <p><u>Informimi dhe komunikimi:</u> Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë.</p> <p>Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Nga Bashkia Tepelenë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por mungon dokumentimi i konsultimit publik.</p> <p><u>Monitorimi:</u> Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Në Bashkinë Tepelenë aktivitetet e vlerësimit të njësive janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualin e MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë</p>			

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	17.11.2016.			
26	<p>Nga auditimi u konstatua se struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk është e plotë, pasi aktualisht funksionon me një auditues/përgjegjës sektori.</p> <p>Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga NjAB, u konstatua se anekset “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “Vetëvlerësimi periodik” nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve në pikën 7.1.1. të Kapitullit VII të MAB, si dhe mungon komponenti i tretë “Reagimet e subjektit të audituar”. Pyetëtori i reagimit ndaj angazhimit nuk i është dërguar zyrtarisht subjekteve të audituara me dërgimin e Raportit Përfundimtar, kështu që pyetëtori nuk është kthyer i plotësuar dhe nuk gjendet si pjesë e inventarit të çdo dosjeje.</p> <p>Në programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë, nuk janë përcaktuar indikatorët e matjes së performancës, gjë që ka pamundësuar hartimin e raporteve specifike të vlerësimit të performancës dhe si rrjedhim adresimin e rekomandimeve për përmirësim, duke munguar raportimi tek Titullari për këtë procedurë.</p> <p>Në raportet e auditimit duhet të zinte më shumë vend analizimi i secilit komponent të kontrollit të brendshëm për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të qenë më të qarta rekomandimet për të ardhmen dhe të përfshihej opinioni i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm (referuar dosjeve të shqyrtuara). Audituesit e Brendshëm nuk kanë dhënë asnjë opinion mbi funksionimin dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe nuk kanë kryer vlerësimin dhe analizën e riskut për fushat e veprimtarisë së institucionit, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projektraportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim).</p> <p>Në shumicën e rasteve rekomandimet e dhëna i referohen bazës ligjore, pra “në zbatim të akteve ligjore”, duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem. Për rekomandimet e adresuara nuk ka përcaktuar afatin e zbatimit të tyre dhe nivelin e rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët).</p> <p>Nuk dokumentohet që NjAB, pas përfundimit të çdo angazhimi të auditimit, të ketë njoftuar zyrtarisht subjektin e audituar për reagimin ndaj projekt rekomandimeve të adresuara, konform detyrimit të përcaktuar në pikën 4.1.12 të MAB. Në formulimin e gjetjeve ka mangësi, pasi në të shumtën e rasteve situata e përshkruar nuk ka të përcaktuar periudhën e</p>	Pika 2.1., faqe 30-42	E mesme	Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të merren masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse t’i jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. Nga kryetari i Bashkisë Tepelenë, të merren masa për të plotësuar strukturën e sektorit të auditimit të brendshëm.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>audituar, kujt viti i referohet, si dhe nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i mospërputhshmërisë apo standardet e kontabilitetit për problematikën e konstatuar nga auditimi, në kundërshtim me pikën 2.4.1 “<i>Auditimi i përputhshmërisë</i>” dhe 2.4.2. Mbulimi me auditim i aktivitetit të Bashkisë Tepelenë është i pamjaftueshëm vetëm me një punonjës në strukturën e kësaj drejtorie dhe si për pasojë puna e bërë nuk arrin rezultatet e duhura.</p> <p>Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, të tilla si prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, asetet, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të Ligjit nr. 114/2015 “<i>Për auditimin e brendshëm në sektorin publik</i>”.</p> <p>Sa më sipër, është në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “<i>Për auditimin e brendshëm në sektorin publik</i>”, të MAB të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të MF “<i>Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik</i>”, kapitulli IV, pika 4.1.1 “<i>Planifikimi i një angazhimi auditimi</i>”, kapitulli VI “<i>Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese</i>”, pika 6.1.</p>			

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

I. Opinioni i Pamodifikuar me theksim të çështjes, mbi pasqyrat financiare:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të Bashkisë Tepelenë, për periudhën ushtrimore 01.01.2022-31.12.2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një **opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Tepelenë, duke arritur në përfundimin se, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “*Bazës për Opinionin e Pamodifikuar*”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale (pa anomali materiale), pozitën financiare të njësisë vendore më 31 dhjetor 2022, në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes, janë adresuar disa çështje (jo thelbësore), të cilat paraqiten te paragrafi “*Theksimi i çështjes*” dhe duhet të jenë në vëmendje të njësisë vendore për sistemimin e tyre.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik” apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 “Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare, Udhëzues për SAI-n”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2022 ka marrë në konsideratë vlerën e materialitetit 5,731 mijë lekë për shpenzimet dhe 847 mijë lekë për të ardhurat.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2022 kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, fakt ky që përbën bazën për opinion (ISA-705; ISSAI-1705). Këto aspekte nuk konsiderohen materiale, prandaj vetëm meritojnë evidentim, si theksim çështjesh. Për këto arsye kemi dhënë opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në paragrafin e mëposhtëm:

Theksimi i çështjes:

1. Gjendja e llogarisë 231, “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 0, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se ka 11 kontrata projektsh që kanë mbetur pa u financuar plotësisht, pavarësisht se kanë përfunduar si punime, por likuidimi është shtrirë në 2-3 vite ushtrimore, për të cilat janë kryer pagesa pjesore në vlerën 245,018,000 lekë sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Kjo vlerë duhet ti përkiste gjendjes debitore të llogarisë 231 “Shpenzime për investime në proces” në datën 31.12.2022.

2. Gjendja e llogarisë 4341, “Operacione me shtetin (detyrime)”, paraqitet si në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 111,655,654 lekë, e cila nuk rakordon për vlerën 898,083 lekë me gjendjen e debitorëve në llogaritë e klasës 4 në aktiv të bilancit në vlerën 110,757,571 lekë. Vlera prej 898,083 lekë nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson dhe i ka fillesat që në konsolidimin e PF të Bashkisë me ish-Komunat nga Reforma Administrative Territoriale.

II. Opinion i Modifikuar për përputhshmërinë:

Në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Tepelenë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Tepelenë, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Tepelenë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinionin mbi përputhshmërinë”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar për përputhshmërinë.

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë:

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e

përshatshme¹ për të dhënë një bazë për opinionin tonë, (ISSAI 400 & ISSAI 4000) si më poshtë:

1. Nga auditimi i procedurave të prokurimeve publike të llojit “e hapur” dhe “e hapur e thjeshtuar”, të zhvilluara gjatë vitit 2022, janë konstatuar mangësi të cilat lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, pasi në 5 raste janë vendosur kritere të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën, objektin e prokurimit dhe madhësinë e kontratës.
2. Nga auditimi i procedurave si më sipër, janë konstatuar në shkëlqje të LPP dhe akteve nënligjore, gjithsej në 3 procedura, ku OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DT të miratuara nga AK, në vlerën 23,910,718 lekë pa TVSH.
3. Nga auditimi, u konstatua se në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, në një rast taksa e ndikimit në infrastrukturë është përlloritur më pak në vlerën 188,311 lekë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Tepelenë:

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të Njësitve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik në një auditim financiar lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie, është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të japë opinion për këtë.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe këto çështje përshkruhen në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

¹ ISA 500-ISSAI 1500, ku cilësohet se: “Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mund të sigurojë evidence auditimi të mjaftueshme, të përshatshme dhe të besueshme”

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 422/1, datë 19.05.2023 “*Auditim financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Tepelenë*”, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin “*Bashkia Tepelenë*”, nga data 24.05.2023 deri në datën 28.06.2023, u krye “*Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë*”, për periudhën nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022, nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. J.P., *Përgjegjës Grupi*;
2. I.Sh.;
3. O.F. dhe
4. S.D., *anëtarë*.

1. Objekti i Auditimit

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.

2. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Tepelenë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë, z. T.P., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, z. S.K. në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH*”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin e grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).

- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor. Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Tepelenë, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

6. Kriteret e vlerësimit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
 - Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:**
- Ligjet përkatëse “Për buxhetin vjetor” dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje.
 - Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”
 - Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Per pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar;
 - VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”;
 - Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;
 - Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;
 - UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj;
 - Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
 - Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022;
 - Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të

prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.

- Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;
- Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, dhe pikat 116-117, “Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”), Fletore zyrtare 196/2014;

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

- VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

Në fushën e prokurimeve publike:

- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;
- UMF nr. 57, datë 12.06.2014, “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e

Shqipërisë”, i ndryshuar;

Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:

- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”;
- Ligji nr. 107-2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e përditësuar;
- VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;
- Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLS-së”;
- Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
- Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;
- Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

7. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

8. Metodatat e auditimit

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pështetja specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin:

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

▪ Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

▪ Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

▪ Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

▪ Kontrolli i vlerësimeve

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

▪ Konfirmimi nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

▪ Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme,

regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- **Intervista**
- **Raporte dhe Informacione**
- **Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK**

9. Dokumentimi i auditimit

Mbi bazën e Pyetësorëve dhe Testeve përkatëse të miratuara në manualët e auditimit financiar dhe përputhshmërisë, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartuan Akt-Konstatimet dhe Akt-Verifikimet, si dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, u përgatit Projektraporti i Auditimit, i cili është materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Opinionit të Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre;
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

- **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

- **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivët, pasivët dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

- **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Tepelenë

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Tepelena kufizohet në veri me bashkinë Memaliaj, në lindje me bashkinë Këlcyrë, në jug me bashkinë Gjirokastrë dhe në perëndim me bashkinë Himarë dhe Selenicë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Tepelenës. Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 8.949 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 16.371 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 431.24 km² me një densitet prej 12.1 banorë/km² (disafish më e ulët se mesatarja në rang vendi, për shkak të sipërfaqes së madhe me zonë malore). Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 24 fshatra. Bashkia e Tepelenës zgjerohet me disa zona rurale, të cilat merren kryesisht me blegtori. Shërbimet e vogla tregtare dhe mbledhja e bimëve medicinale sigurojnë pak të ardhura për familjet. Një nga projektet më të rëndësishme është ai i qendrës së qytetit të Tepelenës, ku synohet edhe rivitalizimi i kalasë së Ali Pashës në funksion të nxitjes së turizmit. Kjo kala, por edhe pasuri të tjera si kanioni i Bënçës, ura e Beçishtit apo Uji i Ftohtë mund të shërbejnë për nxitjen e turizmit kulturor dhe natyror.


Të dhënat e vitit 2015 flasin për një numër total prej 16,4 mijë banorësh të regjistruar në gjendjen civile, krahasuar me rreth 20 mijë në vitin 2000. Duket se rënia sistematike e numrit të popullsisë aktualisht është frenuar, si në territorin e ish-komunave, ashtu edhe në qytetin e Tepelenës. Raporti gjinor, sipas të dhënave të censurit të vitit 2011 rezulton të jetë 104.9, pak më i lartë se mesatarja kombëtare prej 100.4, gjë që mund të shpjegohet me fenomenin më të lartë të migrimit tek gjinia femërore.

Në Bashkinë e Tepelenës, grupmosha 15 – 64 vjeç përbën 66.9% të totalit të banorëve, duke qenë thuajse afër mesatares kombëtare (68%), po ashtu si edhe grupmosha e fëmijëve: 19% (mesatarja në rang vendi 20%).²

Zhvillimi ekonomik

Ekonomia e Bashkisë Tepelenë karakterizohet nga prezenca e informalitetit dhe mbizotërimi i bizneseve të vogla dhe familjare. Numërohen në total rreth 353 biznese, nga të cilat pjesa më e madhe e zhvillojnë aktivitetin në territorin e njësisë administrative Tepelenë. Tregtia dhe shërbimet përqendrojnë mbi gjysmën e aktiviteteve të biznesit në total.

Sektori i shërbimeve është më i zhvilluari, ai është përgjegjës për gati gjysmën e *output*-it dhe punësimit. Rritimi i rritjes së këtij sektori ka qenë konstant edhe gjatë 4-5 viteve të fundit me një normë mesatare prej 1-2% në vit. Rritja e shpejtë e këtij sektori është e lidhur ngushtë me shfrytëzimin e potencialeve turistike që ka bashkia. Atëherë, shërbimet mund të luajnë rolin e motorrit të rritjes ekonomike në vitet në vazhdim.



² **Burimi:** Plani Operacional i Zhvillimit Vendor

Krahas sektorit të shërbimeve, po tenton të rritet gradualisht aktiviteti me natyrë industriale, që konsiston në bizneset e industrisë së lehtë dhe ushqimore (Uji Tepelena), por edhe përpunimin fillestar të bimëve medicinale.

Rënia e interesit ndaj zhvillimi të aktiviteteve tradicionale të bujqësisë është e dukshme, diçka më mirë paraqitet prodhimi blegtoral nga baxhot e zonës. Aktivitetet ekszituese bujqësore synojnë më tepër përmbushjen vetëm të nevojave familjare dhe janë të kufizuara në përdorimin e ngastrave jo më të madhe se 1-2 ha për këtë qëllim. Klima e përshtatshme lejon rritjen e rreth 41 mijë rrënjë ullinj dhe 38 mijë rrënjë hardhi. Në fermat blegtorale rriten rreth 70 mijë krerë të imta (50 mijë dele dhe 20 mijë dhi) dhe 4 mijë gjedhë, produktet e të cilave tregtohen edhe jashtë territorit të bashkisë.

Forma dhe mënyra e organizimit:

Kryetar i Bashkisë Tepelenë është z. T.P. dhe Këshilli Bashkiak i Tepelenës përbëhet nga 15 anëtarë, të cilët janë mandatuar në datën 30 korrik 2019.

Struktura organizative aktuale është miratuar me Vendim të Titullarit nr. 14 datë 01.04.2022, me 239 punonjës.

Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat

Emri i Njësite	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Tepelenë	Qyteti Tepelenë
Qendër Tepelenë	Fshatrat: Dukaj, Salari, Turan, Mamaj, Veliqot, Bënçë, Dragot, Beçisht, Mezhgoran, Peshtan, Hormovë, Lekël, Kodër, Luzat
Lopës	Fshatrat: Sinanaj, Matohasanaj, Dorëz, Dhëmbjan, Lab Martalloz
Kurvelesh	Fshatrat: Progonat, Lekdush, Gusmar, Nivicë, Rexhin

Kuadri ligjor:

Bashkia Tepelenë e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në dispozitat ligjore/nënligjore për secilën fushë të aktivitetit të saj, të cilat janë të specifikuar në programin e auditimit dhe në aneksin bashkëlidhur.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Tepelenë, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë është renditur puna e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimi për integritet dhe vlerat etike”

- Bashkia Tepelenë ka miratuar Rregulloren e brendshme të bashkisë me Vendimin e kryetarit të bashkisë nr. 68 prot., datë 05.05.2017 “Për miratim të Kodit të Etikës në Bashkinë Tepelenë”;

- Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria Juridike, por nuk ka trajnime për këto raste.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”

- Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të tij.

- Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

- Në bazë të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenet 19 dhe 29, si dhe shkresave përkatëse të Ministrisë së Financave nga bashkia, është plotësuar dhe dërguar pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pranë Ministrisë së Financave “Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm” për vitin 2022 me shkresën nr. 397 prot., datë 16.02.2023.

- Raportet periodike për realizimin e objektivave janë miratuar me VKB nr. 75 prot., datë 17.12.2021 “Për miratimin e buxhetit afatmesëm 2022-2024”; VKB nr. 76 prot., datë 26.09.2022 “Për miratimin e raportit për monitorimin e vlerësimin e buxhetit për periudhën janar-gusht 2022”, VKB nr. 43 prot., datë 31.05.2022 “Për miratimin e raportit për monitorimin dhe vlerësimin e buxhetit për 4 mujin e parë 2022”; VKB nr. 18, datë 23.02.2023 “Për miratimin e raportit për zbatimin e buxhetit 2022, miratimin e grupit të punës për hartimin e projekt buxhetit 2022-2024”; Vendim nr. 1 prot., datë 27.09.2021 “Për fillimin e realizimit të procedurës së konsultimit publik”; Ftesa për konsultim nr. 1879 prot., datë 08.10.2021 “Për programin buxhetor afatmesëm 2022-2024”; Procesverbali datë 19.10.2021; Shkresa nr. 2453 prot., datë 13.12.2022 “Mbi zbatimin e rekomandimeve e opinionëve të dhëna gjatë procesit të konsultimit publik të projekt aktit PBA 2022-2024”.

- Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendimmarrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 *“Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”*

- Bashkia Tepelenë për periudhën objekt auditimi ka hartuar dhe ka funksionuar me një rregullore të brendshme në përshtatje me strukturën organizative, me vendimin nr. 2, datë 21.03.2016, i ndryshuar me vendimin nr. 21 prot., datë 04.09.2019.

- Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri me njëfarë mase me ndryshimet e strukturave organike, pasi mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e Strukturës së Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, të strukturave për funksione të deleguara të atashuar si Sektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, (MZSH-së), sektorë të cilët nuk janë përfshirë në Rregullore.

- Informimi i stafit me rregulloren e re është bërë me adresën zyrtare të emali-it për stafin dhe drejtoritë dhe nuk ka urdhër të veçantë të Kryetarit të Bashkisë. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet me ndryshimet e strukturave organike.

- Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.

- Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë. Për vitin 2022 struktura është miratuar me Vendim të Titullarit nr. 14 datë 01.04.2022, me 239 punonjës.

- Në Rregulloren e Brendshme, për çdo drejtori janë misioni, objektivat, baza ligjore, përbërja e strukturës, detyrat dhe përgjegjësitë për çdo drejtori, sektor dhe specialist. Ndërsa në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, por jo objektivat për secilin punonjës.

- Bashkia Tepelenë ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësinë vendore.

- Vlerësimin e punës të strukturës organike, Bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 *“Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”*

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, por nuk ka një plan vjetor rekrutimi.

- Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale, e cila përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë, si dhe dokumentet përkatëse që vërtetojnë pohimin e bërë si: çertifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit për zhvillimin e stafit dhe për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

- Nga Bashkia Tepelenë është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve dhe kjo tabelë i është dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

- Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë, në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë të organigramës së përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve

njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit.

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komiteti i Auditimit të Brendshëm”.

- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Përgjegjës i Zyrës së Financës.

Në lidhje me parimin 5 “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”

- Janë kryer delegime detyrash të cilat janë bërë në bazë të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 59, pika 3 me autorizimet dhe Urdhërat përkatës, kryesisht delegimi i funksioneve në rast të mungesës së nëpunësit autorizues dhe nuk ka raste të delegimit nga nëpunësi zbatues ose drejtorët e drejtorive.

- Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit të MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2024”, Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhërin nr. 14 prot., datë 12.02.2018, “Për ngritjen e GMS”.

- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

- Nuk janë vendosur rregullat e monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar.

- Nuk është dokumentuar procesi i paraqitjes së kërkesave buxhetore sipas programeve të Koordinatorit i GMS-së.

- Përsa i përket dokumenteve të hartuara, është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë: Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore; sistemi i programimit të zbatimit të buxhetit; sistemi i pagesave, sistemi i prokurimeve me vlera të vogla dhe të larta; inventarët e aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese; sistemi i tatim-taksave.

- Në kapitullin “Vlerësimi i sistemit të MFK-së”, janë përshkruar se sa janë arritur objektivat në fushat prioritare për bashkinë si në sektorin e shërbimeve publike, sektorin e urbanistikës dhe sektorin e tatim-taksave. Si ka ndikuar komponenti i informimit dhe komunikimit me procedurat me rregulloret e hartuara dhe të realizuara nga kjo njësi në arritjen e objektivave në sektorët më të rëndësishëm të veprimtarisë së bashkisë. Si ka funksionuar komponenti i monitorimit të kontrollit të brendshëm në cilësinë e performancës. Si ka ndikuar veprimtaria e AB në monitorimin e Kontrollit të brendshëm.

- Pjesë e Deklaratës duhet të jetë edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo duhej realizuar nëpërmjet:

- Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

- Realizimit të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

- Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”:

Në lidhje me parimin 6: *“Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva”*

- Bashkia Tepelenë në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva si në planet operacionale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimet e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat kombëtare e sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë. Këto objektiva bëhen të njohura, duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak. Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla.

- Është hartuar regjistri i riskut, ku është bërë identifikimi dhe vlerësimi të risqeve në nivel drejtorie, por jo për të gjitha drejtoritë, si dhe janë përcaktuar veprime për të adresuar mangësitë. Duke mos u ngritur grupi i menaxhimit të riskut dhe në mungesë të veprimtarisë së tij, nuk janë identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut. Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe të vendoset kuadri i përgjithshëm i procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*.

Në lidhje me parimin 7: *“Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”*.

- Për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe të vendosë kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie, e cila përgatitet nga NA, duhet të miratohet nga titullari i njësisë, duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

Në lidhje me parimin 8: *“Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”*

- Duke mos patur një vlerësim të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin.

- Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, rryshfetit dhe korrupsionit.

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshira detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe gjithëpërfshirëse.

Në lidhje me parimin 9: *“Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”*

- Bashkia Tepelenë në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për t’i paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe

duke përcaktuar apo deleguar e autorizuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirës.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit*”

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar dhe krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.). Jo të gjitha aktivitetet e kontrollit janë të dokumentuara në formën e hartave të proceseve të punës.

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet, kryhet nga Drejtori i Financës (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i financës/Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA).

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhërat e krijimit dhe funksionimit të komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimi të mallit. Ngritja e këtyre komisioneve është parashikuar edhe në nenin 42 të Rregullores së Brendshme.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili përditësohet sa herë ka ndryshime fondesh.

- Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve, veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, në bazë të së cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar, si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale, të konfirmuara nga përgjegjësit materialë. Kjo praktikë ligjore është ndjekur për të ruajtur këto aktive nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet. Aktivitet Afatgjatë nuk janë regjistruar në SIFQ, pasi kjo Bashki akoma nuk është pilot për aplikimin direkt në programin e Qeverisë SIFQ.

Në lidhje me parimin 11: “*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë*”.

- Bashkia Tepelenë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

- Sektori i IT, i cili varet nga Drejtori i Sektorit të Burimeve Njerëzore, ka vetëm detyra për mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik dhe menaxhimin e programeve dhe merret me instalimin e programeve. Gjithashtu ka përgjegjësi dhe menaxhon Serverin kryesor, duke garantuar sigurinë e sistemit të IT në lidhje me ndryshimet e fjalëkalimeve, fireëall-et.

- Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up)

Në lidhje me parimin 12: “*Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave*”

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe për personelin tjetër të caktuar, përgjegjësi këto të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, por mungojnë plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: *“Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”*

- Drejtuesit në Bashkinë Tepelenë kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacional, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

- Sistemi i raportimit ofron pjesërisht informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj në tërësi.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe paraqiten pranë Këshillit Bashkiak si dhe në Degën e Thesarit.

- Raportet për detyrimet e konstatuara por të papaguara, hartohen çdo muaj dhe paraqiten në degën e thesarit.

- Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit në Bashkinë Tepelenë për mbajtjen e kontabilitetit, operon me program të vetin të kontabilitetit, pa e dubluar programin SIFQ. Në bazë të këtij programi kontabilitetit me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria Ekonomike. Ndërsa monitorimi i të ardhurave kryhet me program të veçantë të cilin e menaxhon Sektori i Tatim-Taksave.

Në lidhje me parimin 14: *“Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm”*

Në lidhje me parimin 15: *“Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm”*

- Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, në nenin 15” *Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të Administratës së Bashkisë”,* nenin 16 *“Marrëdhëniet me Këshillin Bashkiak”,* nenin 17 *“Informacioni dhe komunikimi me median”* dhe nenin 18 *“Marrëdhëniet me publikun”.*

- Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit çdo muaj, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale, të ardhurat e veta të realizuara dhe buxhetin e planifikuar. Informacioni prej drejtuesve dhe përgjegjësve të sektorëve, dërgohet çdo javë dhe nëpërmjet analizave të herëpashershme, sigurohet informacion për arritjen e objektivave dhe dëmet e mundshme.

- Të gjithë punonjësit e Bashkisë Tepelenë me statusin e nëpunësit civil, janë të pajisur me e-mail zyrtar.

- Nga Bashkia Tepelenë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por mungon dokumenti i konsultimit publik.

V. Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: *“Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.*

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion, konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë pjesërisht raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen e objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore lidhet me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen e objektivave, ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit, në lidhje me ligjshmërinë

dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomicitetit, të efikasitetit e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave për vitin 2022 me shkresën nr. 397/1 prot. datë 02.03.2023.

- Raportet Periodike për realizimin e objektivave, janë miratuar me VKB nr. 75, datë 17.12.2021 “Për miratim të buxhetit afatmesëm 2022-2024”; VKB nr. 76, datë 26.09.2022 “Për miratimin e raportit për monitorimin e vlerësimit të buxhetit për periudhën janar-gusht 2022”; VKB nr. 43, datë 31.05.2022 “Për miratim të raportit për monitorimin dhe vlerësimit të buxhetit për 4 mujorin e parë 2022”; VKB nr. 18 datë 23.02.2023 “Për miratimin e raportit për zbatimin e buxhetit 2022”.

- Në Bashkinë Tepelenë, aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Titulli i gjetjes: Në Bashkinë Tepelenë funksionimi i sistemit të MFK ka shfaqur mangësi, duke shkaktuar mosfunksionimin e plotë të sistemeve të kontrollit.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm, u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregojnë se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, megjithatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

Mjedisi i kontrollit: Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga auditimi rezulton se GMS nuk ka kryer detyrat si: Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e komisioneve të përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë, në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

Menaxhimi i Riskut: Mungon Urdhëri për përcaktimin e grupit të punës për riskun. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë në arritjen e objektivave dhe pengojnë marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe të vendoset kuadri i përgjithshëm i procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Aktivitetet e Kontrollit: Bashkia Tepelenë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (*back-up*) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të IT si instalimin e softuerit, programimin e testimit etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të IT të miratuar nga Kryetari, si dhe nuk ka qenë fushë drejtimi auditimi nga AB.

Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme.

Informimi dhe komunikimi: Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë.

Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Nga Bashkia Tepelenë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por mungon dokumentimi i konsultimit publik.

Monitorimi: Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Në Bashkinë Tepelenë aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar dhe Manualin e MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Kriteri: Mosnjohje e plotë dhe sa duhet e koncepteve të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Ndikimi/Efekti: Nga Bashkia Tepelenë nuk janë zbatuar rigorozisht elementët nga të cilët përbëhen pesë Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke riskuar sigurinë e arritjes së objektivave të bashkisë nëpërmjet përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore.

Shkaku: Mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin në drejtim të njohjes së dispozitave të MFK dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, me atributet e Kryetarit të GMS, si dhe Nëpunësit Autorizues dhe Koordinatorit të Riskut, të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryhen investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryhen procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimesh për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherë të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Të vendoset

një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm.

Në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, është krijuar njësi e Auditimit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr. 1100, i Institutit Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm. Ky sektor, për periudhën objekt auditimi është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të VKB nr. 14, datë 01.04.2022, i konfirmuar nga Prefekti Gjirokastër me shkresën nr. 529/1 prot., datë 02.06.2022. Në strukturën organike është miratuar me 3 punonjës, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Aktualisht kjo strukturë funksionon me 1 auditues/përgjegjës i sektorit të AB në Bashkinë Tepelenë.

Struktura e NjAB në Bashkinë Tepelenë është në nivel Njësie. Sipas vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 21, datë 31.03.2022, i konfirmuar nga Prefekti Gjirokastër me shkresën nr. 355/1 prot., datë 19.04.2022. “Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë Tepelenë dhe strukturave të tjera” dhe Relacionit “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Tepelenë, për vitin 2022”.

NjAB e ka kryer veprimtarinë e saj në zbatim të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe akteve të dala në zbatim të tij, të cilët përbëjnë detyrat dhe kërkesat më themelore për veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

Nga data 01.11.2021 e në vijim, drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Tepelenë është në marrëdhënie pune me kontrate, aktualisht me detyrë drejtues i Njësisë së Auditimit të Brendshëm. Gjatë muajit tetor është miratuar karta e AB, me shkresën nr. 2529 prot., datë 19.10.2022.

Struktura e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Tepelenë, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Arsimi	Vjetërsi	Vjetërsi Auditim	Trajnime 2022	Çertifikatë si auditues
1	K.N.	Përgj/Sek.	I lartë	45	21	Po	Po

Struktura e AUB nuk është në përputhje me VKM nr. 83 prot., datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar.

2.1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm.

Plani i Auditimit të Brendshëm vjetor për vitin 2023 dhe Plani Strategjik për vitet 2023-2025, është miratuar nga Titullari i Bashkisë me shkresën nr. 2528 prot., datë 19.10.2022.

Për vitin 2022 janë planifikuar gjithsej 8 angazhime auditimi dhe janë realizuar 8 auditime: 4 auditime financiare dhe 4 auditime përputhshmërie, si më poshtë vijon:

Nr.	Subjektet e audituara	Lloji i auditimit
1	NJ. A. Qendër Tepelenë	Financiar & Përputhshmëri
2	NJ. A. Kurvelesh	Financiar & Përputhshmëri
3	NJ. A. Lopës	Financiar & Përputhshmëri
4	NJ. A. Qytet Tepelenë	Përputhshmëri
5	Drejtoria e Financës së Bashkisë	Financiar, Detyrimet e prapambetura

Sipas raportimit vjetor të veprimtarisë me shkresën nr. 329 prot., datë 09.02.2023 se NJAB për periudhën 01.01.2022-31.12.2022

Nr.	Llojet e auditimit	Të planifikuara	Të realizuara
1	Të përputhshmërisë	4	4
2	Financiare	4	4
	Gjithsej	8	8

Nga shqyrtimi i disa dosjeve të auditit të brendshëm për vitin 2022 u konstatua:

Janë audituar nga NJAB: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik & Menaxhimit Financiar dhe 4 Njësitë Administrative të Bashkisë Tepelenë, pra janë planifikuar në institucione të varësisë. Në Njësitë Administrative janë kryer 4 auditime Përputhshmërie dhe 3 auditime Financiare. Në Drejtorisë së financës Auditim Financiar mbi Detyrimet e Prapambetura për vitin 2021 dhe për 10 mujorin e vitit 2022.

Program Auditimi: nr. 1555/1 Prot., datë 04.07.2022.

Ky program është bërë me kërkesë nga ana e NJAB, të Bashkisë Tepelenë për shtyrje të afatit kohor, për kryerjen e misionit të auditimit të brendshëm deri në datën 30.11.2022.

Pra, programi ka ndryshuar për afatin kohor, me shkresën nr. 2683 Prot., datë 04.11.2022, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Tepelenë.

Periudha e auditimit:	01.01.2022-31.10.2022;
Audituesit:	K.N.;
Periudha e angazhimit:	04.11.2022-30.11.2022;
Lloji i auditimit:	Përputhshmërie & Financiar;
Raporti final:	Nr. 117 prot., datë 17. 01.2023;
Numri i rekomandimeve:	8 të dhëna dhe 8 të pranuar.

Shtyrja e afatit kohor të periudhës së auditimit të programuar nga 6 muj të vitit 2022, në 10 muaj të vitit 2022, ka ardhur si rezultat i ndryshimit në programin e paraqitur, pasi do të auditohen edhe detyrimet e prapambetura për vitin 2021 dhe për 10 mujorin e vitit 2022, sipas dokumentacionit përkatës, pranë Drejtorisë së Financës të Bashkisë.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

Nuk janë respektuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të MAB të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të MF “Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik” kapitulli IV, pika 4.1.1 “Planifikimi i një angazhimi auditimi”; kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”, pika 6.1

Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga vetë NjAB konstatohet se anekset “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “Vetëvlerësimi periodik” nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve në pikën 7.1.1 të Kapitullit VII të MAB, të cilat nuk mbulojnë në të gjitha fazat e auditimit si dhe i mungon komponenti i tretë “Reagimet e subjektit të audituar”. Pyetëtori i reagimit ndaj angazhimit nuk i është dërguar zyrtarisht subjekteve të audituara me dërgimin e Raportit Përfundimtar, kështu që pyetëtori nuk është kthyer i plotësuar dhe nuk gjendet si pjesë e inventarit të çdo dosjeje.

Në programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë, nuk janë përcaktuar indikatorët e matjes së performancës, gjë që ka kushtëzuar hartimin e raporteve specifike të vlerësimit të performancës dhe si rrjedhim adresimin e rekomandimeve për përmirësim, duke munguar raportimi tek Titullari për këtë procedurë.

Në dosjet e shqyrtuara u konstatua se në raportet e hartuara për çdo angazhim auditimi është shprehur opinionimi i grupit lidhur me faktorët që kanë çuar në: nivelin e riskut të evidentuar dhe vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme të vendosura.

Në raportet e auditimit duhet të zinte më shumë vend analizimi i secilit komponent të kontrollit të brendshëm për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të qenë më të qarta rekomandimet për të ardhmen dhe të përfshihej opinionimi i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm (referuar dosjeve të shqyrtuara). Audituesit e Brendshëm nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi funksionimin dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për çdo sistem të audituar, vlerësimin dhe analizën e riskut, përcaktimin

e faktorëve kryesorë në rezultatet e vlerësimit të riskut, si dhe kritereve për vlerësimin e nivelit të riskut (I lartë, I mesëm dhe I ulët).

Opinion i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të jetë prezent si në përmbledhësen ekzekutive dhe në memorandumun e çdo raporti angazhimi. Nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projektraportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim).

Në shumicën e rasteve rekomandimet e dhëna i referohen bazës ligjore, pra “*në zbatim të akteve ligjore*”, duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem. Për rekomandimet e adresuara nuk ka përcaktuar afatin e zbatimit të tyre dhe nivelin e rëndësisë së tyre (I lartë, I mesëm dhe I lartë);

Nuk dokumentohet që NjAB, pas përfundimit të çdo angazhimi të auditimit, të ketë njoftuar zyrtarisht subjektin e audituar për reagimin ndaj projekt rekomandimeve të adresuara, konform detyrimit të përcaktuar në pikën 4.1.12 të MAB. Në formulimin e gjetjeve ka mangësi, pasi në të shumtën e rasteve situata e përshkruar nuk ka të përcaktuar periudhën e audituar, kujt viti i referohet, si dhe nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i mospërputhshmërisë apo standardet e kontabilitetit për problematikën e konstatuar nga auditimi, në kundërshtim me pikën 2.4.1 “*Auditimi i përputhshmërisë*” dhe 2.4.2. Mbulimi me auditim i aktivitetit të Bashkisë Tepelenë është i pamjaftueshëm vetëm me një punonjës në strukturën e kësaj drejtorie dhe si për pasojë puna e bërë nuk arrin rezultatet e duhura.

Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, të tilla si prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, asetet, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”.

Titulli i gjetjes: Mbi vlerësimin e aktivitetit të Njësisë së auditimit të brendshëm.

Situata: Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga NjAB, u konstatua se anekset “*Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë*” dhe “*Vetëvlerësimi periodik*” nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve në pikën 7.1.1 të Kapitullit VII të MAB, si dhe mungon komponenti i tretë “*Reagimet e subjektit të audituar*”. Pyetësi i reagimit ndaj angazhimit nuk i është dërguar zyrtarisht subjekteve të audituara me dërgimin e Raportit Përfundimtar, kështu që pyetësi nuk është kthyer i plotësuar dhe nuk gjendet si pjesë e inventarit të çdo dosjeje.

Në programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë, nuk janë përcaktuar indikatorët e matjes së performancës, gjë që ka kushtëzuar hartimin e raporteve specifike të vlerësimit të performancës dhe si rrjedhim adresimin e rekomandimeve për përmirësim, duke munguar raportimi tek Titullari për këtë procedurë.

Në raportet e auditimit duhet të zinte më shumë vend analizimi i secilit komponent të kontrollit të brendshëm për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të qenë më të qarta rekomandimet për të ardhmen dhe të përfshihej opinion i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm (referuar dosjeve të shqyrtuara). Audituesit e Brendshëm nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi funksionimin dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për çdo sistem të audituar, vlerësimin dhe analizën e riskut, përcaktimin e faktorëve kryesorë në rezultatet e vlerësimit të riskut, si dhe kritereve për vlerësimin e nivelit të riskut (I lartë, I mesëm dhe I ulët).

Opinion i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të jetë prezent si në përmbledhësen ekzekutive dhe në memorandumun e çdo raporti angazhimi. Nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të

Projektraportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim).

Në shumicën e rasteve rekomandimet e dhëna i referohen bazës ligjore, pra “*në zbatim të akteve ligjore*”, duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem. Për rekomandimet e adresuara nuk ka përcaktuar afatin e zbatimit të tyre dhe nivelin e rëndësisë së tyre (I lartë, I mesëm dhe I lartë).

Nuk dokumentohet që NjAB, pas përfundimit të çdo angazhimi të auditimit, të ketë njoftuar zyrtarisht subjektin e audituar për reagimin ndaj projekt rekomandimeve të adresuara, konform detyrimit të përcaktuar në pikën 4.1.12 të MAB. Në formulimin e gjetjeve ka mangësi, pasi në të shumtën e rasteve situata e përshkruar nuk ka të përcaktuar periudhën e audituar, kujt viti i referohet, si dhe nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i mospërputhshmërisë apo standardet e kontabilitetit për problematikën e konstatuar nga auditimi, në kundërshtim me pikën 2.4.1 “*Auditimi i përputhshmërisë*” dhe 2.4.2. Mbulimi me auditim i aktivitetit të Bashkisë Tepelenë është i pamjaftueshëm vetëm me një punonjës në strukturën e kësaj drejtorie dhe si për pasojë puna e bërë nuk arrin rezultatet e duhura.

Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, të tilla si prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, asetet, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të Ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”.

Sa më sipër, është në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, të MAB të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të MF “*Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik*”, kapitulli IV, pika 4.1.1 “*Planifikimi i një angazhimi auditimi*”, kapitulli VI “*Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese*”, pika 6.1.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi, ngarkohen me përgjegjësi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë z. T.P. dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditit të Brendshëm z. K.N..

Kriteri: Ligji nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” dhe “*Manuali i auditimit të brendshëm në sektorin publik*”; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik*”; Ligji nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”; “*Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhërin e Ministrisë të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016, “*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*”, etj.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e një njësie të plotë të auditimit të brendshëm në strukturën e Bashkisë Tepelenë, përbën pengesë për mirëfunksionimin dhe performancën e Njesisë së auditimit të brendshëm të bashkisë, si dhe në dhënien e sigurisë titullarit të saj për përmbushjen e objektivave të bashkisë.

Shkaku: Moszbatim i kërkesave të akteve ligjore të sipërcituara, Neglizhenca dhe mos përmbushja e angazhimeve për auditim sipas planifikimit të bërë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të merren masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse t’i jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. Nga kryetari i Bashkisë Tepelenë, të merren masa për të plotësuar strukturën e sektorit të auditimit të brendshëm.

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

➤ Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2022-2024

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024 rezultoi se:

- Për realizimin e fazave të përgatitjes ka dalë Urdhëri i Titullarit nr. 141 datë 11.11.2021 mbi bazën e të cilit është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), i përbërë prej 9 punonjësish dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP). Programi Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe buxheti i vitit 2022, si dhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara janë miratuar në Këshillin Bashkiak.

- Programi Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 është miratuar me VKB nr. 75, datë 17.12.2021. Nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së përgatitjes dhe hartimit të PBA rezultoi se në përgjithësi ishin respektuar kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024” dhe të Udhëzimit plotësues të MFE nr. 20, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

- Në këtë programim është përgatitur dhe përfshirë Instrumenti i Planifikimit Financiar, shoqëruar me relacionin shpjegues, i cili është dërguar në MFE me shkresën nr. 911/1 prot., datë 31.05.2021 dhe përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzime të viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve (të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (kostot direkte dhe të ardhurat e pritshme).

- Në dokumentin e PBA janë përcaktuar drejtimit e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, duke u bazuar në analizën e zërave të buxhetit në tre vitet e fundit dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin PBA-ja 2022-2023-2024.

- Janë përcaktuar fushat prioritare në shpenzimet për investime për funksionet më të rëndësishme si në infrastrukturë, në funksionin e arsimit, në bujqësi për të thithur projekte investimi me financim nga FSHZH. Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe ka marrë rekomandimet e Ministrisë së Financave;

- Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”, ku për të cilat ishin mbajtur relacionet dhe protokollet përkatëse.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur për hartimin e PBA 2022-2024 dhe buxheteve vjetore, rezulton se janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga Njësitë Administrative dhe nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Tepelenë në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, si dhe kërkesa nga sektorë të ndryshëm, që mbulojnë këto programe.

- Në fazën përfundimtare të PBA, duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investime dhe të ardhurat.

- Kërkesat buxhetore për PBA janë dërguar në MFE me shkresën nr. prot.911/1, datë 31.05.2021.

➤ Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2022

Për vitin 2022, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 76, datë 17.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1174/1 datë 30.12.2021, sipas Aneksit B1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku konstatohet se buxheti i vitit 2022

është miratuar i balancuar dhe pa defiçite, ku të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 220,000 mijë lekë.

➤ Krahasimi i planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, është paraqitur në Aneksin B2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku konstatohet se nga krahasimi i planit fillestar të buxhetit 2022 me vitin e parë të planit buxhetor afatmesëm 2022-2024, rezulton se ka diferencë prej 56,032 mijë lekë mbi tavanin e përcaktuar në PBA. Diferenca prej 56,032 mijë lekë e rezultuar nga krahasimi i planit fillestar me vitin e parë PBA (2022) i përket shpenzimeve në llogaritë 602, 604, 609, që i përket vlerës së shtuar nga ndryshimi i planit të të ardhurave të veta, nga shtesa e transfertes së pakushtëzuar si dhe fonde nga projekte me financim të huaj.

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet, që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Tepelenë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Tepelenë dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjera, sipas nevojave të Bashkisë Tepelenë .

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB. Për vitin 2022 konstatohet se janë bërë vetëm dy ndryshime me VKB dhe një shtesë nga MF, të cilat janë paraqitur në Aneksin B3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Tepelenë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Tepelenë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin 2022, të miratuar me Vendim të KB ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara. Nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-

rakordimeve periodike me degën e Thesarit Tepelenë u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin është paraqitur në Aneksin B4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku konstatohet se niveli i realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2022 është realizuar 486,649 mijë lekë nga 512,088 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 95,03%.

Kjo tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Tepelenë. Në këtë masë realizimi, ka ndikuar realizimi në masë të ulët në zërat e buxhetit:

- a. Shpenzimet operative (Ilogaria 602) janë realizuar në masën 88,86%.
- b. Transferime 604 (Këshilli i Qarkut, Sporti), janë realizuar në masën 99,97%.
- c. Shpenzimet për investime (Ilogaria 231) janë realizuar në masën 98,55%.

Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë transferimet tek individët për ndihmë ekonomike e invaliditeti, ndjekur nga shpenzimet për investime dhe shpenzimet për paga personeli, tregues të cilët janë paraqitur në Aneksin B5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ Miratimi i realizimit faktik të buxhetit

Në fund të periudhës ushtrimore nga Bashkia Tepelenë është miratuar buxheti vjetor, ku për vitin 2022 është miratuar me vendim të KB nr. 18, datë 23.2.2023.

➤ Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe i kontigjencës

Fondi rezervë për vitin 2022 është në total në shumën 5,000 mijë lekë, i cili është miratuar që nga buxheti fillestar e deri në fund të vitit buxhetor me VKB dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

- Miratimi fillestar me VKB nr. nr. 76, datë 17.12.2021 në vlerën 5,000 mijë lekë.

Përdorimi i Fondit Rezervë në vlerën 5,000 mijë lekë, konkretisht:

- VKB nr. 44 datë 31.05.2022 përdorur për transferta të brendshme 1,000 mijë lekë, transferta për individë 500 mijë lekë dhe shpenzime operative 3,500 mijë lekë.

➤ Raportet e Monitorimit

Për vitin 2022, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 6.

Për vitin 2022 është dërguar “Raport monitorimi Buxhetit janar-prill” me shkresën nr. prot., 1127, datë 19/05/2022, “Raport monitorimi Buxhetit janar-gusht” me shkresën nr. 2016 prot., datë 12.09.2022, “Raport monitorimi Buxhetit janar-dhjetor” me shkresën nr. 177 prot., datë 23.01.2023.

Raportet e monitorimit janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” dhe Shtojcës 5 “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”, të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”. Raportet e monitorimit janë të plota me të gjitha anekset sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, pika 10, 12, 28, 29, 48.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditore) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

➤ Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të palikuiduara

Me fondet e vitit buxhetor 2022, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara Bashkia, nga Ministrinë e linjës apo FSHZH sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Planifikimi i detyrimeve të papaguara nga viti paraardhës në buxhet respektivisht, është paraqitur në Aneksin B6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Detyrimet e prapambetura janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “*Detyrimet e prapambetura*”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura janë paraqitur në Aneksin B7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Referuar shkresës së raportimit nr. 177 prot., datë 23.01.2022 dërguar në MFE detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2021 janë në shumën 39,180,517 lekë, ndërsa sipas raportimeve në mënyrë periodike në MFE, detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2022 janë në shumën 26,173,384 lekë. Gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime ndaj të tretëve në shumën 1,205,133 lekë, por njëkohësisht janë likuiduar në total detyrime si të krijuara dhe të prapambetura në shumën prej 14,212,266 lekë, duke ulur detyrimet e prapambetura në fund të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 26,173,384 lekë.

Shënim: Detyrimet e raportuara në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për vitin 2022 me shkresën nr. 177 prot, datë 23.01.2023 janë në vlerën 1,205,133 lekë, i përkasin detyrimeve të krijuara vetëm brenda vitit 2022.

Faturat e palikuiduara gjendje të mbërritura në institucion deri me datë 31.12.2022 janë paraqitur në Aneksin B8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Detyrimet e prapambetura janë të rakoduara me Degën e Thesarit sipas Aneksit B9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Konkluzion: Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, në fund të periudhës ushtrimore 2021 Bashkia Tepelenë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në shumën prej 19,299,971 lekë, e cila ka ardhur duke u ulur. Nga auditimi i dokumentacionit të miratimit të buxhetit vjetor 2022, rezultoi se është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura.

Detyrimet e prapambetura për vitin 2022, të paraqitura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 177 prot, datë 23.01.2023 janë paraqitur në Aneksin B10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Krijimi dhe akumulimi i detyrimeve të paguar në fund të vitit ushtrimor është në pajtueshmëri me Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, pika 153-162, Rubrika “*Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve*”, nenin 52 të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*”, pikat 82-91.

➤ Situata e gjendjes Financiare

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (të akumuluar) në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën 26,173,384 lekë dhe fondet e miratuara për shpenzime të këtij viti janë në vlerën 377,249,000 lekë (512,088,000 lekë totali i planifikuar –134,839,000 lekë transferta e kushtëzuar ndihmë ekonomike & invaliditet). Peshat specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj ndaj palëve të treta është 6.94% kundrejt fondeve të miratuara. Kjo situatë, tregon se Bashkia Tepelenë është në situatë normale të gjendjes financiare në fund të vitit ushtrimor 2022, pasi raporti i detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është nën nivelin prej 25 %, sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për investime. Investimet kryesisht janë me burim financimi nga transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta (minimale) të Bashkisë Tepelenë.

- Për vitin 2022 janë planifikuar fonde për investime në shumën 118,879,000 lekë (nga të cilat 17,800,000 lekë janë nga granti i pakushtëzuar + tansnferta sektoriale + të ardhura dhe 101,079,090 lekë transfertë e kushtëzuar të financuar nga Ministritë e linjës), realizuar dhe likuiduar në vitin 2022 në vlerën 111,020,656 lekë. Realizimi në masën 93.3% i investimeve ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave.

Gjatë vitit ka pasur ndryshime si shtesa dhe pakësime, të cilat janë shqyrtuar nga GMS, i cili ka vendosur miratimin e tyre dhe më pas janë miratuar me VKB për secilin rast.

Projektet me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre janë paraqitur në Aneksin B11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e investimeve në nivel projekti paraqiten si më poshtë:

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e 19 projekteve të investimeve Bashkia Tepelenë, rezultoi se janë realizuar dhe finalizuar me kontratë 2 projekte dhe nuk janë prokuruar 4 projekte në vlerën 17,414,000 lekë.

Projekte të paprocuruara për vitin 2022:

1. Blerje konteniere për mbetje urbane në vlerën 1,200 mijë lekë.
2. Rikonstrukcion blloqe banimi në vlerën 4,714 mijë lekë.
3. Rikonstrukcion lera e permiresim kullote në vlerën 8,000 mijë lekë.
4. Rikonstrukcion Qendra e fshatit Dukaj në vlerën 3,500 mijë lekë.

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e **19** projekteve të investimeve Bashkia Tepelenë, rezultoi se janë ndjekur hapat:

Për çdo procedure prokurimi, urdhëri është regjistruar në kohë dhe ka vulën/ datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Tepelenë. Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Tepelenë dhe të shtrira në kohë sipas financimit brenda vitit buxhetor koherent. Kontrata është regjistruar e plotë me qëllim pagesën e saj në afate mujore, pra nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në Degën e Thesarit është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit.

➤ Burimet e financimit të buxhetit vjetor

Realizimi i buxhetit për vitin 2022, sipas burimit të financimit është paraqitur në Aneksin B12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku rezulton se nga të ardhurat e veta kjo bashki përballon në fakt:

- Shpenzimet në artikullin 600 “Paga e shpërblime” për vitin 2022 në masën 4%

- Shpenzimet në artikullin 601 “Kontributin për sigurime shoqërore e shëndetësore” për vitin 2022 në masën 0.71%.
- Shpenzimet në artikullin 602 “Shpenzime operative për mallra e shërbime” për vitin 2022 në masën 4.05%.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 “Investime” për vitin 2022 në masën 1,44 %.
- Shpenzimet në artikullin 604 “Transferime “ për vitin 2022 në masën 0.41%.

Duke u nisur nga burimi i financimit **për vitin 2022** shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 55,189 mijë lekë ose në masën 11,3 %, nga transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike në shumën 196,285 mijë lekë ose në masën 40,03%, nga transfertat e kushtëzuar në shumën 235,175 mijë lekë ose në masën 48,3% .

Titulli i gjetjes: Mbi programimin, realizimin dhe zbatimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi.

Situata: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2020 u konstatua se:

a. Realizimi i buxhetit për vitin 2022 janë realizuar **486,649** mijë lekë nga **512,088** mijë lekë të planifikuara, ose në masën 95%. Në nivel zëri shpenzimesh me realizim më të ulët rezulton zëri 602 “Shpenzime operative” në masën 89%, ndërsa zëri 230-231 “Shpenzime për investime”, pavarësisht se është realizuar si fonde në masën 93% në nivel projektesh nga 19 projekte të planifikuara nuk janë prokuruar, kontraktuar dhe realizuar 4 projekte investimesh.

b. Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën **26,173,384** lekë ose në masën 6.94% të shpenzimeve të planifikuara, të cilat janë ulur krahasuar me fundvitin 2021, që ishin në shumë të konsiderueshme prej **39,180,517** lekë. Detyrimet e krijuara vetëm në vitin 2022 janë në vlerën 1,205,133 lekë. Detyrimet e papaguara rakordojnë me raportimin në MFE të vitit 2022, ndërsa me gjendjen prej 28,229,661 lekë të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të bilancit të vitit 2022 nuk rakordon për shumën 2,056,277 lekë, diferencë që përfaqëson detyrimet ndaj të treteve të krijuara në dhjetor të vitit ushtrimor 2022, që nuk u ka kaluar afati 30 ditor i pagesës.

c. Gjithashtu konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën më të madhe prej 88.7% nga Buxheti i Shtetit (transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat e kushtëzuar e transfertat specifike) dhe 11.3% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifatat vendore janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat që siguron njësitë vendore nga burime të tjera.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 43, paragrafi 4, nenet 47, 48, 52; Ligji nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 40, germa h, neni 42; UMFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësitve të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3.

Ndikimi/Efekti: Financimi i buxhetit kryesisht nga nga transfertat e fondeve nga pushteti qendror dhe në një masë të vogël nga të ardhurat e veta, realizim jo shumë i mirë i të ardhurave si dhe raportim jo i plotë i detyrimeve të papaguara.

Shkaku: Realizim jo i mjaftueshëm i të ardhurave, si dhe trashëgim i detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve në masë të konsiderueshme.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Tepelenë, nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe në bashkëpunim me Menaxherët e Programeve, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdeshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent të jenë sa më të argumentuara, si dhe të kujdesen për realizimin e projekteve të investimeve të planifikuara.

Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të palikuiduara të prapambetura dhe të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të asetëve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

➤ Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Për vitin 2022 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 79, datë 22.12.2021 dhe me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 191 datë 01.04.2020 “Për miratimin e strukturës, organigramës e Bashkisë Tepelenë, viti 2022”, ku përfshihet edhe struktura e Sektorit të Taksave dhe tarifave Vendore, si pjesë e Drejtorisë së Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila përbëhet nga 4 punonjës, 1 përgjegjës dhe 3 specialistë.

➤ Të dhëna mbi numrin e subjekteve, regjistrimet dhe mbylljet

Nga të dhënat e paraqitura nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tepelenë në lidhje me numrin e subjekteve aktiv, regjistrimeve të reja dhe atyre që kanë kërkuar mbyllje aktiviteti, rezulton se:

Për periudhën objekt auditimi, gjendja dhe ndryshimet mbi statusin e subjekteve paraqitet: **në vitin 2022** janë **481** subjekte biznesi, nga të cilat 355 subjekte të biznesit të vogël dhe 111 subjekte të biznesit të madh, Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Tepelenë në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur në Aneksin A1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2022, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Tepelenë është miratuar me VKB nr. 74, datë 28.12.2018, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tepelenë”, i ndryshuar me VKB nr. 81 datë 22.12.2019 dhe me VKB nr. 26 datë 30.04.2020. Referuar planit vjetor të miratuar dhe bazuar në akt-rakordimet me Degën e Thesarit Tepelenë, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për Bashkinë Tepelenë për vitin 2022 paraqitet i detajuar në Aneksin A2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për vitin 2022 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Tepelenë paraqitet në masën 84%, nga 62,000 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 52,313 mijë lekë. Në këtë realizim kanë ndikuar pagesat e debive të viteve të kaluara në vlerën 849 mije lekë dhe arkëtimi i gjobave. Gjithashtu në këtë realizim ka ndikuar dhe realizimi jo i pritshëm disa taksave dhe tarifave vendore për të cilat nuk është bërë i mundur planifikimi i saktë tyre si:

- Tatimi mbi të ardhurat personale i derdhur nga DTTV realizuar realizimi në masën 197%;
- Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë/pasuritë e paluajtshme realizimi në masën 9%;
- Taksa vjetore për qarkullimin e automjeteve të përdorura realizimi në masën 152%;
- Taksa e rentës minerare realizimi në masën 64%;
- Taksa mbi tatimin e thjeshtuar për biznesin e vogël në masën 3.2%;
- Tarifa të tjera (tele. Celulare, debitore, gjoba)realizimi në masën 109%.

Referuar Aneksit A2, konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulëta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet më shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon

negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Kështu:

a. Taksat dhe tarifatat e paraqitura me realizim mbi planin si:

- **Tarifa e menaxhimit të mbetjeve** (tarifë pastrimi biznes dhe familjarë) është realizuar 3,258 mijë lekë nga 2,994 mijë lekë e planifikuar ose në masën 108%,

- **Tarifa për shërbimet shitesë nga zjarrëfiksja**, është realizuar 13 mijë lekë nga 12 mijë lekë e planifikuar ose në masën 108%,

- **Tarifa për dhënie license për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj**, është realizuar 580 mijë lekë nga 0 mijë lekë e planifikuar.

- **Tarifa për zënie dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave**, është realizuar 984 mijë lekë nga 429 mijë lekë e planifikuar ose në masën 229%,

- **Tarifa për zënie dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave**, është realizuar 919 mijë lekë nga 520 mijë lekë e planifikuar ose në masën 176%,

- **Kundravajtjet administrative (Gjobat)**, është realizuar 301 mijë lekë nga 30 mijë lekë e planifikuar ose në masën 1000%,

b. Taksat dhe tarifatat e paraqitura me realizim të ulët të planit si:

- **Taksa mbi ndërtesën**, është realizuar 2,127 mijë lekë nga 520 mijë lekë e planifikuar ose në masën 45%,

- **Taksa mbi tokën bujqësore**, është realizuar 566 mijë lekë nga 721 mijë lekë e planifikuar ose në masën 78%,

- **Tarifa për gjelbërimin**, është realizuar 1,322 mijë lekë nga 1,558 mijë lekë e planifikuar ose në masën 84%,

- **Tarifa për ndriçimin publik**, është realizuar 1,305 mijë lekë nga 1,606 mijë lekë e planifikuar ose në masën 81%,

- **Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtitë të therura**, është realizuar 30 mijë lekë nga 1,305 mijë lekë e planifikuar ose në masën 81%,

- **Tarifa e licencimit të veprimtarive të transportit**, është realizuar 80 mijë lekë nga 90 mijë lekë e planifikuar ose në masën 88%,

- **Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë**, është realizuar 713 mijë lekë nga 1,115 mijë lekë e planifikuar ose në masën 63%.

➤ Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor;

Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2022 .

Në realizimin e ulët të të ardhurave, ka ndikuar **niveli i lartë e debitorëve**. Në bazë të përpunimit të të dhënave të regjistrimit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Tepelenë, rezultoi se ka nivel të lartë **debitorësh** në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin, individët, familjarët, (për taksën e ndërtesës, tabelës, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie, tarifa e qirasë për objekte, toka, pyje, dru zjarri, etj.), i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të **vitit 2021** vlera e debitorëve është **19,373,174 lekë** dhe në fund të **vitit 2022** vlera e debitorëve është **22,460,249 lekë**. Informacion më i detajuar lidhur me debitorët progresivë është paraqitur në Aneksin A3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku konstatohet se vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2021 është **17,431,036 lekë**, vlera e borxhit e krijuar **gjatë vitit 2022** është **1,733,167 lekë** dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive **në fund të vitit 2022** është **20,381,313 lekë**.

➤ Masat e marra për uljen e borxhit

Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Tepelenë është përgjegjës për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhëri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Sekuestrimi i pasurisë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet, rezulton se janë njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifatat vendore.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, janë nxjerrë urdhërat përkatës për të ndërmarrë masa të tjera bazuar në përcaktimet e kuadrit ligjor të sipërcituar. Përkatësisht, janë nxjerrë urdhërat që ju janë dërguar bankave të nivelit të dytë për bllokimin e llogarive bankare të 52 tatimpaguesve debitorë për vitin 2021 dhe 2 bllokime për vitin 2022.

Si rezultat i këtyre masave të marra, nga debitorët që rezultonin se gjatë vitit 2022 kanë likuiduar detyrimet ndaj bashkisë **54 subjekte në vlerën 2,919,685 lekë**.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9 pika 1.3 dhe neni 35, me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 3, pikat 9 dhe 10, me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 89, 90, 91 93 dhe 94, me Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshime, neni 181, etj.

➤ Akt marrëveshjet për pagesën me këste të detyrimeve

Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Bashkia Tepelenë ka lidhur marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura me disa subjekte debitorë që sqarohen më të detajuara në vijim. Aktmarrëveshjet e lidhura në vitin 2022 për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura, janë paraqitur në Aneksin A4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i zbatimit të kushteve të akt marrëveshjeve rezulton se, nuk kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes 3 subjekte me vlerë 1,119,565 lekë të cilat duhet të kishin shlyer këstet deri në dhjetor të vitit 2022. Nga Sektori i Tatim Taksave nuk janë marrë masa për zgjidhjen e marrëveshjes së pagesës me këste në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 78.

Përsa më sipër, ngarkohen më përgjegjësi: z. G.G. me detyrë inspektor në Sektorin e Tatim taksave dhe z. R.H. me detyrë me detyrë/inspektor në Sektorin e Tatim taksave.

Titulli i gjetjes: Mbi nivelin e borxhit tatimor në Bashkinë Tepelenë dhe masat e marra për uljen e tij.

Situata: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, u konstatua se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Vlera e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2021 është **17,431,036 lekë**, vlera e borxhit e krijuar **gjatë vitit 2022** është **1,733,167 lekë** dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive **në fund të vitit 2022** është **20,381,313 lekë**, e përbërë nga:

- Taksa e Tarifa vendore për Biznesin e Vogël në vlerën **8,836,111 lekë**;
- Taksa e Tarifa vendore për Biznesin e Madh në vlerën **10,922,734 lekë**;
- Taksa e Tarifa vendore për Institucione Shtetërore në vlerën **622,468 lekë**.

Kriteri: Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.3, neni 35, Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106, “Për sistemin e taksave vendore”, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreu XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 89, 90, 91, 93 dhe 94, Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshime, neni 181, etj.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Tepelenë.

Shkaku: Strukturat e Bashkisë Tepelenë nuk kanë respektuar përcaktimet e VKB-së për paketën fiskale duke mos ngarkuar familjet për detyrimet vendore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Tepelenë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2022.

a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Tepelenë, për moskalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

➤ Taksat dhe tarifave familjare

Në Bashkinë Tepelenë aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës. Sektori i Tatimeve nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve, që janë debitorë ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Tepelenë nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifave të tjera të miratuara me VKB, si për shembull taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifa e gjelbërimit. Bashkia Tepelenë ka si Agjent Tatimor për arkëtimin e tarifës së pastrimit dhe taksën e ndërtesës ShA Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë, e cila sipas aktakordimit me Bashkinë Tepelenë për të ardhurat rezulton se **deri në fund të vitit 2022** ka mbetur pa u derdhur Bashkisë **vlera në mënyrë progresive prej 16,397,158 lekë** nga vlera e deklaruar e maturimit prej 18,091,147 lekë. Ndërsa **vetëm për vitin 2022**, nga ShA Ujësjellës Kanalizime Tepelenë, **janë arkëtuar** detyrime për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit në **vlerën 4,169,582 lekë**, e cila nuk është derdhur për llogari të Bashkisë. Të dhënat për maturimet, derdhjet e kryera për llogari të Bashkisë si dhe detyrimet e pashlyera ndaj Bashkisë Tepelenë, sipas akt-rakordimit me ShA Ujësjellës Kanalizime Tepelenë, janë paraqitur në Aneksin A5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga ShA Ujësjellës Kanalizime Tepelenë nuk ka bashkëpunim me Bashkinë Tepelenë për shkëmbimin e të dhënave në lidhje me numrin e kontratave të lidhura me kryefamiljarët, sa nga këto i përkasin fashës së përjashtuar nga taksimi, sipas dispozitave ligjore dhe sa familje janë

debitorë nga mospagesat e detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore regjistron vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë, ndërsa për familjet debitore nuk ka një regjistër. Si rezultat, procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitore dhe vlera totale që ato kanë ndaj Bashkisë.

- Në Njësitë Administrative, për banesat të cilat nuk janë të lidhura me rrjetin e Ujësjellësit, taksa e banesës, tarifa e ndriçimit, gjelbërimit nuk faturohet dhe nuk është mbledhur nga Bashkia Tepelenë.

- Nga Administratorët e Njërive Administrative dhe punonjësit e taksave nëpër NJA nuk është kryer asnjë përpjekje dhe punë për evidentimin e familjeve që janë abonentë me Ujësjellësin dhe ato që nuk kanë kontrata me Ujësjellësin, si dhe sa familje nga ato të regjistruara në Gjendjen Civile jetojnë në fshatra., duke krijuar një *database* për tatimpaguesit me të dhënat e duhura për ngarkesën dhe faturimin me taksa dhe tarifave, detyrim ligjor për t'u paguar nga taksapaguesit për njësinë vendore në këmbim të shërbimeve që marrin nga shërbimet e Bashkisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr. 74, datë 28.12.2018, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tepelenë” i ndryshuar, me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me Ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me Ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117.

0699858776

Titulli i gjetjes: Mos ngarkim i familjeve për detyrimet vendore.

Situata: Në Bashkinë Tepelenë aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës. Sektori i Tatimeve nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve, që janë debitore ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Tepelenë nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifatat e tjera të miratuara me VKB, si për shembull taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifa e gjelbërimit. Bashkia Tepelenë ka si Agjent Tatimor për arkëtimin e tarifës së pastrimit dhe taksën e ndërtesës ShA Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë, e cila sipas aktrakordimit me Bashkinë Tepelenë për të ardhurat, rezulton se **deri në fund të vitit 2022** ka mbetur pa u derdhur Bashkisë **vlera në mënyrë progresive prej 16,397,158 lekë** nga vlera e deklaruar e maturimit prej 18,091,147 lekë. Ndërsa **vetëm për vitin 2022** nga ShA Ujësjellës Kanalizime Tepelenë **janë arkëtuar** detyrime për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit në **vlerën 4,169,582 lekë**, e cila nuk është derdhur për llogari të Bashkisë.

Kriteri: VKB nr. 74, datë 28.12.2018, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tepelenë” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 7, Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Tepelenë.

Shkaku: Strukturat e Bashkisë Tepelenë nuk kanë respektuar përcaktimet e VKB-së për paketën fiskale duke mos ngarkuar familjet për detyrimet vendore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Tepelenë nëpërmjet Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe NJA, të marrë masa për krijimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e

kategorisë “familjare” me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore, që ju linden familjeve referuar paketës fiskale të Bashkisë Tepelenë. Gjithashtu të shqyrtohet mundësia e arkëtimit të shumës së të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore të mbledhura nga agjenti tatimor ShA Ujësjetës Kanalizime Tepelenë. Nëse nuk është e mundur, të shikohet mundësia e ndëshkimit me gjobë sipas dispozitave ligjore në fuqi për detyrimin e paderdhur ndaj Bashkisë.

➤ Taksa mbi tokën bujqësore

Toka bujqësore në Bashkinë Tepelenë, sipas Aneksit 1 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, klasifikohet në kategorinë e pestë të bonitetit. Referuar VKB-së nr. 74 datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, klasifikimi i kategorisë së bonitetit dhe çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore në Bashkinë Tepelenë është paraqitur në Aneksin A6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi, u konstatua se në Bashkinë Tepelenë familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore si dhe Sektori i Tatimeve nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet dhe planifikohen të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, Aneksi 1 dhe me VKB nr. 74 datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, pika 4/4.

Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore, janë rastet kur fermerët paraqiten në bashki apo NJA në mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifave vendore apo për të marrë shërbime dhe nga Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe ju mbahet edhe taksa e tokës me vlerë 1,100 lekë/ha/vit, kur bashkia ka të dhëna.

Nga NJA nuk disponohen regjistrat e saktë të tokës me të dhënat e sipërfaqeve dhe cilësisë së tokave (kategorizimi), si dhe marrëdhëniet juridike më të, pra statusi i pronësisë për të gjitha familjet fermere, gjë që është e domosdoshme për të patur të dhëna të sakta për bazën e taksueshme dhe për një planifikim të taksës së tokës mbi baza reale. Nga specialistët e tatimeve në NJA nuk ngarkohen familjet fermerë me taksën e tokës sipas kategorisë dhe nivelin e taksës përkatëse të përcaktuar në paketën fiskale.

Përsa më sipër ngarkohen më përgjegjësi: z. G.G. me detyrë/inspektor në Sektorin e Tatim taksave, z. R.H. me detyrë me detyrë/inspektor në Sektorin e Tatim taksave, z. F.K. me detyrë Administrator i NJA Qytet, z. L.Sh. me detyrë Administrator NJSA Qendër, z. Sh.L. me detyrë Administrator i NJA Kurvelesh dhe z. A.O. me detyrë Administrator i NJA Lopës.

Titulli i gjetjes: Mos ngarkesë e familjeve në Bashkinë Tepelenë për taksën e tokës bujqësore.

Situata: Nga auditimi u konstatua se *taksa mbi tokën bujqësore* është realizuar 566 mijë lekë nga 721 mijë lekë e planifikuar ose në masën 78%. Për taksën bujqësore nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta për planifikimin e saj mbi baza reale. Në Bashkinë Tepelenë, familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore si dhe Sektori i Tatimeve nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve, që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqen e tokës bujqësore, që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet edhe taksa e tokës bujqësore. Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore, janë rastet kur qytetarët paraqiten në bashki në mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifave vendore apo për të marrë shërbime, ku nga Sektori i Taksave dhe Tarifave ju mbahet edhe taksa e tokës me vlerë 1,100 lekë/ha/vit për tokë të kategorisë VII-X.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, Aneksi 1 dhe VKB nr. 74 datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, pika 4/4.

Ndikimi/Efekti: Bashkia Tepelenë nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që zotërojnë tokë bujqësore dhe sa është sipërfaqja që duhet të tatohet referuar paketës fiskale, duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë.

Shkaku: Mosangazhim i strukturave të bashkisë për të krijuar regjistrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Tepelenë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë, të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve, referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Tepelenë.

➤ **Taksa e ndikimit në infrastrukturë**

Në Bashkinë Tepelenë struktura që administron dokumentacionin dhe përllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë është Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës dhe Sektori i Tatimeve.

Nga auditimi i ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, rezulton se në Bashkinë Tepelenë ka detyrime të papaguara për objekte, që janë legalizuar që nga viti 2015 deri në 31.12.2021 në vlerën **1,942,139 lekë për 64 objekte**. Nga korrespondenca zyrtare e Bashkisë Tepelenë me ASHK në vitin 2022 rezulton se:

- **Për vitin 2022** janë kryer 15 legalizime me vlerën e taksës së infrastrukturës të përllogaritur 545,206 lekë, ku **janë debitorë 6 individë në vlerën 136,798 lekë**, ndërsa në vlerë progresive deri në 31.12.2022 **është 2,078,937 lekë**, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, VKB nr. 74, datë 28.12.2018 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore", i ndryshuar, pika 2/b.

Në mënyrë të detajuar, debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale deri në fund të vitit 2022 janë paraqitur në Aneksin A7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Titulli i gjetjes: Mosarkëtim i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit financiar të pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, rezulton se në Bashkinë Tepelenë ka detyrime të papaguara për objekte, të legalizuara që nga viti 2015 deri në 31.12.2021, në vlerën **1,942,139 lekë për 64 objekte**. Nga korrespondenca zyrtare e Bashkisë Tepelenë me ASHK për periudhën objekt auditimi, rezultoi se **për vitin 2022** janë kryer 15 legalizime me vlerën e taksës së infrastrukturës të përllogaritur 545,206 lekë, ku **janë debitorë 6 individë në vlerën 136,798 lekë**, ndërsa deri në 31.12.2022 në vlerë progresive debitorë **është 2,078,937 lekë**, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, VKB nr. 74, datë 28.12.2018 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore", i ndryshuar, pika 2/b.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Tepelenë nga mosarkëtimi i vlerës prej **2,078,937 lekë** për ndërtimet e reja që legalizohen.

Shkaku: Mosmarrje e masave efektive nga Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës dhe Sektori i Tatimeve të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Tepelenë të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 70 debitorë në vlerën 10,620,347 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Tepelenë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen, si dhe të bëhen marrëveshje për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

➤ **Të ardhura të munguara nga mospagesa e qirave të kontratave të aseteve.**

Bashkia Tepelenë për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre, ka lidhur 30 kontrata për dhënien me qira të aseteve që i kanë kaluar me VKM nga pushteti qendror. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizikë/juridikë që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 1-30 vjet. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, për aktivitet bujqësor, për pemtari, Antena, agroturizëm etj. Kontratat e lidhura me të dhënat e detajuar për to, detyrimet, pagesat dhe debitë e qiramarrësve janë paraqitur në Aneksin A8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku rezulton se në fund të vitit 2022 paraqiten 16 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në **vlerën 3,708,676 lekë të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë**. Detyrimi i krjuar i papaguar për vitin 2022 është 2,874,456 lekë. Nga strukturat e bashkisë nuk janë veprime të mjaftueshme për evidentimin e problematikave dhe ndërmarrjen e hapave për negociime me qiramarrësit debitorë si dhe në kushtet e mosmarrëveshjeve ndërmarrjen e veprimeve ligjore për prishjen e në mënyrë të njëanshme të kontratave me qiramarrësit që nuk paguajnë detyrimet për tarifën e qirave.

Gjithashtu, për qiramarrësit debitorë nuk janë përlllogaritur dhe nuk janë aplikuar kamatëvonesa prej 0.01% për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës.

Këto veprime janë në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkëtesë, neni 5 “Pagesa e tarifës së qirasë”.

Përsa më sipër ngarkohen më përgjegjësi: z. G.Sh. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Rural, z. H.Z. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, Mbrojtjes së Tokës dhe Ujërrave, si dhe Administratorët e NJA: z. F.K. NJA Qytet, z. L.Sh., NJA Qendër, z. Sh.L., NJA Kurvelesh dhe z. A.O., NJA Lopës.

Titulli i gjetjes: Të ardhura të munguara nga mospagesa e qirave nga qiramarrësit e aseteve sipas kontratave të lidhura me Bashkinë Tepelenë.

Situata: Bashkia Tepelenë për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre, ka lidhur 30 kontrata për dhënien me qira të tyre. Nga të dhënat e nxjerra nga dokumentacioni i dosjeve dhe ai financiar, rezulton se në fund të vitit 2022 paraqiten 16 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në **vlerën 3,708,676 lekë të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë**. Detyrimi i krjuar i papaguar vetëm për vitin 2022 është 2,874,456 lekë. Gjithashtu,

për qiramarrësit debitorë nuk janë përllogaritur dhe nuk janë aplikuar kamatëvonesa prej 0.01% për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës. Nga strukturat e Bashkisë nuk janë kryer veprime të mjaftueshme për evidentimin e problematikave dhe ndërmarrjen e hapave për negociime me qiramarrësit debitorë për pagesat me këste apo marrjen e masave për anulimin e kontratave.

Kriteri: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe kontratat përkëtesë, neni 5 “Pagesa e tarifës së qirasë”.

Ndikimi/Efekt: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Tepelenë nga mosarkëtimi i detyrimeve nga qiramarrësit.

Shkaku: Strukturat e Bashkisë Tepelenë nuk kanë qenë efektive në mbledhjen e detyrimeve të qirave nga subjektet qiramarrëse si dhe nuk kanë respektuar përcaktimet ligjore për dhënien me qira të aseteve të tyre.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Tepelenë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës që lind nga mospagesa e kontratave të qirasë për 16 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në **vlerën 3,708,676 lekë** dhe kamatëvonesat për vonesat në pagesa, referuar kushteve të kontratave. Nga strukturat e Bashkisë të merren masa për evidentimin e problematikave dhe ndërmarrjen e hapave për negociime me qiramarrësit debitorë, si dhe në kushtet e mosmarrëveshjeve, të ndërmarrë veprime ligjore për prishjen në mënyrë të njëanshme të kontratave me qiramarrësit, që nuk paguajnë detyrimet për tarifën e qirave.

➤ **Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve**

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit, rezultoi se Bashkia Tepelenë ka pajisur rast pas rasti me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe ka hartuar akt marrëveshje me to lidhur me pagesën e detyrimit për autorizimin. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Në territorin e Bashkisë Tepelenë për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 6 subjekte të paraqitura në Aneksin A9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Referuar dosjeve të 6 subjekteve që operojnë në territorin e Bashkisë Tepelenë për shitje me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tij, konstatohet se kanë detyrime të papaguara 4 subjekte në vlerën 2,280,000 lekë, ku në 3 raste nuk kanë paguar në vlerë të plotë detyrimin e përcaktuar në dispozita ligjore dhe në 1 rast nuk është paisur me autorizim, pavarësisht se ushtron aktivitetin. Konkretisht:

- Subjektit B. ShPK i ka mbaruar afati i autorizimi/licenca që në vitin 2020, e shoqëruar dhe me një debi të hershme prej 100,000 lekë, të cilën nuk e ka rivotuar dhe ka vazhduar aktivitetin në tregtimin e hidrokarbureve në mungesë të autorizimit dhe si pasojë ka sjellë të ardhura të munguara në vlerën 1,100,000 lekë.

- Subjekti O. ShPK është pajisur me autorizim për vitet 2018-2023, ka paguar 620,000 lekë dhe është debitor për detyrimin në shumën 380,000 lekë.

- Subjekti S.G. ShPK është pajisur me autorizim për vitet 2018-2023, ka paguar 200,000 lekë dhe është debitor për detyrimin në shumën 800,000 lekë, por në fakt për vitin 2022 ky subjekt e ka mbyllur aktivitetin.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, nenet 4, 15 dhe 20 pikat 2 dhe 11 dhe me VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, Kreu II, pika 3.

Përsa më sipër ngarkohen më përgjegjësi: z. G.G. me detyrë/inspektor në Sektorin e Tatim taksave dhe z. R.H. me detyrë me detyrë/inspektor në Sektorin e Tatim Taksave.

Titulli i gjetjes: Mbi pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit të subjekteve që tregtojnë lëndë djegëse dhe pagesat e tarifave.

Situata: Nga auditimi, rezultoi se Bashkia Tepelenë ka pajisur rast pas rasti me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe ka hartuar akt marrëveshje me to lidhur me pagesën e detyrimit për autorizimin. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Në territorin e Bashkisë Tepelenë për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 6 subjekte nga të cilat 4 subjekte konstatohet se kanë detyrime të papaguara në vlerën 2,280,000 lekë, ku në 3 raste nuk kanë paguar në vlerë të plotë detyrimin e përcaktuar në dispozitat ligjore dhe në 1 rast nuk është paisur me autorizim.

Kriteri: Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, nenet 4, 15 dhe 20 pikat 2 dhe 11 dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, Kreu II, pika 3.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Tepelenë.

Shkaku: Puna jo efektive e Sektorit të Tatim Taksave në identifikimin në kohë të përfundimit të afateve të autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit si dhe mosndjekja e hapave ligjorë për subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet pa autorizim.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin e subjektit B. ShPK dhe të marrë masa që ky subjekt të pajiset menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur prej 1,000,000 lekë ndaj Bashkisë Tepelenë për 5 vjet, që nga data e mbarimit në vitin 2022. Gjithashtu, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë rregullisht pagesat periodike dhe të prapambetura të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera, me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

- 2.3. **Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi**
- 2.3.1. *Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.*
- 2.3.2. *Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.*
- 2.3.3. *Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.*
- 2.3.4. *Auditim mbi administrimin e asetëve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.*
- 2.3.5. *Auditim mbi administrimin e asetëve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.*

➤ Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:
Për vitin 2022, njësia shpenzuese “Bashkia Tepelenë”, për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

➤ Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.
Bashkia Tepelenë për vitin 2022 nuk ka hartuar Pasqyra Financiare të Konsoliduara, sepse nuk ka në varësi njësi shpenzuese me NUIS më vete, pasi Agjencia e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsim Kulturës i janë bashkuar Aparatit të Bashkisë në vitin 2020.

➤ Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare
Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Tepelenë për vitin ushtrimor 2022 me shkresën përcjellëse nr. 358 prot., datë 14.02.2023. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Tepelenë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Përgjegjësi i Financës. Pra në këtë rast nuk kemi delegime të detyrave.

➤ Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.
Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor, rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

➤ Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitja e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për t’u siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi, u kryen teste në regjistrimet në ditaret kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mosndryshueshmërinë e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

- kontrollit të vlefshmërisë së një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti, duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

➤ Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë elektronike në programin “Excel”.

- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Përditësimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Është mbajtur centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditaret në centralizator deri në bilancin vërtetues. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

- Në tërësi, organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentave bazë dhe justifikues, është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmbajnë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhërat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

➤ Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të bashkisë për aktivitetin ekonomiko-financiar nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022. Nga grupi i auditimit është logaritur vlera e materialitetit, e cila ka rezultuar 5,731 mijë lekë për shpenzimet dhe 847 mijë lekë për të ardhurat.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit;

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar;

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme;

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël;

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura;

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës:

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë;

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe obligimet e subjektit;

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar dhe detyrimet janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra janë të paraqitura të plota në bilanc;

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitet, pasivet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese:

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit;

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë;

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur dhe përshkruar në mënyrë të përshtatshme, si dhe janë mbajtur shënimet shpjeguese, të cilat shprehin paqartësitë e ndodhura;

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi janë dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur;

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022, rezultoi se llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse, pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduar, veprime të paraqitura në me Formatin nr. 5 “Pasqyra e lëvizjes në cash viti 2022”

Totali i Aktivit për vitin 2022 është 2,434,164,978 lekë. Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Tepelenë në datën 31.12.2022, sipas Formatit nr. 1 i PF është paraqitur në Aneksin PF2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

I. Aktivet Afatshkurtra

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 14,411,297 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “Teprica e likuiditeteve në fund të vitit

ushtrimor” në Formatin nr. 3 “*Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte*”, të paraqitur në Aneksin PF3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas bilancit në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 14,411,297 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr. 5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2022”.

Klasa 3 “Gjendja e inventarit qarkullues”, e aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 19,111,677 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 18,615,766 lekë, ku diferenca e tyre në ulje në vlerën prej 495,911 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në Formatin nr. 2 “*Pasqyra e performancës financiare*”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”, paraqitet paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,731,115 lekë dhenë mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,411,158 lekë, me një diferencë në ulje për vitin ushtrimor prej -1,319,957 lekë, e cila përfaqëson pakësim të gjendjes së mallrave në fund të vitit 2022.

Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët”, paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 16,380,562 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 17,204,608 lekë, me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 827,046 lekë, e cila përfaqëson rritje të inventarit të imët për vitin 2022.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme”, paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 133,718,423 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 137,905,534 lekë, ku kemi shtesë duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i rritjes së detyrimeve të debitorëve të ndryshëm.

Gjendja e llogarisë 423, 429 “Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba”, në aktiv të bilancit paraqitet si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,254,774 lekë, vlerë e cila përfaqëson debitorë për detyrime të lëna nga ish-Auditi i Prefekturës për paradhënie dieta për punonjësit e Bashkisë Tepelenë, që para vitit 2010. Për gjendjen e kësaj llogarie ekziston lista e ish-punonjësve debitorë të cilët janë të larguar apo nuk ka adresë. Në këtë situatë këta debitorë janë pa shpresë arkëtimi, pasi përveçse mungojnë të dhënat për ta, por edhe ka kaluar koha e kërkimit dhe ndjekjes së procedurave ligjore për realizimin e arkëtimit të vlerës së këtyre detyrimeve.

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 144,770,921 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 150,593,337 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka pësuar një rritje prej 5,822,416 lekë. Në vlerën e lartë të llogarisë së debitorëve ka ndikuar dhe gjendja e debitorëve të taksave prej 60,415,945 lekë, që zënë 40,1% të vlerës debitorë. Pjesa tjetër janë detyrimet e lindura nga rekomandimet “shpërblim dëmi” të lëna nga KLSH në vite, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërkimit. Analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës, është paraqitur në Aneksin PF4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operatione me shtetin (të drejta)”, në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në shumën 27,147,963 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2022, që trashëgohen në vitin 2023. Kjo gjendje ka në analizë ose përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llogaria 401-404 “Furnitore e llogari te lidhura me to” në vlerën 5,544,358 lekë, llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 9,224,232 lekë, llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 501,183 lekë, llogaria 435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 2,570,834 lekë, llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 351,714 lekë dhe vlerën pjesore prej 8,955,642 lekë të llogarisë

“Kreditorë të ndryshëm” të planifikuar për likuidim në vitin 2023. Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” pasqyron detyrimet afatshkurtra, duke u debituar në kredi të llogarive kundërpartit në pasiv të Bilancit, pasi kjo llogari përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

Gjendja e llogarisë 49 “Shumat e parashikuara për zhvlerësime”, në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën - 41,381,911 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën - 41,090,540 lekë, vlerë e cila përfaqëson vlerë e cila përfaqëson detyrimet e debitorëve të krijuar mbi 10 vjet nga rekomandimet e dhëna nga auditimet e Prefekturës dhe KLSH, (në këtë vlerë nuk përfshihen debitorët për taksa e tarifa vendore dhe qiradhëniet) të vlerësuar pa shpresë arkëtimi për mungesë adresimi si dhe të gjobave për kundravajtje me tejkalim të afatit të parashkrimit, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga:

Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 26,173,384 lekë, vlerë e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, ku në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 28,229,661 lekë. Për detyrime të prapambetura ndaj të tretëve debitohet llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, ku vlera e mosrakordimit prej 2,056,277 lekë përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve të krijuara në dhjetor të vitit ushtrimor 2022, që nuk u ka kaluar afati 30 ditor i pagesës dhe pritët të paguhen në janar të vitit pasardhës 2023.

II. Aktive Afatgjata Materiale

1. Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivët ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuar në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve afatgjata materiale, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve afatgjata materiale në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivët afatgjata materiale;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranura dhe udhëzimeve përkatëse.

- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivët e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Për Aktivët e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për t'u siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;

- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifikë, etj.);

- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në Formatin nr. 1, "Aktivet Afatgjata" në aktiv të bilancit, në mbyllje të vitit 2021 paraqiten në vlerën 2,106,059,234 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,237,058,997 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,303,909,007 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,666,913,128 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 "Aktive Afatgjata jo materiale" që përbëhet nga:

Gjendja e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime", në aktiv të bilancit, në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 352,003 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)", në mbyllje të vitit 2021 gjendja paraqitet në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 352,003 lekë. Kjo llogari i përket projektit "Studimi, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale", vlerë e shtuar gjatë vitit 2022. Ky projekt është bërë hyrje dhe ruhet në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban dhe Arshivën e Institucionit.

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2022.

Në Formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) "Aktivet afatgjata materiale" në mbyllje të vitit 2021 paraqiten në vlerën 1,932,526,987 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 2,236,706,994 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,303,909,007 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,666,561,125 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

Gjendja e llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene", në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 194,554,524 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 269,805,883 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" si në mbyllje të vitit 2021 është 194,554,524 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 269,805,883 lekë, pasi ka shtesa gjatë vitit 2022 në shumën prej 75,251,359 lekë për shkak të regjistrimit të pronave në ASHK. Këto gjendje paraqiten të analizuara sipas vlerës bruto në Aneksin PF5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 211 "Pyje, Plantacione", në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 660,589,298 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 834,513,598 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 660,589,298 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 834,513,598 lekë. Shtesa prej 173,924,300 lekë ka rezultuar nga regjistrimi i pronave në ASHK. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie është paraqitur në Aneksin PF6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”, në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 322,533,722 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 312,012,841 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr. 7/B në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 430,166,088 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 436,066,935 lekë. Gjatë vitit 2022 janë krijuar aktive shtesë në vlerën 5,900,847 lekë, ku vlera prej 3,000,000 lekë nga rritja e AAGJM me pagesë si: rikonstruksione shkollash, kopshtesh, banja publike etj. dhe shtesë pa pagesë nga jashtë sistemit në vlerën 2,900,847 lekë, që përfaqëson kalimin kapital Bashkisë Tepelenë nga Ministria e Shëndetësisë “*Rikonstruksioni i godinave të Qendrave Shëndetësore*”. Pakësimet janë në vlerën 0 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet për vitin 2022 është paraqitur në Aneksin PF7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 727,482,471 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 793,031,633 lekë, ku diferenca prej 65,549,162 lekë është amortizimi i llogaritur për vitin 2022. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr. 7/B në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 952,596,041 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,054,594,327 lekë. Gjatë vitit 2022 janë bërë shtesat në vlerën 101,998,286 lekë, e cila përfaqëson investime të kryera me pagesë brenda sistemit në rrugë, kanale vaditëse, ujësjellës etj. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet për vitin 2022 është paraqitur në Aneksin PF8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 6,584,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 6,254,800 lekë, ku diferenca është amortizimi i perlllogaritur i vitit ushtrimor për këtë grup aktivesh. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr. 7/B në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 11,738,947 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 11,738,947 lekë, për të cilat ka inventar fizik. Në këtë grup aktivesh nuk ka as shtesa dhe as pakësime për vitin 2022. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie në vitin 2022 është paraqitur në Aneksin PF9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”, në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 3,831,206 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 6,466,964 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr. 7/B në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 18,353,189 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 22,605,689 lekë. Shtesat gjatë vitit 2022 përfaqësojnë blerjen e një mjete teknologjik pastrimi për Agjencinë e Punëve Publike me vlerë 4,252,500 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve në fund të vitit 2022 janë paraqitur në Aneksin PF10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”, në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 16,951,766 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 14,621,275 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/B “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*” në mbyllje të vitit 2021 gjendja paraqitet në vlerën 35,910,920 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 37,235,746 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 1,769,870 lekë e pajisjeve, për të cilat janë ndjekur procedurat financiare e ligjore për evidentimn e tyre. Pakësimet janë në vlerën 445,044 lekë, që përfaqësojnë sistemim në aktivet e inventarit ekonomik.

Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2022 janë paraqitur në Formatin nr. 7/a “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, në Aneksin PF11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale paraqitet në bilanc në vlerën 429,854,131 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në Formatin nr. 7, kolona 9.

Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, pika

36. Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.

➤ Inventarizimi i aktiveve për vitin 2022 Bashkia Tepelenë

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2022 për Bashkinë Tepelenë dhe Njësitë Administrative në varësi.

Për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2022, ka dalë nga titullari urdhëri nr. 200/1 prot., datë 05.12.2022 “Për ngritjen e komisioneve të inventarizimit për vitin 2022”. Janë mbajtur procesverbale nga çdo komision. Është mbajtur relacion shpjegues për gjendjen e llogarive si dhe procesverbale për propozim për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve që kanë humbur funksionin e tyre. Të gjitha proceset e kryerjes së inventareve për vitin 2022 janë me dokumentacion bashkëlidhur. Për vitin 2022 nuk janë nxjerrë aktive afatgjata jashtë përdorimit.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit, rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventareve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Tepelenë dhe për Njësitë Administrative në varësi. Fletët e inventareve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit materialë brenda muajit dhjetor 2022 dhe rezultojnë pa diferenca. Është hartuar një relacion përmbledhës për gjithë inventarin e AAGJM, ku përshkruhen mënyra e ruajtjes së këtyre aktiveve dhe konfirmimi i rezultatit të inventarit.

Konkluzion: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2022 në vlerën **2,666,913,128** lekë është paraqitur e plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grupi të aktivitetit. **Inventari kontabël i aktiveve materiale** gjendje në fund të vitit 2022 në llogaritë: **210 “Toka, Troje, Terrene”** është në vlerën 269,805,883 lekë; **211 “Pyje, Plantacione”** në vlerën 834,513,598 lekë, **212 “Ndërtesa Konstruksiione”** në vlerën 436,066,935 lekë; **213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** në vlerën 1,054,594,327 lekë; **214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerën 11,738,947 lekë. Në këto inventare ka në ndonjë rast në çdo grup aktivesh emërtesa të paplota, si dhe janë përditësuar bruto të gjitha investimet e kryera për të gjithë aktivitet brenda llojit, sipas emërtesave të projekteve të investimeve, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv për një pjesë të AAGJM si dhe, siç duhet t’i ketë të evidentuar një regjistër format i plotë i aktiveve në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III, pika 30 dhe me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, dhe me Nomenklaturën e Llogarive të planit kontabël publik.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë **231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”**, në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se ka kontrata që kanë përfunduar si punime, por likuidimi është shtrirë në 2-3 vite ushtrimore, për të cilat janë kryer pagesa pjesore sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Nga auditimi i kontabilizimeve të veprimeve ekonomike për kontratat e investimeve me shtrirje kohore likuidimi përtej vitit ushtrimor, rezulton se llogaria 231 “Shpenzime për investime në proces” është debituar dhe kredituar për vlera pjesore të paguara, duke e mbyllur këtë llogari në mënyrë të gabuar pa u kapitalizuar aktivi deri në vlerë të plotë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, pasi në fund të vitit 2022, konstatohet se 11 kontrata investimesh kanë mbetur pa u mbyllur për vlerën 190,841,000 lekë, ndërsa vlera pjesore prej 245,018,000 lekë e financuar për këto projekte,

duhet t'i përkiste gjendjes debitoare llogaria 231 "Shpenzime për investime në proces" në datën 31.12.2022. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Aneksi 1, Pika 2 Klasa 2, si dhe Kreu I, pika 8, Kreu II, pika 15/a, b, c, 18/a, b, Kreu III, pika 32.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimet e bëra në llogarinë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT".

Situata: Gjendja e llogarisë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT", në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se ka kontrata që kanë përfunduar si punime, por likuidimi është shtrirë në 2-3 vite ushtrimore, për të cilat janë kryer pagesa pjesore sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Nga auditimi i kontabilizimeve të veprimeve ekonomike për kontratat e investimeve me shtrirje kohore likuidimi përtej vitit ushtrimor, rezulton se llogaria 231 "Shpenzime për investime në proces" është debituar dhe kredituar për vlera pjesore të paguara, duke e mbyllur këtë llogari në mënyrë të gabuar pa u kapitalizuar aktivi deri në vlerë të plotë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, pasi në fund të vitit 2022, konstatohet se 11 kontrata investimesh kanë mbetur pa u mbyllur për vlerën 190,841,000 lekë, ndërsa vlera pjesore prej 245,018,000 lekë e financuar për këto projekte, duhet t'i përkiste gjendjes debitoare llogaria 231 "Shpenzime për investime në proces" në datën 31.12.2022.

Kriteri: Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Aneksi 1, Pika 2 Klasa 2, si dhe Kreu I, pika 8, Kreu II, pika 15/a, b, c, 18/a, b, Kreu III, pika 32.

Ndikimi/Efekti: Mosevidentim dhe kontabilizim jo i saktë i AAGJM të blera deri në kapitalizimin e tyre.

Shkaku: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka bërë kontabilizimin direkt në llogarinë AAGJM me vlera pjesore të paguara, ndërkohë kur aktivi nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë të kontratës, pa e kontabilizuar në llogarinë e ndërmjetme 231 "Shpenzime për investime në proces" deri në momentin e kapitalizimit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë, të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet t'i evidentojë ato në llogaritë 230-231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 170,890,087 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

Gjendja e llogarisë 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikuiduara. Gjendja e kësaj llogarie në pasiv të bilancit mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 25,457,997 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 5,544,358 lekë, vlerë e cila ka ardhur në ulje, duke paguar faturat e palikuiduara për mallra, shërbime dhe investime të periudhës së fundvitit ushtrimor. Sipas analizës të gjendjes së kësaj llogarie, rezulton se, përbëhet nga 13 fatura të palikuiduara ndaj të tretëve, borxh i krijuar në nëntor-dhjetor të vitit 2022, ku në mënyrë të detajuar është paraqitur në Aneksin PF12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 9,224,232 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listëpagesave të punonjësve të muajit dhjetor për pagat që do të paguhen në janar të vitit 2023.

Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën kontabël 501,183 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listëpagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2023.

Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 2,570,834 lekë, të llogaritura për t’u paguar në muajin pasardhës e analizuar si vijon:

b. Sigurimet shoqërore 15% punëdhënësi vlera 2,570,834 lekë.

Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore” në fund të vitit 2022 është në vlerën kontabël 351,714 lekë, e cila përbëhet nga:

a. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëmarsi vlera 175,857 lekë.

b. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëdhënësi vlera 175,857 lekë.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 111,655,654 lekë, e cila nuk rakordon për vlerën 898,083 lekë me gjendjen e debitorëve në llogaritë e klasës 4 në aktiv të bilancit në vlerën 110,757,571 lekë përkatësisht: (gjendja e llogarisë 468 “debitorë të ndryshëm” në vlerën 150,593,337 lekë + gjendja e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën 1,254,774 lekë - gjendja e llogarisë 49 “Shuma të parashikuara për zhvlerësim” në vlerën 41,090,540 lekë). Vlera prej 898,083 lekë nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson dhe i ka fillesat që në konsolidimin e PF të Bashkisë me Ish-Komunat nga Reforma administrative territoriale, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 15/b, 59/a, Kreu III, pika 32, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, pika 3.3., “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”, nënpika 8.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimet e bëra në llogarinë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”.

Situata: Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 111,655,654 lekë, e cila nuk rakordon për vlerën 898,083 lekë me gjendjen e debitorëve në llogaritë e klasës 4 në aktiv të bilancit në vlerën 110,757,571 lekë. Vlera prej 898,083 lekë nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson dhe i ka fillesat që në konsolidimin e PF të Bashkisë me Ish-Komunat nga Reforma administrative territoriale.

Kriteri: Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu II, pika 15/b, 59/a, Kreu III, pika 32, Aneksi 1, pika 3.3., “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”, nënpika 8.

Ndikimi/Efekti: Moskontabilizim i saktë i detyrimeve në llogaritë e klasës 4.

Shkak: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar nuk ka saktësuar vlerën e debitorëve në aktiv të bilancit për vlerën 898,083 lekë.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë, të shqyrtojë veprimet kontabël të kryera në librat e kontabilitetit, për nxjerrjen e shkakut të deviacionit në vlerën 898,083 lekë të veprimeve ekonomike të ndodhura me debitorët në vite dhe më pas të kryhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet në llogaritë e klasës 4, duke i reflektuar përfundimisht në pasqyrat financiare të vitit 2023.

Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 12,812,451 lekë. Për këtë gjendje të llogarisë 466 është bërë rakordimi në degën e Thesarit Tepelenë, ku në mënyrë analitike është paraqitur në Aneksin PF13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të të vonesave të krijuara në kryerjen e procedurave të prokurimit, në lidhjen e kontratave apo në mbërritjen me vonesë të faturave dhe si rezultat i bllokimit të transaksioneve financiare nga MFE në ditët e fundit të dhjetorit të vitit ushtrimor. Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 13,722,520 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 28,229,661 lekë, me një diferencë në rritje prej 14,507,141 lekë në krahasim me vitin 2021. Nga analiza e kësaj gjendje, rezulton se janë kryesisht detyrimet e krijuara nga moslikuidimi i faturave për shpenzime të muajve nëntor-dhjetor 2022 dhe detyrimet e prapambetura. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie është paraqitur në Aneksin PF14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Analiza e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve, me klasifikim sipas natyrës ekonomike, të pasqyruara në Formatin nr. 2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2022, është paraqitur në Aneksin PF15, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 52,313,157 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Tepelenë paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”, për vitin 2022 paraqitet në bilanc në vlerën **23,132,829** lekë, e cila kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë analitike 7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”, pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 1,090,762 lekë, e cila përfshin taksën mbi Biznesin e vogël, rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

Gjendja e llogarisë 7020 “Tatim mbi pasurinë e palujtshme”, pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 3,337,882 lekë, e cila përfshin taksën mbi ndërtesën dhe truallin, rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

Gjendja e llogarisë 7035 “Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”, për vitin 2022 pasqyrohet në bilanc në vlerën 18,687,932 lekë, e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qirate për truallin.etj.

Gjendja e llogarisë 71 “Të ardhurat jo tatimore”, paraqitet në bilancin e vitit 2022 në vlerën 20,440,729 lekë, kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë 7109 “Të ardhura të tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”, paraqitet në bilancin e vitit 2022 në vlerën 7,783,096 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë 711 “Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare”, paraqitet në bilancin e vitit 2022 në vlerën 1,475,920 lekë, e cila përfshin tarifën e parkimit, kamatvonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, është në vlerën 27,147,963 lekë, e cila rakordon me gjendjen e llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në aktivin e bilancit, pasi kjo gjendje pasqyron detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

Analiza e shpenzimeve në vitin 2022 , të cilat në total janë në vlerën 231,352,626 lekë paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë 600 “Paga, shpërblime e të tjera personeli”, për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 129,733,568 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 128,396,689 lekë. Diferenca është 1,336,879 lekë.

Gjendja e llogarisë 601 “Kontribute për sigurime”, për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 17,412,441 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 17,175,996 lekë, diferenca 236,445 lekë.

Gjendja e llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime”, paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 84,206,617 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 88,430,609 lekë, diferenca - 4,223,992 lekë.

Gjendja e llogarisë së fondeve 604 “Transferime korente te brendshme”, paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 8,737,930 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 8,737,930 lekë, diferenca nuk ka.

Gjendja e llogarisë së fondeve 606 “Transferime per buxhetet familjare e Individe”, paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 132,887,472 lekë, e cila rakordon me aktrakordimin me Thesarin.

Për vitin 2022 totali i të ardhurave në vlerë është 375,072,785 lekë dhe totali shpenzimeve është 373,473,939 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 1,598,846 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultati i ushtrimit”.

Gjithashtu, ***gjendja e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”***, është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2022 është në vlerën 495,911 lekë.

➤ **Formati nr. 6 “Investimet dhe burimet e financimit”**

Zëri “Burimet për investime”, Formatin 6, i plotësuar për shumën 363,449,165 lekë në analizë tregon burimet e investimit, vlera prej 111,020,656 lekë fonde të akorduara për investime, vlera prej 252,428,509 lekë investime të dhuruara nga donatorë vendas.

Zëri “Shpenzime per Aktive Afatgjata materiale”, formati 6 e plotësuar për shumën 111,020,656 lekë, në analizë rakordon me pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata”, kolona 4, formati 7/b.

➤ **Nga testi i kontrollit për vitin 2022, në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:**

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve. Gjendja e arkës nuk e kalon limitin e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit. Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kreut III, pika 34 dhe 35 gjerat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të Ligjit nr. 290, datë 14.06.1993 “Për limitin e arkës”.

➤ **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues, të konfirmuara nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listëpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore, rezultoi se totali është i barabartë me shumën totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- Pagesat e kryera jashtë afatit 30 ditë të paraqitjes së faturës.

Titulli i gjetjes: Mbi pagesat nëpërmjet bankës të faturave të mbërritura mbi afatin 30 ditor.

Situata: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2022 me urdhër-shpenzime në **99** raste faturash, me vlerë 30,089,049 lekë lekë, mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime/investime të mbërritura në Bashkinë Tepelenë, ku 92 raste në vlerën 24,718,349 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për mallra e shërbime llogaria 602 “shpenzime operative” dhe në 7 raste në vlerën 5,370,700 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për investime llogaria 231 “investime”, ku në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mbërritje me vonesë e faturave apo realizim me vonesë i punimeve.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52, Ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 44 “Kontrolli i shpenzimeve”.

Ndikimi/Efekti: Moslikuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të palikuiduara.

Shkaku: Likuidim me vonesë i faturave në tejkallim të afatit ligjor prej 30 ditësh i pjesës më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Bashkia Tepelenë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përfshijë kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim moskrijim borxhi për fatura të palikuiduara dhe krijimin e vështirësisë në aftësinë paguese.

Përsa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi: z. S.K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe zj. K.S. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës.

2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë, shërbime dhe mallra, të cilat janë miratuar me VKB-të përkatëse.

Prokurimet e kryera për periudhën objekt auditimi, janë paraqitur në Aneksin P1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për vitin ushtrimor 2022, nga Bashkia Tepelenë, referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve ka kryer gjithsej 1 procedurë prokurimi të llojit “e hapur”, 4 procedura prokurimi të llojit “e hapur e thjeshtuar” dhe 68 procedura prokurimi të llojit “blerje e vogël”, me vlerë të fondit limit 70,669,446 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 63,148,768 lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 7,520,678 lekë pa TVSH ose 10.64%.

Sipas llojit të aktivitetit, konstatohet se në fushën e ndërtimit (investime), është 1 procedurë me fond limit 13,122 mijë lekë ose 18.6% e kontratave të lidhura dhe kjo me fonde të deleguara nga buxheti i shtetit.

Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedurat e periudhës 01.01.2022 – 31.12.2022	Nr.	Fondi Limit	Vlera e Kontratave
Gjithsej	73	70,669,446	63,148,768
- Të hapura	1	13,122,000	12,244,051
- E hapur e thjeshtuar	4	15,833,334	15,664,666
- Të vogla	68	41,714,112	35,240,051
Procedurat “E hapur/e hapur e thjeshtuar” sipas llojit të objekteve			
- Objekte në fushën e investimeve/ndërtime	1	13,122,000	12,244,051
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	4	15,833,334	15,664,666

Financimi i kontratave është paraqitur në Aneksin P2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Titulli i gjetjes: Nga auditimi, u konstatua se në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, janë konstatuar kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST, të miratuar nga AK-ja.

Situata: Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, janë realizuar gjithsej 72 procedura me fond limit 70,669.4 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 63,149 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 7,520.4 mijë lekë ose 10.6%.

Këto procedura prokurimi kanë qenë të llojit: 1 procedurë “e hapur”, 3 procedura “e hapur e thjeshtuar” dhe 68 procedura “blerje e vogël”.

Sipas llojit të aktivitetit, u konstatua se në fushën e ndërtimit (investime), është 1 procedurë me fond limit 13,122 mijë lekë ose 18.6% e kontratave të lidhura dhe kjo me fonde të deleguara nga buxheti i shtetit.

Referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditimit vlerësoi për auditim 5 procedurat e llojit “e hapur” dhe “e hapur e thjeshtuar” dhe 6 procedura të llojit “Blerje e vogël”.

1. Nga auditimi i 5 procedurave të llojit “e hapur” dhe “e hapur e thjeshtuar”, të zhvilluara gjatë vitit 2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar.

2. Nga auditimi i procedurave si më sipër, janë konstatuar në shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, gjithsej në 3 procedura, ku OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DT të miratuara nga AK, në vlerën 23,910,718 lekë pa TVSH, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3 dhe neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.

Shkaku: Mosvlerësimi i drejtë i kriterëve, kritere jo në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe/ose aplikimi i kriterëve të rënduara, të cilat çojnë direkt ose indirekt në uljen e numrit të OE pjesëmarrës.

Ndikimi/Efekti: Aplikimi i kriterëve jo në mënyrë të argumentuar dhe jo në përputhje me procedurën, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të DT për vlerën totale **23,910,718 lekë**.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen e OE fitues të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit, etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim rrugë në qytet dhe rruga veriore Dragot”.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 177, datë 20.10.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 177, datë 20.10.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 07/02, datë 05.01.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedurë e hapur	1. J.K., Kryetare; 2. M.Sh., Anëtar; 3. R.H., Anëtar.	1. S.K., Kryetar 2. G.G., Anëtar 3. G.Sh., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSH) 12,233,833 lekë	6. Oferta fituese: OE “N.” SHPK Oferta 10,325,179 lekë pa TVSH. Kontrata datë 30.12.2022, me afat 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës	7. Diferenca me fondin limit: 1,908,654 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 01.12.2022	9. Burimi i Financimit: Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE, b) Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 2 OE.
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje ankesës nga KPP: Jo

Njësia e prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave

- Me Urdhërin nr. 177, me nr. 2546 prot., datë 20.10.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit 12,233,833 lekë pa TVSH, për objektin: “Sistemim asfaltim rrugë në qytet dhe rruga veriore Dragot”.

- Me këtë urdhër është ngritur edhe Njësia e Prokurimit e përbërë nga J.K., Kryetare, M.Sh. dhe R.H., anëtarë.
- Numri i referencës së prokurimit është REF-47897-10-31-2022 dhe afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është datë 01.12.2022.
- Me Urdhërin nr. 177/1, me nr. 2546/1 prot., datë 20.10.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, është urdhëruar ndarja e detyrave për Njësinë e Prokurimit, si vijon: J.K., me profesion juriste, është personi përgjegjës, M.Sh., me profesion ing. gjeodet dhe R.H., me profesion ekonomist.
- Kriteret e kualifikimit dhe specififikimet teknike janë hartuar nga Njësia e Prokurimit, me procesverbalin datë 20.10.2022, pa numër protokoll.
- Procedura dhe dokumentet e prokurimit janë miratuar nga titullari me shkresën datë 20.10.2022, pa numër protokoll.
- Me nr. 2546/3 prot., datë 08.11.2022, ka dalë Urdhëri nr. 188 i titullarit, për pezullimin e procedurës së prokurimit. Në zbatim të këtij urdhëri, janë bërë sqarimet përkatëse në DT me procesverbalin datë 08.11.2022, pa numër protokoll.
- Me nr. 2546/4 prot., datë 08.11.2022, ka dalë Urdhëri nr. 188/1 i titullarit, për përfundimin e pezullimit të procedurës së prokurimit. Afati i dorëzimit të ofertave nuk ka ndryshuar, me argumentimin se nuk janë bërë ndryshime në DT.
- Me urdhërin nr. 07/02, me nr. 09/02 prot., datë 05.01.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, është krijuar Komisioni për Vlerësimin e Ofertave, i përbërë nga S.K., Kryetar, G.G., Anëtar dhe G.Sh., Anëtar.
- Procesverbalet janë mbajtur në kundërshtim me nenin 18 të “*Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”.

Projekti dhe fondi limit:

- Fondi limit është hartuar në bazë të kontratës me objekt “*Blerje projekte dhe preventiva: Sistemin asfaltim të rrugëve të brendshme qytet dhe rrugës veriore Dragot*”, me nr. 1704/1 Ref., datë 01.08.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Tepelenë dhe BOE I.D. Shpk & K.K., PF.
- Oponenca Teknike është dërguar nga Instituti i ndërtimit me shkresën nr. 1604/3 prot., datë 03.10.2022 dhe është protokolluar në Bashkinë Tepelenë me nr. 2357, date 06.10.2022.
- Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Tepelenë, i miratuar me VKB-në nr. 44, datë 31.05.2022, “*Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 76, datë 17.12.2021 “Për miratim të buxhetit të vitit 2022”*”. Sipas kontratës, financimi për këtë objekt do të shpërndahet në tre vite, konkretisht 1,200,000 lekë për vitin 2023, 8,800,000 lekë për vitin 2024 dhe 2,393,000 për vitin 2025. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 “*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH*”, i ndryshuar, neni 40 “*E drejta për të kryer shpenzime*”, paragrafi i tretë.

Kriteret e vlerësimit:

- Në pikën 2.2. “*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*”, nënpika 2.2.1., është kërkuar që “*vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës e fondit limit të kontratës që prokurohet...*”.
- Duke qenë se vlera e fondit limit të kësaj procedure është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, kjo kërkesë është në kundërshtim edhe me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 43, “*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*”, pika 2, germa b.
- Në nënpikën 2.2.2., është kërkuar që “*bilancet vjetore... të jenë të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon*

shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”...”. Kjo kërkesë nuk është e mbështetur në legjislacionin për prokurimin publik, është e tepërt dhe nuk mbështet nxitjen e sipërmarrësve të vegjël për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Sa më sipër është në kundërshtim me kërkesat e LPP, neni 2 “Qëllimi”, pikat c, ç dhe d.

- Në nënpikën 2.2.3., është kërkuar “Vërtetim në fazën e ofertimit, për plotësim e detyrimeve të maturuara taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022”.

Sa më sipër nuk është sipas parashikimeve në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik, ku përcaktohet qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksat, tarifën, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual, me selinë e OE, etj. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2.

- Në pikën 2.3. “Aftësitë teknike dhe profesionale”, nënpika 2.3.1., është kërkuar “a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 45% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 100% i vlerës limit të kontratës që prokurohet”.

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5.

- Në nënpikën 2.3.6., janë kërkuar 3 muratorë dhe 1 elektrikist, me argumentimin “Bazuar në zërat e punimeve sipas preventivës punime betoni, ndërtim mur guri, suvatime dhe FV elektroda tokëzime, kabëll dhe puseta elektrike”. Nga auditimi i preventivave dhe zërave të punimeve, u konstatua se zërat e përmendur nuk ekzistojnë për projektin në fjalë. Të vetmit zëra për punë krahu, janë “Skarifikim bari me lopatë” dhe “Prerje bimë të vogla”.

- Në nënpikën 2.3.8., krahas të tjerave janë kërkuar 3 vibratorë betoni, nevoja e të cilëve nuk argumentohet, pasi në preventiva nuk ka beton apo zë të ngjashëm ku mund të përdoret vibratorët i betonit.

- Nga auditimi i preventivave dhe zërave të punimeve, u konstatua se për zërat “Guardrail”, “Tabela të ndryshme rrugore” dhe “Vijëzim shirita gjatësorë dhe anësorë”, nga AK nuk është kërkuar disponimi i asnjë makinerie/pajisje apo personeli të kualifikuar, duke mos e garantuar zbatimin e kontratës.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përgjegjësia për sa më sipër është e Njësisë së Prokurimit.

Vlerësimi i ofertave:

- Dokumentet e dorëzuara nga OE i shpallur fitues nuk janë numërtuar dhe inventarizuar.

- Me procesverbalet datë 01.12.2022, pa numër protokoli, është dokumentuar hapja e ofertave, ku u konstatua pjesëmarrja e 4 OE.

- Në datën 16.12.2022, pa numër protokoli, është hartuar Raporti Përmbledhës, ku dokumentohet pjesëmarrja e 4 OE, konkretisht: OE Sh., me ofertën 11,774,041 lekë; OE I., me ofertën 10,576,158 lekë, OE A., me ofertën 10,694,598 lekë dhe OE N., me ofertën 10,325,179 lekë. Janë kualifikuar si me dokumentacion të rregullt OE Sh. dhe OE N.. Fitues është shpallur OE N., i cili është edhe ofertuesi me vlerën më të ulët.

- Me nr. 2546/7 prot., datë 16.12.2022, ka dalë Vendimi nr. 64 i titullarit, për miratimin e Raportit Përmbledhës dhe shpalljen e fituesit.

- Kontrata e sipërmarrjes është lidhur me nr. 2546/1 Ref., datë 30.12.2022.

Të dhënat për kualifikimin/skualifikimin e Operatorëve Ekonomikë, janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	O. Ekonomike	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës
1	Sh.	11,774,041	Kualifikuar
2	I.	10,576,158	Skualifikohet për arsyet: 1.. OE nuk ploteson kriterin “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”. Mungon kontrata e furnizimit sipas kërkesave : “Në rastin kur është me qera ose kontratë furnizimi të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të objektit. “ C: DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” ky seksion i paplotësuar . 2. OE ka paraqitur certifikaten ISO 99-2012 te leshuar nga nje organ i cili nuk eshte i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit per te leshuar kete certificate. “Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”. Referuar listes se organeve te akredituara, AQSCERT nuk eshte i akredituar per te leshuar 99-2012
3	A.	10,694,598	Skualifikohet për arsyet: 1. Eshte debitor prane Bashkise Tepelenë ne Shumen 1,281,616 leke sipas raportit te KLSH te vitit 2019. 2. Deklarata eshte bere per nje tjetër AK, “AUTORITETI I MBIKQYRJES FINANCIARE”, nje tjetër objekt prokurimi) 3. OE ka paraqitur certifikaten ISO 99-2012 te leshuar nga nje organ i cili nuk eshte i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit per te leshuar kete certificate. “Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”. Referuar listes se organeve te akredituara, AQSCERT nuk eshte i akredituar per te leshuar 99-2012
4	N.	10,325,179	Kualifikuar

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi se vlerësimi i kësaj procedure prokurimi është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në DT dhe në legjislacionin për prokurimin publik.

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Karburanti për nevoja të Bashkisë Tepelenë 2022”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 17, datë 01.02.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 17, datë 01.02.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 07/02, datë 05.01.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar	1. J.K., Kryetare; 2. M.Sh., Anëtar; 3. R.H., Anëtar.	1. S.K., Kryetar 2. G.G., Anëtar 3. G.Sh., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSH) 8,166,667 lekë	6. Oferta fituese: OE “O.” SHPK Oferta 8,166,666 lekë pa TVSH. Kontrata datë 17.03.2022, me afat 11 muaj nga nënshkrimi i kontratës	7. Diferenca me fondin limit: 0 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 21.02.2022	9. Burimi i Financimit: Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE, b) Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 2 OE.
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje ankesës nga KPP: Jo

Njësia e prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave

- Me Urdhërin nr. 17, me nr. 237 prot., datë 01.02.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit 8,166,667 lekë pa TVSH, për: “Blerje Karburanti për nevoja të Bashkisë Tepelenë 2022”.

- Me këtë urdhër është është ngritur edhe Njësia e Prokurimit e përbërë nga J.K., Kryetare, M.Sh. dhe R.H., anëtarë.

- Numri i referencës së prokurimit është REF-18335-02-01-2022 dhe afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është datë 14.02.2022.

- Me Urdhërin nr. 17/1, me nr. 237/1 prot., datë 21.02.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, është urdhëruar ndarja e detyrave për Njësinë e Prokurimit, si vijon: J.K., me profesion juriste, është personi përgjegjës, M.Sh., me profesion ing. gjeodet dhe R.H., me profesion ekonomist.

- Kriteret e kualifikimit dhe specififikimet teknike janë hartuar nga Njësia e Prokurimit, me procesverbalin nr. 237/2, datë 01.02.2022.
- Procedura dhe dokumentet e prokurimit janë miratuar nga titullari me shkresën nr. 237/3, datë 20.10.2022.
- Me nr. 237/4 prot., datë 03.02.2022, ka dalë Urdhëri nr. 18 i titullarit, për pezullimin e procedurës së prokurimit. Në zbatim të këtij urdhëri, janë bërë sqarimet përkatëse në DT me procesverbalin nr. 237/6 prot., datë 03.02.2022, ku kërkohët që stacionet e tregëtimit me pakisë të karburantit detyrimisht duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore të tipit B, lëshuar nga QKL.
- Me nr. 237/5 prot., datë 03.02.2022, ka dalë Urdhëri nr. 18/01 i titullarit, për përfundimin e pezullimit të procedurës së prokurimit. Afati i dorëzimit të ofertave nuk ka ndryshuar, me argumentimin se ndryshimet në DT janë bërë në gjysmën e parë të afatit për pranimin e ofertave.
- Me emailin e datës 09.02.2022, protokolluar në Bashkinë Tepelenë me nr. 237/6, datë 09.02.2022, nga APP është kërkuar ndryshim i kriterëve të vlerësimit, si të papërshtatshme.
- Me nr. 237/7 prot., datë 10.02.2022, ka dalë Urdhëri nr. 18/2 i titullarit, për pezullimin e procedurës së prokurimit. Në zbatim të këtij urdhëri, është mbajtur procesverbali datë 10.02.2022, pa numër protokolli, ku nuk shprehet marrja në konsideratë e sugjerimeve të APP-së.
- Me nr. 237/8 prot., datë 10.02.2022, ka dalë Urdhëri nr. 18/3 i titullarit, për përfundimin e pezullimit të procedurës së prokurimit. Afati i dorëzimit të ofertave është zgjatuar me 7 ditë, me argumentimin se ndryshimet në DT janë bërë në gjysmën e dytë të afatit për pranimin e ofertave.
- Me urdhërin nr. 07/02, me nr. 09/02 prot., datë 05.01.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, është krijuar Komisioni për Vlerësimin e Ofertave, i përbërë nga S.K., Kryetar, G.G., Anëtar dhe G.Sh., Anëtar.
- Disa procesverbale janë mbajtur në kundërshtim me nenin 18 të “*Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”.

Fondi limit:

- Hartimi i fondit limit është pasqyruar në Raportin nr. 154 prot., datë 21.01.2022, “*Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit e hapur e thjeshtuar “Blerje naftë për institucionin për vitin 2022”*”. Si bazë për llogaritjen e fondit limit është marrë nevoja e drejtorive përkatëse, sipas normativave të harxhimit të karburantit, të miratuara me VKB nr. 75, datë 17.12.2021.
- Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Tepelenë, i miratuar me VKB-në nr. 76, datë 17.12.2021, “*Për miratimin e buxhetit të vitit 2022*”.

Kriteret e vlerësimit:

- Në pikën 2.2. “*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*”, nënpika 2.2.1., është kërkuar që “*vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës e fondit limit të kontratës që prokurohet...*”.

Duke qenë se vlera e fondit limit të kësaj procedure është nën kufirin e ulët monetar, kjo kërkesë është në kundërshtim edhe me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 43, “*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*”, pika 2, germa c.

Duke kërkuar që vlera e xhiros të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit dhe duke pasur parasysh që legjislacioni për prokurimin publik nuk e lejon më të madhe se 40% e fondit limit, kjo kërkesë e bën të pamundur realizimin e kësaj kontrate ose e përcakton direkt fituesin, duke specifikuar xhiron fiks sa 40% e fondit limit.

- Në pikën 2.3. “Kapaciteti teknik”, nënpika 13.a., është kërkuar që “Subjekti duhet të deklarojë se merr persiper furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë në shërbim 24 orë me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor, me tollon ose bot...”. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM-në nr. 561, datë 7.3.2018 “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 1.

- Në pikën 2.3. “Kapaciteti teknik”, nënpika 14., është kërkuar që “Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera minimalisht 1 (një) Autobot të transportit të lendeve të rrezikshme me kapacitet mbajtes nga 1,000-20,000 litra...”. Karburanti nuk bën pjesë të mallrat e rrezikshëm dhe rrjedhimisht kjo kërkesë është në kundërshtim me Ligjin nr. 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, neni 23 “Llojet e mallrave për autorizim”, pika 1.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3. Përgjegjësia për sa më sipër është e Njesisë së Prokurimit.

Vlerësimi i ofertave:

- Me procesverbalet datë 21.02.2022, pa numër protokoll, është dokumentuar hapja dhe vlerësimi i ofertave, ku u konstatua pjesëmarrja e 2 OE.

- Në datën 01.03.2022, pa numër protokoll, është hartuar Raporti Përmbledhës, ku dokumentohet pjesëmarrja e 2 OE, konkretisht: OE K., me ofertën 8,166,667 lekë, me marzh fitimi 16% dhe OE O., me ofertën 8,166,666 lekë, me marzh fitimi 9.9%. Janë kualifikuar si me dokumentacion të rregullt të dy OE. Fitues është shpallur OE O., i cili është edhe ofertuesi me marzhin e fitimit më të ulët.

- Me nr. 237/20 prot., datë 17.03.2022, ka dalë Vendimi nr. 42 i titullarit, për miratimin e Raportit Përmbledhës dhe shpalljen e fituesit.

- Kontrata është lidhur me nr. 237/9 prot., datë 17.03.2022.

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezulton si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	O. Ekonomike	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës
1	K.	Marzhi 16%	Kualifikuar
2	O.	Marzhi 9.9%	Kualifikuar

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi se OE “O.” nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e detyrimeve vendore.

Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2.

Në dosjen e dokumenteve të tenderit, të paraqitura pranë AK nga OE O. Shpk, nuk disponohen akte, procesverbale, dëshmi në lidhje me plotësimin e kriterëve të përcaktuar në DST, si më poshtë:

“16. Bazuar në VKM nr. 561 datë 29. 07.2016” Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve në njësinë e qeverisjes së përgjithshme” Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (ëbpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nepermjet kartes elektronike.

17. Faqja e menaxhimit të karburanteve (ëbpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasise së karburantit nga Operatori Ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasise së karburanteve të kryhet nga vet autoriteti kontraktor.

18. Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukture piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit Kontraktor, shërbimin e furnizimit me

karburant nepermjet kartave elektronike stikera (pulla), te cilat ngjiten ne xhamin e automjetit dhe ofrojne sherbimin e furnizimit me karburant vetem per ate automjet per te eliminuar levizjen e mundshme te targave nga mjete shteteror drejt mjeteve private, si dhe sherbimin e dergimit te fotografive me ane te e-mailit me kerkesen e autoritetit kontraktor per furnizimin e kryer te mjetit prane stacionit te shitjes se karburanteve me pakice me qellim identifikimin e mjetit dhe perdoruesit te saj.

19. Disponimi /ekzistenca e faqes se menaxhimit te karburanteve (ëëbpage), se bashku me ofrimin e sherbimeve te kerkuara me siper do te demonstrohen nga ana e operatoreve ekonomik pjesmarres me shembuj per zbatimin ne praktike ne prani te anetareve te KVO-se se Autoritetit Kontraktor perpara mbylljes se procesit te kualifikimit dhe shpalljes se fituesit.”

Konkluzion:

Për sa më sipër OE “O.” Shpk nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe KVO nuk duhet ta kishte kualifikuar këtë OE, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si më poshtë:

Neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr. 1, germa a) dhe neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3.

Duke shpallur fitues OE “O.” Shpk, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, AK ka lidhur kontratë me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën 8,166,667 lekë pa Tvsh.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga S.K., Kryetar; G.G., Anëtar dhe G.Sh., Anëtarë.

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje mjet teknologjik për mbledhjen e mbetjeve urbane”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 65, datë 10.05.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 65, datë 10.05.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 07/02, datë 05.01.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar	1. J.K., Kryetare; 2. M.Sh., Anëtar; 3. R.H., Anëtar.	1. S.K., Kryetar 2. G.G., Anëtar 3. G.Sh., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSH) 4,166,667 lekë	6. Oferta fituese: OE “S.C.” SHPK Oferta 3,998,000 lekë pa TVSH. Kontrata datë 16.06.2022, me afat 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës	7. Diferenca me fondin limit: 168,667 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 30.05.2022	9. Burimi i Financimit: Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE, b) Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE.
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje ankesës nga KPP: Jo

Njësia e prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave

- Me Urdhërin nr. 65, me nr. 1008 prot., datë 10.05.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit 4,166,667 lekë pa TVSH, për: “Blerje mjet teknologjik për mbledhjen e mbetjeve urbane”.

- Me këtë urdhër është është ngritur edhe Njësia e Prokurimit e përbërë nga J.K., Kryetare, M.Sh. dhe R.H., anëtarë.

- Numri i referencës së prokurimit është REF-29409-05-17-2022 dhe afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është datë 30.05.2022.

- Me Urdhërin nr. 65/1, me nr. 1008/1 prot., datë 10.05.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, është urdhëruar ndarja e detyrave për Njësinë e Prokurimit, si vijon: J.K., me profesion juriste, është personi përgjegjës, M.Sh., me profesion ing. gjeodet dhe R.H., me profesion ekonomist.

- Kriteret e kualifikimit dhe specififikimet teknike janë hartuar nga Njësia e Prokurimit, me procesverbalin datë 17.05.2022, pa numër protokollit.

- Procedura dhe dokumentet e prokurimit janë miratuar nga titullari me shkresën nr. 1075, datë 17.05.2022.
- Me urdhërin nr. 07/02, me nr. 09/02 prot., datë 05.01.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, është krijuar Komisioni për Vlerësimin e Ofertave, i përbërë nga S.K., Kryetar, G.G., Anëtar dhe G.Sh., Anëtar.
- Disa procesverbale janë mbajtur në kundërshtim me nenin 18 të “*Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”.

Fondi limit:

- Hartimi i fondit limit është pasqyruar në Raportin nr. extra prot., datë 15.12.2021, “*Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit e hapur e thjeshtuar “Blerje mjet teknologjik për mbledhjen e mbetjeve urbane”*”. Llogaritja e fondit limit është kryer në bazë të studimit të tregut, duke marrë oferta nga shoqëritë “A. Sh.A.”, “A.T.” dhe “M.L. Shpk”. Vlera mestare e përlllogaritur nga komisioni ka rezultuar 4,166,667 lekë.
- Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Tepelenë, i miratuar me VKB-në nr. 76, datë 17.12.2021, “*Për miratimin e buxhetit të vitit 2022*”.

Kriteret e vlerësimit:

- Në pikën 2.2. “*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*”, nënpika 2.2.1., është kërkuar që “*vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës e fondit limit të kontratës që prokurohet...*”.

Duke qenë se vlera e fondit limit të kësaj procedure është nën kufirin e ulët monetar, kjo kërkesë është në kundërshtim edhe me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 43, “*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*”, pika 2, germa c.

Duke kërkuar që vlera e xhiros të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit dhe duke pasur parasysh që legjislacioni për prokurimin publik nuk e lejon më të madhe se 40% e fondit limit, kjo kërkesë e bën të pamundur realizimin e kësaj kontrate ose e përcakton direkt fituesin, duke specifikuar xhiron fiks sa 40% e fondit limit.

- Në nënpikën 2.2.2., është kërkuar që “*bilancet vjetore... të jenë të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr. 10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit...*”. Kjo kërkesë nuk është e mbështetur në legjislacionin për prokurimin publik, është e tepërt dhe nuk mbështet nxitjen e sipërmarrësve të vegjël për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Sa më sipër është në kundërshtim me kërkesat e LPP, neni 2 “*Qëllimi*”, pikat c, ç dhe d.

- Në nënpikën 2.2.3., është kërkuar “*Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin 2021 për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së*”.

Sa më sipër nuk është sipas parashikimeve në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik, ku përcaktohet qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksat, tarifat, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual, me selinë e OE, etj. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, pika 2.

Nga auditimi, u konstatua se nuk është përcaktuar asnjë karakteristikë teknike, e domosdoshme për vënien në funksionim të makinës teknologjike, si psh. kapaciteti i motorit, kapaciteti i

kazanit, lloji dhe konsumi i lëndës djegëse, viti i prodhimit, pajisjet/aksesorët e domosdoshëm, si larja, fshirja, hidrauliku për ngarkimin e kazanëve, etj.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3. Përgjegjësia për sa më sipër është e Njesisë së Prokurimit.

Vlerësimi i ofertave:

- Me procesverbalet datë 30.05.2022, pa numër protokollit, është dokumentuar hapja dhe vlerësimi i ofertave, ku u konstatua pjesëmarrja e 4 OE.

- Në datën 30.05.2022, pa numër protokollit, është hartuar Raporti Përmbledhës, ku dokumentohet pjesëmarrja e 4 OE, konkretisht: OE L. Shpk, me ofertën 3,990,000 lekë pa Tvsh, OE A. Shpk, me ofertën 4,100,000 lekë pa Tvsh, OE S. Shpk, me ofertën 4,160,000 lekë pa Tvsh dhe OE S.C. Shpk, me ofertën 3,998,000 lekë pa Tvsh. Është kualifikuar si me dokumentacion të rregullt OE S.C. Shpk, i cili është shpallur fitues si ofertues me dokumentacion të rregullt. Diferenca në ofertën e këtij ofertuesi me ofertën më të ulët të ofruar është 8,000 lekë.

- Me nr. 1009 prot., datë 02.06.2022, ka dalë Vendimi nr. 27 i titullarit, për miratimin e Raportit Përmbledhës dhe shpalljen e fituesit.

- Kontrata është lidhur me nr. 1075/2 prot., datë 16.06.2022.

- Me nr. 1419 prot., datë 17.06.2022, ka dalë Urdhëri nr. 92 i titullarit, “Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të makinës teknologjike”, i përbërë nga D.M., kryetar, G.C., L.Sh. dhe R.K. anëtarë.

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezulton si më poshtë:

Të dhënat për kualifikimin/skualifikimin e Operatorëve Ekonomikë, janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	O. Ekonomike	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës
1	L.	3,990,000	Skualifikuar për arsyet: - Nuk ka licence Kodi VII 3.B.2 - Nuk ka parqitur llojin e mjetit, librezat perkatese, foto etj
2	A.	4,100,111	Skualifikuar për arsyet: Nuk ka parqitur llojin e mjetit, librezat perkatese, foto etj
3	S.	4,160,000	- Nuk ka licence Kodi VII 3.B.2 - Nuk ka parqitur llojin e mjetit, librezat perkatese ,foto etj
4	S.C.	3,998,000	Kualifikuar

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi se vlerësimi i kësaj procedure prokurimi është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në DT dhe në legjislacionin për prokurimin publik.

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje naftë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave Civile”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 183, datë 01.11.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 183, datë 01.11.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 07/02, datë 05.01.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar	1. J.K., Kryetare; 2. M.Sh., Anëtar; 3. R.H., Anëtar.	1. S.K., Kryetar 2. G.G., Anëtar 3. G.Sh., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSH) 3,500,000 lekë	6. Oferta fituese: OE “O.” SHPK Oferta 3,500,000 lekë pa TVSH. Kontrata datë 02.12.2022, me afat 3 muaj nga nënshkrimi i kontratës	7. Diferenca me fondin limit:0 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 15.11.2022	9. Burimi i Financimit: Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE, b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE.
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje ankesës nga KPP: Jo

Njësia e prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave

- Me Urdhërin nr. 183, me nr. 2647 prot., datë 01.11.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit 3,500,000 lekë pa TVSH, për: *“Blerje Karburanti për nevoja shtesë të Bashkisë Tepelenë”*.
- Me këtë urdhër është ngritur edhe Njësia e Prokurimit e përbërë nga J.K., Kryetare, M.Sh. dhe R.H., anëtarë.
- Numri i referencës së prokurimit është REF-48312-11-02-2022 dhe afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është datë 15.11.2022.
- Me Urdhërin nr. 183/1, me nr. 2647/1 prot., datë 01.11.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, është urdhëruar ndarja e detyrave për Njësinë e Prokurimit, si vijon: J.K., me profesion juriste, është personi përgjegjës, M.Sh., me profesion ing. gjeodet dhe R.H., me profesion ekonomist.
- Kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike janë hartuar nga Njësia e Prokurimit, me procesverbalin datë 02.11.2022, pa numër protokoll.
- Procedura dhe dokumentet e prokurimit janë miratuar nga titullari me shkresën nr. 2647/2, datë 18.11.2022.
- Me urdhërin nr. 07/02, me nr. 09/02 prot., datë 05.01.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, është krijuar Komisioni për Vlerësimin e Ofertave, i përbërë nga S.K., Kryetar, G.G., Anëtar dhe G.Sh., Anëtar.
- Disa procesverbale janë mbajtur në kundërshtim me nenin 18 të *“Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”*.

Fondi limit:

- Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Tepelenë, i miratuar me VKB-në nr. 77, datë 26.09.2022, *“Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 76, datë 17.12.2022, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”*”. Prokurimi i sasisë shtesë të karburantit është argumentuar me rastin e ngritjes së çmimit të karburantit në bursë dhe rrjedhimisht pamundësinë e blerjes të sasisë së nevojshme për realizimin e shërbimeve publike dhe ngrohjes së institucioneve.

Kriteret e vlerësimit:

- Në pikën 2.2. *“Kapaciteti ekonomik dhe financiar”*, nënpika 2.2.1., është kërkuar që *“vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës e fondit limit të kontratës që prokurohet...”*.

Duke qenë se vlera e fondit limit të kësaj procedure është nën kufirin e ulët monetar, kjo kërkesë është në kundërshtim edhe me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, neni 43, *“Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”*, pika 2, germa c.

Duke kërkuar që vlera e xhiros të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit dhe duke pasur parasysh që legjislacioni për prokurimin publik nuk e lejon më të madhe se 40% e fondit limit, kjo kërkesë e bën të pamundur realizimin e kësaj kontrate ose e përcakton direkt fituesin, duke specifikuar xhiron fiks sa 40% e fondit limit.

Ky kriter, nuk përmbush parashikimet e LPP, neni 77 *“Kërkesat për kualifikim”* dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 39 *“Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”*, pika 1 dhe pika 3.

Përgjegjësia për sa më sipër është e Njesisë së Prokurimit.

Vlerësimi i ofertave:

- Me procesverbalet datë 15.11.2022, pa numër protokollit, është dokumentuar hapja dhe vlerësimi i ofertave, ku u konstatua pjesëmarrja e 1 OE.
- Në datën 18.11.2022, pa numër protokollit, është hartuar Raporti Përmbledhës, ku dokumentohet pjesëmarrja e 1 OE, konkretisht OE O., me ofertën 3,500,000 lekë, me çmim 196.4 lekë/litër. Është kualifikuar si me dokumentacion të rregullt dhe është shpallur fitues.
- Me nr. 2647/3 prot., datë 19.12.2022, ka dalë Vendimi nr. 65 i titullarit, për miratimin e Raportit Përmbledhës dhe shpalljen e fituesit.
- Kontrata është lidhur me nr. 2898 prot., datë 02.11.2022.

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezulton si më poshtë:

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi se OE “O.” nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e detyrimeve vendore.

Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2.

Në dosjen e dokumenteve të tenderit, të paraqitura pranë AK nga OE O. Shpk, nuk disponohen akte, procesverbale, dëshmi në lidhje me plotësimin e kriterëve të përcaktuar në DST, si më poshtë:

“12. Bazuar ne VKM nr. 561 date 29. 07.2016” Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve ne njesine e qeverisjes se pergjithshme” Operoret ekonomik pjesmarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (ëebpage),ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepermjet kartes elektronike.

13. Faqja e menaxhimit te karburanteve (ëebpage) duhet te ofroje sherbimin e ngarkimit te sasise se karburantit nga Operatori Ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targon e mjetit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet autoriteti kontraktor.

14. Faqja e menaxhimit te karburanteve duhet te ofroje edhe sherbimin per krijimin e struktures piramidale ne perputhje me strukturen piramidale te Autoritetit Kontraktor, sherbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike stikera (pulla),te cilat ngjiten ne xhamin e automjetit dhe ofrojne sherbimin e furnizimit me karburant vetem per ate automjet per te eliminuar levizjen e mundshme te targave nga mjeti shteteror drejt mjeteve private, si dhe sherbimin e dergimit te fotografive me ane te e-mailit me kerkesen e autoritetit kontraktor per furnizimin e kryer te mjetit prane stacionit te shitjes se karburanteve me pakice me qellim identifikimin e mjetit dhe perdoruesit te saj.

15. Disponimi /ekzistenca e faqes se menaxhimit te karburanteve (webpage),se bashku me ofrimin e sherbimeve te kerkuara me siper do te demonstrohen nga ana e operatoreve ekonomik pjesmarres me shembuj per zbatimin ne praktike ne prani te anetareve te KVO-se se Autoritetit Kontraktor perpara mbylljes se procesit te kualifikimit dhe shpalljes se fituesit.”

Konkluzion:

Për sa më sipër OE “O.” Shpk nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe KVO nuk duhet ta kishte kualifikuar këtë OE, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si më poshtë:

Neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr. 1, germa a) dhe neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3.

Duke shpallur fitues OE “O.” Shpk, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, AK ka lidhur kontratë me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën 3,500,000 lekë pa Tvsh.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga S.K., Kryetar; G.G., Anëtar dhe G.Sh., Anëtarë.

5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Furnizim dhe vendosje matësash uji në pallatet me kollonë të brendshme”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 143, datë 14.09.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 143, datë 14.09.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 07/02, datë 05.01.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedurë e hapur	1. J.K., Kryetare; 2. M.Sh., Anëtar; 3. R.H., Anëtar.	1. S.K., Kryetar 2. G.G., Anëtar 3. G.Sh., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSH) 12,769,562 lekë	6. Oferta fituese: OE “N.S.” SHPK, me ofertë 12,244,051 lekë pa TVSH, me kontratë datë 16.12.2022, me afat 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës	7. Diferenca me fondin limit: 525,511 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 22.11.2022	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE, b) Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE.
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje ankesës nga KPP: Jo

Njësia e prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave

- Me Urdhërin nr. 143, me nr. 2054 prot., datë 14.09.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit 12,769,562 lekë pa TVSH, për objektin: “Furnizim dhe vendosje matsash uji në pallatet me kollonë të brendshme”.
- Me këtë urdhër është ngritur edhe Njësia e Prokurimit e përbërë nga J.K., Kryetare, M.Sh. dhe R.H., anëtarë.
- Numri i referencës së prokurimit është REF-46589-10-19-2022 dhe afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është datë 22.11.2022.
- Me Urdhërin nr. 143/1, me nr. 2054/1 prot., datë 14.09.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, është urdhëruar ndarja e detyrave për Njësinë e Prokurimit, si vijon: J.K., me profesion juriste, është personi përgjegjës, M.Sh., me profesion ing. gjeodet dhe R.H., me profesion ekonomist.
- Kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike janë hartuar nga Njësia e Prokurimit, me procesverbalin datë 27.09.2022, pa numër protokoll.
- Procedura dhe dokumentet e prokurimit janë miratuar nga titullari me shkresën datë 27.09.2022, pa numër protokoll.
- Me emailin e datës 31.10.2022, protokolluar në Bashkinë Tepelenë me nr. 2054/2, datë 31.10.2022, nga APP është kërkuar ndryshim i kriterëve të vlerësimit, si të papërshtatshme.
- Me nr. 2636 prot., datë 01.11.2022, ka dalë Urdhëri nr. 143/3 i titullarit, për pezullimin e procedurës së prokurimit. Në zbatim të këtij urdhëri, është mbajtur procesverbali datë 01.11.2022, pa numër protokoll, ku nuk shprehet marrja në konsideratë e sugjerimeve të APP-së.
- Me nr. 2636/1 prot., datë 01.11.2022, ka dalë Urdhëri nr. 143/4 i titullarit, për përfundimin e pezullimit të procedurës së prokurimit. Afati i dorëzimit të ofertave nuk është zgjatur, me argumentimin se nuk janë ndryshuar DT.
- Me urdhërin nr. 07/02, me nr. 09/02 prot., datë 05.01.2022, nxjerrë nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, është krijuar Komisioni për Vlerësimin e Ofertave, i përbërë nga S.K., Kryetar, G.G., Anëtar dhe G.Sh., Anëtar.
- Procesverbalet janë mbajtur në kundërshtim me nenin 18 të “Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Projekti dhe fondi limit:

- Burimi i financimit është nga Buxheti i Shtetit, i dërguar në Bashkinë Tepelenë me shkresat nr. 1494 dhe 1494/1, datë 20.07.2022, për vlerën e plotë 15,746,401 lekë, nga e cila 15,323,763 lekë për ndërtim-montime, 367,763 për drejtim punimesh dhe 55,164 për kolaudim punimesh.
- Në Bashkinë Tepelenë, ky investim është miratuar me VKB nr. 15, me nr. 468/10 prot., datë 01.03.2022, “Për miratim të objekteve prioritare të investimeve për vitin 2022”.
- Me shkresën nr. 134 prot., datë 03.08.2022, është dërguar në Bashkinë Tepelenë nga Ujësjetillës ShA Tepelenë projekti i zbatimit për investimin në fjalë.
- Oponenca Teknike është dërguar nga Instituti i ndërtimit me shkresën nr. 1483/2 prot., datë 01.09.2022.
- Shlyerja e këtij investimi është e shtrirë në tre vite, 2022-2024.

Kriteret e vlerësimit:

- Në pikën 2.2. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, nënpika 2.2.1., është kërkuar që “vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% te vleres se parashikuar te kontrates...”.

Duke qenë se vlera e fondit limit të kësaj procedure është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, kjo kërkesë është në kundërshtim edhe me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 2, germa b.

- Në nënpikën 2.2.2., është kërkuar që “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019,2020,2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar... ose tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”. Kërkesa e mësipërme nuk është e mbështetur në legjislacionin për prokurimin publik, është e tepërt dhe nuk mbështet nxitjen e sipërmarrësve të vegjël për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Sa më sipër është në kundërshtim me kërkesat e LPP, neni 2 “Qëllimi”, pikat c, ç dhe d.

- Në nënpikën 2.2.3., është kërkuar “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas percaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njësisve të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet për vitin 2022 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.”.

Sa më sipër nuk është sipas parashikimeve në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik, ku përcaktohet qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksat, tarifatat, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual, me selinë e OE, etj. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2.

- Në pikën 2.3. “Aftësitë teknike dhe profesionale”, nënpika 2.3.1., është kërkuar “a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 45% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 100% i vlerës limit të kontratës që prokurohet”.

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5.

- Në nënpikën 2.3.4., është kërkuar “auditues energjistik, i certifikuar nga agjensia për eficienten e energjise ne ndertesa”, e cila nga grupi i auditimit gjykohet se është e tepërt dhe e pabazuar në ligj.

- Kërkesat për certifikatat ISO nuk janë të përditësuara. Konkretisht, versioni që duhej kërkuar është 14001-2018 dhe jo 14001-20015 dhe OHSAS 18001-2007 është zëvendësuar nga ISO 45001.

- Kërkesa për 3 aparate ngjitës tubo elektrofuzive është e tepërt, pasi kërkohet vetëm një hidraulik, i cili nuk mund të përdorë tre aparate në të njëjtën kohë. Gjithashtu, kërkesa për dy kamiona me kapacitet 1,5 deri 3 ton është e tepërt.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit, e përbërë nga J.K., Kryetare; M.Sh., Anëtar dhe R.H., Anëtar.

Vlerësimi i ofertave:

- Me procesverbalet datë 22.11.2022, pa numër protokoll, është dokumentuar hapja e ofertave, ku u konstatua pjesëmarrja e 4 OE.

- Në datën 22.11.2022, pa numër protokoll, është hartuar Raporti Përmbledhës, ku dokumentohet pjesëmarrja e 4 OE, konkretisht: OE A.A.C., me ofertën 11,900,989 lekë; OE I., me ofertën 11,505,315 lekë, OE N.S., me ofertën 12,244,051 lekë dhe OE A., me ofertën 9,464,849 lekë. Është kualifikuar si me dokumentacion të rregullt OE N.S., i cili është shpallur fitues.

- Me nr. 2054/5 prot., datë 16.12.2022, ka dalë Vendimi nr. 61 i titullarit, për miratimin e Raportit Përmbledhës dhe shpalljen e fituesit.

- Kontrata e sipërmarrjes është lidhur me nr. 2054/4 Ref., datë 16.12.2022.

Të dhënat për kualifikimin/skualifikimin e Operatorëve Ekonomikë, janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	O. Ekonomike	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës
1	A.A.C.	11,900,989	Skualifikuar për arsyet: OE ka paraqitur certifikata ISO te leshuara nga nje organ i cili nuk eshte i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit. Ne listen e publikuar nga ky institucion nuk fuguron fare organi qe ka leshuar ISO operatorit ekonomik. “Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”. OE ka dorëzuar formularin e deklarimit sipas nje formati te shfuqizuar nga APP. Referuar vendimit te APP mr nr 12 date 06.10.2022 jane miratuar Dokumentat Standarte te reja te cilat perfshijne formularet e rinj te deklarimit. OE nuk ka deklaruar vendodhjen e mjeteve duke mos plotesuar kriteret e DST.
2	I.	11,505,315	Skualifikuar për arsyet: OE nuk ploteson kriterin per auditues energjistik i licensuar nga AEE. Sepse ne formularin e deklarimit ka deklaruar se ky inxhinier do te punesohet dhe jo eshte i punesuar apo i kontraktuar.Kriteret e LPP duhen te provohen qe jane te permbushura plotesisht, jo te prezumuara. OE ka paraqitur certifikaten ISO 99-2012 te leshuar nga nje organ i cili nuk eshte i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit per te leshuar kete certificate . “Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”. Referuar listes se organeve te akredituara, AQSCERT nuk eshte I akredituar per te leshuar 99-2012. OE nuk ka objektin e prokurimit ne veprimtarine e tij. Ne vendimet e udhezimet e APP nje operator i cili nuk ka objekt te veprimtarie objketin e prokurimit duhet te skualifikohet automatikisht. OE ka furnizime materiale hidraulike. Preventivi ka zera ndertim,furnizim vendosje, montim etj.
3	N.S.	12,244,051	Kualifikuar
4	A.	9,464,849	Skualifikuar për arsyet: OE ka ndërhyre ne preventivin e publikuar nga AK duke ndryshuar strukturen e tij, perkatesisht; Zeri nr 33 kapitulli I ,sasia eshte 1, OE e ka ndryshuar ne sasine 2 Zeri nr 18 kapitulli V nuk eshte perfshire fare ne oferten e OE. Nuk plotesion kriterin per auditues energjistik I licensuar nga Agjensia per Eficencen e Energjise. Inxhinieri i deklaruar si Auditues Energjie eshte I certifikuar nga Univeriteti Politeknik i Tiranës. Nuk ploteson kriterin per pune te ngjashme.Puna qe eshte ngarkuar ne sistem nga ky Oe nuk perfshin zera te ngjashme me preventivin e ngarkuar nga AK.

			<p>OE nuk ploteson kriterin për sigurimin e ofertës pasi ky prim është leshuar pa asnjë të dhënë për ofertuesin. Nuk është vendosur kush e ka prerë dhe as nga kush sigurohet oferta.</p> <p>OE nuk ploteson kriterin për certifikata ISO pasi janë leshuar nga një organ që nuk është listuar fare në listën e organeve të akredituara nga DPA.</p> <p>OE nuk ka paraqitur asnjë të dhënë për 3 aparatet për ngjitje tubash në formularin e deklarimit.</p> <p>OE nuk ka plotësuar seksionin "D" të shtojcës nr 8, ku duhet deklaruar stafi Teknik, duke mos plotësuar kriterin e vendosur në DST.</p> <p>OE nuk ka deklaruar vendodhjen e mjeteve duke mos plotësuar kriterin e vendosur në DST.</p>
--	--	--	--

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezulton si më poshtë:

- Nga auditimi, u konstatua se OE "N.S." ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore vetëm për Bashkinë Tepelenë, ndërkohë që nga verifikimi në internet, u konstatua se ky OE, gjatë vitit 2022 ka ushtruar aktivitet edhe në Bashkitë Roskovec, Krujë, Fier, Poliçan, Gjirokastër, Kurbin, Tiranë, Lezhë dhe Durrës³.

Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 "Kriteret detyruese për skualifikim", pika 2.

Konkluzion:

Për sa më sipër OE "N.S." Shpk nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe KVO nuk duhet ta kishte kualifikuar këtë OE, si dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si më poshtë:

Neni 98 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika nr. 1, germa a) dhe neni 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3.

Duke shpallur fitues OE "N.S." SHPK, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, AK ka lidhur kontratë me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën 12,244,051 lekë pa TVSH.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga S.K., Kryetar; G.G., Anëtar dhe G.Sh., Anëtarë.

Blerjet me vlerë të vogël:

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Blerje komplete pllaka për shërbimin e varrimit".

Urdhëri i prokurimit është me nr. 4, datë 11.01.2022, për prokurimin me vlerë të vogël "Blerje komplete pllaka për shërbimin e varrimit".

Me procesverbalin datë 09.01.2022 sipas urdhërit nr. 7, datë 02.01.2022 nga komisioni i përbërë nga K.S., V.P., G.G., R.H. dhe D.A., është përlogaritur fondi limit për objektin si më sipër, në shumën 1,000,000 lekë pa Tvsh.

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 4 prot., datë 11.01.2022, me specifikimet teknike bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga operatori ekonomik i renditur i pari, pranë AK përpara se të shpallet fituesi.

Ftesa për ofertë është drejtuar minimalisht 5 OE.

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ngritur sipas urdhërit nr. 7/1, datë 05.01.2022 me përbërje S.K., J.K. dhe M.N.. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 20 OE me 20 oferta të ndryshme, nga të cilët janë kualifikuar 20, ku operatori ekonomik i renditur në vendin e parë është OE "E." Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 606,825 lekë pa Tvsh.

- OE Fitues është njoftuar në datë 13.01.2022, nëpërmjet sistemit të prokurimit.

- Malli është marrë në dorëzim në datë 17.01.2022 nga komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga S.K., J.K. dhe M.N..

³ https://spending.data.al/en/treasury/list/faqe/1/year/2019/perf_id/NGSTRUCTURES

- Fletë-Hyrja në magazinën e institucionit është me nr. 2, datë 17.01.2022.
- Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 3/2022, datë 17.01.2022, në vlerën 364,095 lekë me Tvsh. (Likuidim pjesor).

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje kontenierë për grumbullimin e mbetjeve urbane Bashkia Tepelenë”.

Urdhëri i prokurimit është me nr. 8, datë 20.01.2022, për prokurimin me vlerë të vogël “Blerje konteniere për grumbullimin e mbetjeve urbane Bashkia Tepelenë”.

Me procesverbalin datë 17.01.2022 sipas urdhërit nr. 7, datë 02.01.2022 nga komisioni i përbërë nga K.S., V.P., G.G., R.H. dhe D.A., është përlogaritur fondi limit për objektin si më sipër, në shumën 1,000,000 lekë pa Tvsh.

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 8 prot., datë 20.01.2022, me specifikimet teknike bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga operatori ekonomik i renditur i pari, pranë AK përpara se të shpallet fituesi.

Ftesa për ofertë drejtuar minimalisht 5 OE.

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ngritur sipas urdhërit nr. 7/1, datë 05.01.2022 me përbërje S.K., J.K. dhe M.N.. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 17 OE me 17 oferta të ndryshme, nga të cilët janë kualifikuar 17, ku operatori ekonomik i renditur në vendin e parë është OE “A.Y.” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 788,000 lekë pa Tvsh.

- OE Fitues është njoftuar në datë 25.01.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

OE “A.Y.” Shpk, sipas procesverbalit të datës 26.01.2022 është skualifikuar pasi nuk u paraqit në afatin e përcaktuar në ftesën për ofertë.

Është kaluar te OE i rradhës “A.C.” i renditur i dyti me ofertën në vlerë 825,000 lekë pa tvsh.

Sipas procesverbalit të datës 27.01.2022 OE “A.C.” është skualifikuar për arsye se nuk u paraqit në afatet e përcaktuara në ftesën për ofertë.

Është vijuar me OE të rradhës “E.N.” PF, i renditur i treti me ofertë në vlerën 900,000 lekë pa tvsh i cili është skualifikuar sipas process verbalit të datës 28.01.2022 për arsye se është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK. Sipas informacionit pasqyruar në dokumentat e vlerësimit të ofertave, OE “E.N.” PF ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes e cila paraqitet në sistemin e prokurimit.

Është vijuar me OE të rradhës “E.”, i renditur i katërti me ofertë në vlerën 900,000 lekë pa Tvsh. Sipas process verbalit të datës 31.01.2022 është skualifikuar për arsye se nuk u paraqit në afatin e përcaktuar për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës.

Është vijuar me OE të rradhës “H.G.C.”, i renditur i pesti me ofertë në vlerën 950,000 lekë pa Tvsh. Sipas process verbalit datë 01.02.2022 është skualifikuar pasi është tërhequr nga vazhdimi i mëtejshëm i procedurës. Sipas informacionit pasqyruar në dokumentat e vlerësimit të ofertave, OE “H.G.C.” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes e cila paraqitet në sistemin e prokurimit.

Është vijuar me OE “D.” shpk i cili është paraqitur me ofertën në vlerën 958,000 lekë pa Tvsh.

- OE Fitues është njoftuar në datë 01.02.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

- Malli është marrë në dorëzim në datë 21.02.2022 nga komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga S.K., J.K. dhe M.N..

- Fletë-Hyrja në magazinën e institucionit me nr. 9, datë 21.02.2022.

- Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 12/2022 datë 21.02.2022, në vlerën 1,149,600 lekë me Tvsh.

3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje dru zjarri për shërbimin e ngrohjes në institucionet shkollore”.

Urdhëri i prokurimit është me nr. 2, datë 06.01.2022, për prokurimin me vlerë të vogël “Blerje dru zjarri për shërbimin e ngrohjes në institucionet shkollore”.

Me procesverbalin datë 05.01.2022 sipas urdhërit nr. 7, datë 02.01.2022 nga komisioni i përbërë nga K.S., V.P., G.G., R.H. dhe D.A., është përlogaritur fondi limit për objektin si më sipër, në shumën 500,000 lekë pa Tvsh.

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 2 prot., datë 06.01.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga fituesi pranë AK ditën e nesërme nga shpallja e fituesit.

Ftesa për ofertë drejtuar minimalisht 5 OE.

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ngritur sipas urdhërit nr. 7/1, datë 05.01.2022 me përbërje S.K., J.K. dhe M.N.. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 13 OE me 13 oferta të ndryshme, nga të cilët janë kualifikuar 5, ku operatori ekonomik i renditur në vendin e parë OE “J. & Sh.” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 395,000 lekë pa Tvsh.

- OE Fitues është njoftuar në datë 10.01.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
- Malli është marrë në dorëzim në datë 11.02.2022 nga komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga S.K., J.K. dhe M.N..
- Fletë-Hyrja në magazinën e institucionit me nr. 6, datë 11.02.2022.
- Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 2/2022 datë 17.02.2022, në vlerën 237,000 lekë me Tvsh. (Likuidim pjesor).

4. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje beton i gatshëm, zgara hekuri, bordure betoni”.

Urdhëri i prokurimit është me nr. 36, datë 08.07.2022, për prokurimin me vlerë të vogël “Blerje beton i gatshëm, zgara hekuri, bordure betoni”.

Me procesverbalin datë 05.07.2022 sipas urdhërit nr. 7, datë 02.01.2022 nga komisioni i përbërë nga K.S., V.P., G.G., R.H. dhe D.A., është përlogaritur fondi limit për objektin si më sipër, në shumën 1,000,000 lekë pa Tvsh.

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 36/1 prot., datë 08.07.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga fituesi pranë AK ditën e nesërme nga shpallja e fituesit.

Ftesa për ofertë drejtuar minimalisht 5 OE.

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ngritur sipas urdhërit nr. 7/1, datë 05.01.2022 me përbërje S.K., J.K. dhe M.N.. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 10 OE me 10 oferta të ndryshme, nga të cilët janë kualifikuar 10, ku operatori ekonomik i renditur në vendin e parë OE “L.Xh.” PF me ofertën më të ulët, në vlerën 767,000 lekë pa Tvsh.

- OE Fitues është njoftuar në datë 12.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
- OE është skualifikuar sipas procesverbalit të datës 28.01.2022 për arsye se është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK. Sipas informacionit pasqyruar në dokumentat e vlerësimit të ofertave, OE “L.Xh.” PF ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes e cila paraqitet në sistemin e prokurimit.

Është vijuar me OE i renditur i dyti “E.” shpk i cili është paraqitur me ofertën në vlerë 885,000 lekë pa Tvsh.

- OE Fitues është njoftuar në datë 13.07.2022, nëpërmjet sistemit të prokurimit.
- Malli është marrë në dorëzim në datë 20.07.2022, nga komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga S.K., J.K. dhe M.N..
- Fletë-Hyrja në magazinën e institucionit me nr. 5, datë 20.07.2022.

- Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 23/2022, datë 20.07.2022, në vlerën 499,680 lekë me Tvsh. (Faturë pjesore).

5. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Mirëmbajtje instituciuone shkollore Bashkia Tepelenë”.

Urdhëri i prokurimit është me nr. 33, datë 23.06.2022, për prokurimin me vlerë të vogël “Mirëmbajtje instituciuone shkollore Bashkia Tepelenë”.

Me procesverbalin datë 20.06.2022 është hartuar preventivi për këtë objekt nga ing. M.B., ing. M.Sh., miratuar nga titullari AK, në vlerën 1,000,000 lekë pa Tvsh.

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 33/1 prot., datë 23.06.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga OE i rendituri i pari pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

Ftesa për ofertë drejtuar minimalisht 5 OE.

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ngritur sipas urdhërit nr. 7/1, datë 05.01.2022 me përbërje S.K., J.K. dhe M.N.. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 19 OE me 19 oferta të ndryshme, nga të cilët janë kualifikuar 18, ku operatori ekonomik i renditur në vendin e parë OE “F.S.C.” shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 679,000 lekë pa Tvsh.

- OE Fitues është njoftuar në datë 27.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

- OE është skualifikuar sipas process verbalit të datës 28.06.2022 për arsye se nuk është paraqitur sipas afateve të përcaktuara në ftesën për ofertë.

- Është vijuar me OE i renditur i dyti “Xh.S.” PF i cili është paraqitur me ofertën në vlerë 747,000 lekë pa Tvsh.

- OE Fitues është njoftuar në datë 28.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Është lidhur kontrata e kryerjes së shërbimit me nr. Ref. 1552, datë 30.06.2022.

Është marrë në dorëzim sipas situacionit të administruar në dosje me proces verbalin datë 6.10.2022 nga komisioni i marrjes në dorëzim A.Sh., A.J. dhe G.C., miratuar nga titullari AK. Likuidimi sipas faturës tatimore 09/2022, datë 6.10.2022, në vlerën 896,400 lekë me Tvsh.

6. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Mirëmbajtje kanale ujitëse Kodër-Luzat-Dukaj”.

Urdhëri i prokurimit është me nr. 21, datë 08.04.2022, për prokurimin me vlerë të vogël “Mirëmbajtje kanale ujitëse Kodër-Luzat-Dukaj”.

Me procesverbalin datë 20.06.2022 është hartuar preventive për këtë objekt i hartuar nga ing. G.Sh., ing. M.Sh., miratuar nga titullari AK, në vlerën 1,000,000 lekë pa Tvsh.

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 21/1 prot., datë 08.04.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga OE i rendituri i pari pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

Ftesa për ofertë drejtuar minimalisht 5 OE.

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ngritur sipas urdhërit nr. 7/1, datë 05.01.2022 me përbërje S.K., J.K. dhe M.N.. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 17 OE me 17 oferta të ndryshme, nga të cilët janë kualifikuar 14, ku operatori ekonomik i renditur në vendin e parë OE “E.” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 504,400 lekë pa Tvsh.

- OE Fitues është njoftuar në datë 12.04.2022, nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Është lidhur kontrata e kryerjes së shërbimit me OE fitues “E.” Shpk.

Është marrë në dorëzim sipas situacionit të administruar në dosje me proces verbalin datë 12.05.2022 nga komisioni i marrjes në dorëzim G.Sh., M.Sh. dhe L.Sh., miratuar nga titullari AK.

Likuidimi sipas faturës tatimore 49/2022, datë 12.05.2022, në vlerën 605,280 lekë me Tvsh.

2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.

Nga auditimi, u konstatua se:

1. Kontrata nr. 2054/4 prot., datë 16.12.2022, me objekt “Furnizim dhe vendosje matsash uji në pallatet me kollonë të brendshme, qyteti Tepelenë”, e lidhur në datën 16.12.2022, me afat 60 ditë, me vlerë 12,244,051 lekë pa TVSh dhe 14,692,861 lekë me TVSh, ka përfunduar në datën 15.02.2023, brenda afatit të kontraktuar. Në Formularin e raportimit për zbatimin e kontratës nuk janë paraqitur probleme gjatë zbatimit.

2. Kontrata nr. 1075/2 prot., datë 16.06.2022, me objekt “Blerje makinë teknologjike pastrimi për nevoja të Bashkisë Tepelenë”, e lidhur në datën 16.06.2022, pa afat, me vlerë 3,998,000 lekë pa TVSh dhe 4,797,600 lekë me TVSh, ka përfunduar pa cilësuar vonesa në lidhje me afatin. Në Formularin e raportimit për zbatimin e kontratës nuk janë paraqitur probleme gjatë marrjes në dorëzim të automjetit.

3. Kontrata nr. 2546/6, prot., datë 30.12.2022, me objekt “Sistemim-asfaltim rrugë në qytet dhe rruga veriore Dragot”, e lidhur në datën 30.12.2022, me afat 45 ditë, me vlerë 10,325,179 lekë pa TVSh dhe 12,390,214.3 lekë me TVSh, ka përfunduar në datën 02.05.2023, brenda afatit të ndryshuar të kontratës. Në datën 31.12.2022, me kërkesë të sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit të punimeve është bërë pezullim i punimeve për shkak të kushteve atmosferike (reshje shiu, ngrica, etj.) dhe është bërë njoftim për rifillim të punimeve në datën 21.03.2023. Në Formularin e raportimit për zbatimin e kontratës nuk janë paraqitur probleme gjatë zbatimit.

Të dhënat për kontratat e lidhura nga Bashkia Tepelenë, janë paraqitur në Aneksin P3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

2.5.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit;

2.5.2. Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj;

Auditimi konsistoi në këto fusha:

1. Dhënia e lejes së zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
2. Dhënia e lejes së ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i kondicioneve urbane.
3. Saktësia e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë.
4. Dhënia e certifikatës së përdorimit

Nga auditimi, u konstatua se Bashkia Tepelenë, nuk ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe është ende në proces. Lejet e ndërtimit janë miratuar në zbatim të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr.1, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore” i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 5, datë 9.12.2014 “Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe hartimi të hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban”, i ndryshuar.

➤ **Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për vitin 2022**

Duke iu referuar sistemit e-Leje, të lejeve të ndërtimit dhe në bazë të informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Tepelenë, gjatë vitit 2022 janë zhvilluar 39 aplikime për leje, nga të cilat janë miratuar **22 leje** ndërtimi, të paraqitura në Aneksin L1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Tepelenë, për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m² është miratuar **1 leje** ndërtimi, për ndërtim të ri deri në 250 m² është miratuar **1 leje** ndërtimi, për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m² janë miratuar **2 leje** ndërtimi dhe **2** çertifikata përdorimi, të paraqitura në Aneksin L2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit, janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e mëposhtme të lejes të zhvillimit, të lejes së ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe më të madhe se 250 m² dhe të certifikatës të përdorimit, të përshkruara më poshtë.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me miratimin e lejes së ndërtimit pa u pajisur me leje zhvillimi.

Të dhënat e lejeve të ndërtimit në Bashkinë Tepelenë janë paraqitur në Aneksin L3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Titulli i gjetjes: Miratimi i lejes së ndërtimit pa u pajisur me leje zhvillimi.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se leja e ndërtimit për objektin “*Strukturë akomoduese në funksion të turizmit*”, miratuar me vendimin nr. LNM 311221, datë 14.02.2022, me zhvillues “E.Z.” ShPK, në qendër të qytetit Tepelenë, është miratuar pa miratuar më parë një leje zhvillimi për ndërtimin e një objekti të ri dhe në përputhje me parametrat urbanë të lejuar.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për “*Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar, neni 38, “*Leja e zhvillimit*”, VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 9, “*Leja e zhvillimit*”, pika 1 dhe neni 14, “*Kushtet për lëshimin e lejes së ndërtimit*”, pika 1.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e lejes së zhvillimit ndikon në përcaktimin e kushteve zhvillimore për pronën në të cilën do të realizohet objekti, të tilla si: përdorimin e tokës dhe strukturat e lejueshme; intensitetin e ndërtimit; koeficientin e shfrytëzimit të tokës për ndërtim; lartësinë maksimale në metra; distancat; gjelbërimin publik; parkimin; informacion rreth kufizimeve apo kushtëzimeve të veçanta në pronën përkatëse;etj.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa miratuar më parë lejen e zhvillimit dhe përcaktimin e kushteve zhvillimore.

Gjatë auditimit të lejeve të zhvillimit, u konstatua 1 praktikë në të cilën situata në lidhje me miratimin e lejes së zhvillimit pasqyrohej jo në përputhje me kushtet bazë të kontratës së marrë me qira për zhvillimin e parcelës.

Titulli i gjetjes: Miratimi i lejes së zhvillimit jo në përputhje me kushtet bazë të kontratës së marrë me qira për zhvillimin e parcelës.

Situata: Nga auditimi u konstatua se për objektin “*Shtëpiza druri, kotec dhe ambiente për turizëm rural*”, për të cilën është marrë vendimi nr. LZH260422 për leje zhvillimi, datë 10.06.2022 dhe vendimi për deklaratën paraprake nr. DP011222, datë 02.12.2022, me zhvillues A.R., në fshatin Rexhinë, Tepelenë, leja e zhvillimit nuk është në përputhje me kushtet bazë të kontratës së marrë me qira për zhvillimin e parcelës, pasi parcela në të cilën për të cilën është miratuar leja e zhvillimit është pasuri shtetërore në përdorim të bashkisë, me statusin arë. Kjo

pasuri është dhënë në qira për 99 vjet, me anë të kontratës së qirasë (kontrata bazë) të lidhur ndërmjet Bashkisë Tepelenë (Qiradhënësi) dhe personit fizik S.H. (Qiramarrësi), në datën 10.12.2021. Më pas është zhvilluar një kontratë nënqiraje, e cila në bazë të nenit 2 të kontratës tip për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, pika vi, përcaktohet që nuk lejohet dhënia me nënqira e tokës bujqësore, objekt i kësaj kontrate; Gjithashtu, në kushtet e kontratës përcaktohet se përdorimi i pasurisë duhet të zhvillohet në bazë të kriterëve të mëposhtme: i. toka objekt i kësaj kontrate do të përdoret në përputhje me legjislacionin në fuqi për tokën bujqësore dhe vetëm për veprimtari bujqësore dhe blegtorale, që përcaktohet në planin e biznesit të veprimtarisë, modeli i të cilit miratohet me udhëzim të ministrit. ii. do të ruajë funksionet natyrore që përmbush toka bujqësore si kategori resursi; iii. do të zbatohet një praktikë të mirë bujqësore të përcaktuar në nenin 16, të Ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 “*Për mbrojtjen e tokës bujqësore*”, të ndryshuar; Në bazë të VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “*Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*”, pika vi., “*Afatet e dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*”, përcaktohet se: c) Deri në 99 vjet, kur: i. destinohen për krijim ullishtash; ii. destinohen për krijim pemëtoresh me drufrutorë, si kulturat arvore dhe specie të tjera, moshë biologjike e të cilave përkon me këtë kohëzgjatje; iii. veprimtaria sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, shoqërohet me investime për përpunimin e prodhimeve të marra nga toka e dhënë me qira. Gjithashtu edhe në kontratën e qirasë (kontrata bazë) të lidhur ndërmjet Bashkisë Tepelenë (Qiradhënësi) dhe personit fizik S.H. (Qiramarrësi), me datë 10.12.2021, në bazë të vendimit nr. 18, datë 30.09.2021, në të cilën shpallet fitues i procedurës konkurruese të shpallur me ftesë për ofertë nr. 1549/1 prot., datë 30.08.2021, në lidhje me marrjen me qera të pasurisë tokë bujqësore e pandarë për 99 vjet, në planin e biznesit paraqitet qëllimi për kultivimin e pemëve arvore të llojit arë dhe jo për qëllim të zhvillimit të strukturave dhe ndërtimeve në funksion të turizmit rural. Kontrata e dytë e lidhur për dhënien me nënqira nuk përkon me qëllimin dhe kushtet e kontratës bazë. Pas lidhjes së nënkontratës është miratuar leja e zhvillimit për ndërtimin e një kompleksi me shtëpiza druri dhe ambiente në shërbim të turizmit rural, funksione të cilat nuk përkojnë me kushtet baza të kontratës dhe zhvillimin e kultivimin e pemëve arvore. Në planvendosjen e miratuar në lejen e zhvillimit parashikohet realizimi i 8 objekteve (shtëpizave të banimi), një kotec dhe një objekt që ofron shërbime. Objektet lidhen ndërmjet tyre nëpërmjet akseve të qarkullimit dhe hapësirave të parkimit, duke çenuar tokën bujqësore.

Kriteri: Ligji nr. 9244, datë 17.6.2004 “*Për mbrojtjen e tokës bujqësore*”, i ndryshuar, VKM nr. 373, datë 20.6.2018, “*Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*”, në kushtet e kontratës tip për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, neni 2, pika vi.

Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara sipas kushteve të kontratës dhe ndryshimi i qëllimit të përdorimit të tokës bujqësore, ndikon në ruajtjen e kultivimin e pemëve në parcelën që do të zhvillohet ndërtimi dhe çënon tokën bujqësore me ndërtime e infrastrukturë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të ruajtur dhe mbrojtur tokën bujqësore nga ndërtimet që nuk janë në përputhshmëri me kushtet e kontratës dhe planin e biznesit të miratuar në dhënien me qera të tokës bujqësore të pandarë.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me realizimin e punimeve të ndërtimit pa zhvilluar njoftim fillim punimesh dhe miratimit të lejes së ndërtimit pas përfundimit të karabinasë.

Titulli i gjetjes: Realizimi i punimeve të ndërtimit pa zhvilluar njoftim fillim punimesh dhe miratimi i lejes së ndërtimit pas përfundimit të karabinasë.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se për objektin “*Strukturë akomoduese në funksion të turizmit*”, për të cilën është marrë vendimi nr. LNM 311221, datë 14.02.2022, me zhvillues “E.Z.” ShPK, në qendër të qytetit Tepelenë, është miratuar më parë një leje rikonstruksioni me Vendimin nr. EZ-LNSHNE191020, datë 11.11.2020 dhe kanë zhvilluar njoftim fillim punimesh nr. EZ-NJFP030421, datë 03.04.2021. Pas fillimit të punimeve me anë të një procesverbali janë pezulluar punimet për arsye të qëndrueshmërisë së konstruksionit dhe kostos së rindërtimit. Pas saj objekti ekzistues është prishur dhe kanë vijuar me ndërtimin e karabinasë. Nga verifikimi i fotove ajrore dhe duke u bazuar në kronologji, objekti ka qenë në fazë ndërtimi të karabinasë në muajin gusht 2021 dhe në muajin qershor 2022 karabinaja ka përfunduar. Objekti i ri i ndërtimit zhvillohet jashtë konfigurimit të objektit ekzistues. Leja për ndërtimin e ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m² është miratuar pas fillimit të punimeve dhe ndërtimit të karabinasë. Pas miratimit të lejes së ndërtimit, nuk është bërë njoftim fillim punimesh dhe nuk janë mbajtur aktet e kontrollit, a) Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues; b) Piketimi i strukturës; c) Përfundimi i themeleve dhe kuota 0; ç) Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin; Gjithashtu nuk është shënuar prishja e objektit ekzistues.

Kriteri: Ligji 107/2014, datë 31.7.2014, “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, neni 40, pika 1, Ligji nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, neni 39, pika 4, VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 27/1, “*Mbikëqyrja e punimeve*”, pika 1.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e verifikimeve në terren përpara miratimit të lejes së ndërtimit dhe lejes së zhvillimit ndikon në realizimin e ndërtimeve pa u pajisur me leje ndërtimi dhe zhvillimin e tyre duke mos qenë në përputhje me kondicionet urbane, duke cënuar zhvillimit të objekteve të reja në parcelat me të cilat kufizohet.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të miratuar lejen e ndërtimit përpara fillimit të punimeve të ndërtimit, të zhvillohet njoftimi i fillimit të punimeve dhe të mbahen aktkontrolltet për fazat e ndërtimit që vijnë pas njoftimit të fillimit të punimeve, duke verifikuar konformitetin e tyre gjatë ndërtimit.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mosparaqitjen e mënyrës së aksesit në parkimin nëntokësorë dhe dalja e konsolave (ballkoneve) jashtë kufirit të pronësisë.

Titulli i gjetjes: Mosparaqitja në planvendojen e miratuar për leje ndërtimi e mënyrës së aksesit në parkimin nëntokësor dhe dalja e konsolave (ballkoneve) jashtë kufirit të pronësisë.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se për objektin “*Strukturë akomoduese në funksion të turizmit*”, për të cilën është marrë vendimi nr. LNM 311221, datë 14.02.2022, me zhvillues “E.Z.” ShPK, në qendër të qytetit Tepelenë, në planvendosjen e miratuar nuk paraqitet mënyra e aksesit në parkimin nëntokësor dhe mënyra e vetme e aksesimit është duke kaluar nëpërmjet pronave kufizuese, jashtë pronësisë në të cilën zhvillohet. Gjithashtu në anën veriore të orientimit të fasadës, daljet konsol pozicionohen jashtë kufirit të pronësisë.

Kriteri: VKM 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, neni 15, pika 1, gërma b;

Ndikimi/Efekti: Mosparaqitja e mënyrës së aksesit në parkimin nëntokësor dhe dalja e konsolave (ballkoneve) jashtë kufirit të pronësisë ndikon në cënimin e pasurive të tjera kufizuese, duke e shtrirë zhvillimin jashtë parcelës për të cilën aplikon për leje ndërtimi.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa verifikuar mënyrën e aksesit në objektin që do të zhvillohet dhe gjurma e objektit të zhvillohet brenda kufirit të pronësisë për të cilën është zhvilluar aplikimi dhe në përputhje me dokumentacionet që vërtetojnë të drejtat pasurore të zhvilluesit.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 4 praktika në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë në lidhje me mosrespektimin e distancave të lejuara nga kufiri i pronës, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

Titulli i gjetjes: Mosrespektimi i distancave të objektit nga kufiri i pronës, në kundërshtim me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se për objektet e mëposhtme nuk janë respektuar distancat ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës sipas kritereve të Rregullores së Zhvillimit të Territorit:

1. “*Strukturë akomoduese në funksion të turizmit*”, për të cilën është marrë vendimi nr. LNM 311221, datë 14.02.2022, me zhvillues “E.Z.” ShPK, në qendër të qytetit Tepelenë. Nga verifikimi i planvendosjes së miratuar, u evidentua që distanca minimale ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës është 2.92 metra. Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës duhet të ishte 6 metër për objektin në lartësinë e 5 kateve dhe 5 metër për objektin në lartësinë e 4 kateve.

2. “*Banesë dy katëshe + një kat podrum në Progonat, Tepelenë*”, për të cilën është marrë vendimi nr. AQ-LN100622, datë 21.11.2022, me zhvillues A.Q., në Progonat, Tepelenë. Nga verifikimi i planvendosjes së miratuar, u evidentua që distanca minimale ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës është 1.6 metra. Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës, për objektin në lartësinë e 3 kateve duhet të ishte 4 metra.

3. “*Bujtinë 2 kate + 1 kat nëntokë*”, për të cilën është miratuar çertifikata e përdorimit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues “G.A.” ShPK, në fshatin Dukaj, Tepelenë. Nga verifikimi i planvendosjes së miratuar, u evidentua që në orjentimin verior, distanca minimale ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës është 1.8 metra. Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës, për objektin në lartësinë e 2 kateve duhet të ishte 3 metra dhe me ndryshimin e projektit, për objektin në lartësinë e 3 kateve duhet të ishte 4 metra.

4. “*Objekt katër kate, me dy kate nën tokë, me destinacion bar-restorant dhe hoteleri*”, për të cilën është miratuar çertifikata e përdorimit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues B.I.H., në zonën e Ujit të ftohtë, Tepelenë. Distancat e objektit nga kufiri i pronës nuk janë respektuar, në bazë të VKM-së 408, pasi është zhvilluar një marrëveshje e cila miraton mosrespektimin e distancave të paraqitura në planvendosje dhe në mos përputhje me bazën ligjore në fuqi. Distanca që duhet të të respektohet nga kufiri i pronës për objektin në lartësinë e 6 kateve është 7 metra.

Kriteri: VKM 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 35, “*Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës*”.

Ndikimi/Efekt: Mosrespektimi i distancës nga kufiri i pronës çënon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe zhvillimin e mëtejshëm të ndërtimeve të reja në parcelat me të cilat kufizohet, në orjentimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në të cilën pasqyrohej situata në lidhje me mosrespektimin e distancave ndërmjet objekteve, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

Titulli i gjetjes: Mosrespektimi i distancave ndërmjet objekteve, në kundërshtim me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se për objektin “*Strukturë akomoduese në funksion të turizmit*”, për të cilën është marrë vendimi nr. LNM 311221, datë 14.02.2022, me zhvillues “E.Z.” ShPK, në qendër të qytetit Tepelenë, distanca minimale ndërmjet objekteve është 3 metra. Distanca minimale midis ndërtimeve, midis objektit që do të zhvillohet në lartësinë e 4 kateve dhe objektit ekzistues në lartësinë e 2 kateve duhet të ishte 8 metra.

Kriteri: VKM 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 34, “*Distanca minimale midis ndërtimeve*”.

Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i distancës ndërmjet ndërtimeve ndikon në orjentimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Tepelenë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara midis ndërtimeve.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit, u konstatuan 3 praktika në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë në lidhje me mospërcaktimin e saktë të numrit të kateve në planvendosje dhe në lejen e ndërtimit të miratuar, në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.

Titulli i gjetjes: Mospërcaktimi i saktë i numri të kateve në planvendosje dhe në lejen e ndërtimit të miratuar, në kundërshtim me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se për objektet e mëposhtme në planvendosje dhe në lejen e ndërtimit të miratuar, nuk pasqyrohej saktë numri i kateve dhe lartësia e objektit sipas projektit të ndërtimit:

1. “*Banesë dy katëshe + një kat podrum në progonat, Tepelenë*”, për të cilën është marrë vendimi nr. AQ-LN100622, datë 21.11.2022, me zhvillues A.Q., në Progonat, Tepelenë. Sipas VKM-së 408, neni 37, pika 3/b, “*Kati nëntokë, që sipas rastit mund të jetë emërtuar edhe “Bodrum”, është vëllimi i ndërtimit të katit të objektit, i cili vendoset tërësisht ose kryesisht nëntokë, me kusht që kuota e sipërme e tij e matur në dyshemenë e përfunduar të katit mbi katin nëntokë, të mos jetë më shumë se 1 metër mbi nivelin e kuotës së sistemuar të trotuarit ose sheshit rrethues të jashtëm të strukturës*”. Objekti në fjalë është në lartësinë e 3 kateve mbi tokë dhe jo në lartësinë e dy kateve, pasi ajo që përcaktohet si bodrum ka akses të drejtpërdrejtë në planin me sistemimin e jashtëm.

2. “*Bujtinë 2 kate + 1 kat nëntokë*”, për të cilën është miratuar çertifikata e përdorimit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues “G.A.” ShPK, në fshatin Dukaj, Tepelenë. Me ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, ka ndryshuar edhe numri i kateve të objektit, pasi është rritur lartësia e objektit. Nga një objekt 2 katësh me çati, ka ndryshuar në një objekt me lartësinë e 3 kateve, nga lartësia 8.55 metra nga kuota e ± 0.00 , në lartësinë 10.12 metra nga kuota ± 0.00 .

3. “*Objekt katër kate, me dy kate nën tokë, me destinacion bar-restorant dhe hoteleri*”, për të cilën është miratuar çertifikata e përdorimit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues B.I.H., në zonën e ujit të ftohtë, Tepelenë. Leja e ndërtimit është miratuar për një objekt në lartësinë e katër kateve mbi tokë dhe dy kate nëntokë. Sipas VKM-së 408, në rastin e ndërtesave të vendosura në terrene me pjerrësi, lartësia në metra jepet në mënyrë të posaçme

për të dyja faqet e strukturës në secilën anë të terrenit të pjerrët, objekti është në lartësinë e 6 kateve mbi tokë.

Kriteri: VKM 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 37, “Lartësia e ndërtimeve”.

Ndikimi/Efekti: Mosparaqitja e saktë e numrit të kateve në planvendosje dhe në lejen e ndërtimit të miratuar ndikon në elementët e mëposhtëm: lartësinë e strukturave ekzistuese përreth strukturës së re; normat e lejuara të distancave; vlerat mjedisore dhe ekologjike në zonë; diellëzimin dhe orientimin; respektimin e normave mjedisore.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje të dhënat e paraqitura në planvendosje, në mënyrë që të jënë në përputhje me projektin e ndërtimit dhe të përcaktohet saktë lartësia dhe numri i kateve të objektit.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në të cilën aplikimi për lejen e ndërtimit nuk është bërë në kategorinë e lejeve të ndërtimit mbi 250 m², por leja e ndërtimit është miratuar në kategorinë deri në 250 m², duke shmangur e thjeshtësuar disa kriteret të tjera që duhet të plotësojë për miratimin e lejes së ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Titulli i gjetjes: Aplikimi i lejes së ndërtimit jo në përputhshmëri me kategorinë e lejes.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se për objektin “Banesë dy katëshe + një kat podrum në Progonat, Tepelenë”, për të cilën është marrë vendimi nr. AQ-LN100622, datë 21.11.2022, me zhvillues A.Q., në Progonat, Tepelenë, Leja e ndërtimit është miratuar në kategorinë për objekte deri në 250 m², duke shmangur e thjeshtësuar disa kriteret të tjera që duhet të plotësojë për miratimin e lejes së ndërtimit, por sipas legjislacionit në fuqi, duhet të ishte aplikuar në kategorinë e objektit mbi 250 m² dhe nevojitet që të pajisej edhe me dokumentacione të tjera plotësuese, projektin e instalimeve elektrike, hidrosanitar, të instalimeve ngrohje-ftohje, për kategorinë mbi 250 m², pasi objekti ka sipërfaqe totale ndërtimi 280,8 m² duke përfshirë në sipërfaqe ndërtimi edhe daljet konsol, ballkonet.

Kriteri: VKM 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 15, “Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi”.

Ndikimi/Efekti: Aplikimi në kategorinë e ndryshme të lejes së ndërtimit, ndikon në mosplotësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm që nevojitet për të miratuar lejen e ndërtimit dhe ndikon në miratimin e saj jo në konformitet me legjislacionin në fuqi.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje aplikimin e lejeve të ndërtimit dhe sipërfaqeve të ndërtimit, në mënyrë që mos lejohen aplikime të cilat nuk janë në përputhje me kategorinë përkatëse dhe dokumentacioni për aplikimin e lejes së ndërtimit të jetë i plotë.

Gjatë auditimit të çertifikateve të përdorimit u konstatua 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mospërputhjen e realizimit të punimeve të ndërtimit me lejen e ndërtimit të miratuar dhe ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit duke tejkaluar masën 2% të sipërfaqes ndërtimore.

Titulli i gjetjes: Mospërputhja e realizimit të punimeve të ndërtimit me lejen e ndërtimit të miratuar dhe ndryshimi i projektit të ndërtimit gjatë ndërtimit duke tejkaluar masën 2% të sipërfaqes ndërtimore.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se për objektin “*Bujtinë 2 kate + 1 kat nëntokë*”, për të cilën është miratuar çertifikata e përdorimit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues “G.A.” ShPK, në fshatin Dukaj, Tepelenë, në bazë të lejes së ndërtimit të miratuar me Vendimin nr. LN220720, datë 07.10.2020 dhe ndryshuar me Vendimin nr. LNP290521, datë 08.06.2021, Leja e parë e ndërtimit është miratuar për realizimin e një objekti me funksionin e bujtinës në lartësinë e dy kateve dhe 1 kati nëntokë. Pas fillimit të punimeve të ndërtimit është aplikuar për ndryshim projekti. Në bazë të VKM-së 408, Neni 17, germa e), ndryshimet që rezultojnë në ndryshimin e sipërfaqes ndërtimore të objektit, mbi tokë dhe nën tokë, brenda kufijve dhe kushteve urbane të zhvillimit, me kusht që ndryshimi i sipërfaqes ndërtimore mbi tokë të mos tejkalojë masën 2% të sipërfaqes ndërtimore mbi tokë të miratuar në lejen e ndërtimit. Projekti i ndryshuar e tejkalon masën e ndryshimit 2% pasi ka shtuar sipërfaqen e ndërtimit në katin e çatisë duke e bërë të shfytëzueshme dhe ka shtuar sipërfaqe ndërtimi në katin nëntokë. Ndryshimi i projektit të ndërtimit ndikon në ndryshimin e numrit të kateve nga 2 kate me çati në objekt me lartësinë e 3 kateve, nga lartësia 8.55 metra nga kuota e ±0.00, në lartësinë 10.12 metra nga kuota ±0.00 dhe ndryshuar kondicionet urbane.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, neni 42, “*Çertifikata e përdorimit*”, VKM 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 17, pika e dhe nenet 27 dhe 27/1.

Ndikimi/Efekti: Miratimi i ndryshimit të projektit gjatë ndërtimit duke tejkeluar sipërfaqen ndërtimore kërkon aplikimin për një leje të re ndërtimi, pasi ndikojnë në ndryshimin e kondicioneve urbane që janë miratuar në lejen e zhvillimit dhe lejen e ndërtimit. Realizimi i ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar ndikon në zhvillimin e ndërtimeve në mospërputhje me parametrat dhe kriteret e zhvillimit urban, të tilla si distanca nga kufiri I pronës, distanca ndërmjet objekteve, në orjentimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të mos pajisur me çertifikatë përdorimi dhe miratuar ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit pa verifikuar më parë masën e ndryshimit të sipërfaqeve ndërtimore në projekt dhe duke verifikuar realizimin e zbatimit të punimeve në përputhje me projektin e ndërtimit të miratuar.

Gjatë auditimit të çertifikatave të përdorimit, u konstatua 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mosparaqitjen në planvendosjen e miratuar në lejen e ndërtimit aksesit për në parcelën që do të zhvillohet ndërtimi dhe miratimi i çertifikatës së përdorimit pas realizimit të sistemimit të jashtëm të objektit.

Titulli i gjetjes: Mosparaqitja në planvendosjen e miratuar për leje ndërtimi e mënyrës së aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimi dhe miratimi i çertifikatës së përdorimit pas realizimit të sistemimit të jashtëm të objektit.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se për objektin “*Objekt katër kate, me dy kate nën tokë, me destinacion bar-restorant dhe hoteleri*”, për të cilin çertifikata e përdorimit është miratuar pas realizimit të sistemimit të jashtëm të objektit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues B.I.H., në zonën e Ujit të ftohtë, Tepelenë, në planvendosjen e miratuar në lejen e ndërtimit nuk pasqyrohet mënyra e aksesit në parcelën që është zhvilluar ndërtimi. Sipas planvendosjes, objekti nuk ka pasur akses të drejtpërdrejtë nga infrastruktura kryesore ose dytësore, pa aksesuar nëpërmjet pronave kufizuese. Dhënia e lejes së ndërtimit kushtëzohet nga ekzistenca e infrastrukturës kryesore dhe dytësore në njësinë ku kërkohet ndërtimi. Nga verifikimi i zbatimit të punimeve dhe fotografitë e pasqyruara në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje për miratimin e çertifikatës së përdorimit, u konstatua që është zhvilluar një

aks lidhës ndërmjet aksist kryesorë rrugor dhe parcelës në të cilën është zhvilluar ndërtimi, si dhe një hapësirë parkimi në funksion të objektit. Sipërfaqja në të cilën është realizuar infrastruktura dhe hapësira e parkimit është marrë me qera nga bashkia, në bazë të kontratës për përdorim e fondit pyjor dhe kullor dhe nuk është pjesë e lejes së ndërtimit.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 42, “Çertifikata e përdorimit”, Ligji nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyje”, neni 12, VKM 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 27/1, pika 1, gërma dh, “Përfundimi i sistemit të jashtëm”, neni 14, pika 2.

Ndikimi/Efekti: Mospasqyrimi i mënyrës së aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimit në planvendosjen e miratuar në lejen e ndërtimit dhe realizimi i aksesit në zbatimin e punimeve ndikon në cënimin e pasurive të tjera kufizuese dhe ndryshimin e destinacionit të përcaktuar në përdorimin e fondit pyjor dhe kullor.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të mos pajisur me çertifikatë përdorimi dhe miratuar leje ndërtimi pa konfirmuar më parë mënyrën e aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimi.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mungesën e pajisjes me çertifikatës së përdorimit, pas miratimit të lejes së ndërtimit.

Titulli i gjetjes: Mungesa e çertifikatës së përdorimit pas miratimit të lejes së ndërtimit.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se për objektin “Banesë dy katëshe + një kat podrum në Progonat, Tepelenë”, për të cilën është marrë vendimi nr. AQ-LN100622, datë 21.11.2022, me zhvillues A.Q., në Progonat, Tepelenë, pas miratimit të lejes së ndërtimit, nuk është zhvilluar njoftim fillim punimesh dhe është vënë në përdorim pa u pajisur me çertifikatë përdorimi. Gjithashtu, realizimi i çatisë dhe shfrytëzimi i saj duke u rritur në lartësi, nuk përkon me projektin e ndërtimit të miratuar.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 50, neni 52, pika g, “Përdorimi i objektit pa lëshimin e çertifikatës së përdorimit”, VKM 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/2, “Mbikëqyrja e punimeve”.

Ndikimi/Efekti: Përdorimi i objektit pa u pajisur me çertifikatë përdorimi, ndikon në verifikimin e përputhshmërisë së objektit me lejen e ndërtimit të miratuar, mungesën e akteve të kontrollit të objektit gjatë punimeve të ndërtimit, duke ndikuar konformitetin e realizimit të punimeve, në sigurinë dhe në qëndrueshmërinë e objektit.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Pas miratimit të lejes së ndërtimit DPZHT Tepelenë të marrë masa për të zhvilluar mbikëqyrjen e punimeve dhe verifikime në terren të ndërtimit të objektit, për të verifikuar mbajtjen e akteve të kontrollit dhe të mos lejojë përdorimin e objekti pa u pajisur me çertifikatë përdorimi.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me miratimin e deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve, pas miratimit të lejes së lejes se zhvillimit.

Titulli i gjetjes: Mungesa e çertifikatës së përdorimit pas miratimit të lejes së ndërtimit.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se për objektin “Shtëpia druri, kotec dhe ambiente për turizëm rural”, për të cilën është marrë vendimi për leje zhvillimi nr. LZH260422, datë

10.06.2022 dhe vendimi për deklaratën paraprake nr. DP011222, datë 02.12.2022, me zhvillues A.R., në fshatin Rexhinë, Tepelenë, pas miratimit të lejes së ndërtimit, nuk ka zhvilluar njoftim fillim punimesh dhe është në përdorim pa u pajisur me çertifikatë përdorimi dhe deklarata paraprake e kryerjes së punimeve është bërë pas miratimit të lejes së zhvillimit. Duke qenë që zhvillimi i zonës ka të miratuar lejen e zhvillimit dhe nuk zhvillohen objekte të cilat mund të realizohen me deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve, duhet të vijohej në miratimin e lejes së ndërtimit.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, , “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 39, “Lejet e ndërtimit”, VKM 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 11, “Lejet e ndërtimit” dhe neni 7, “Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh”.

Ndikimi/Efekti: Miratimi i deklaratës paraprake për kryerje punimesh, ndikon në realizimin e punimeve të ndërtimit pa u pajisur me leje ndërtimi, pa paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe pa marrë miratimet e nevojshme për një leje ndërtimi, që jep konformitetin për zhvillimin e objekteve në përputhje me kriteret dhe kondiconet urbane, sipas legjislacionit në fuqi.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Pas miratimit të lejes së zhvillimit DPZHT Tepelenë të marrë masa për të vijuar me ndjekjen e fazave të tjera për aplikimin e lejes së ndërtimit dhe të mos miratojë deklarata paraprake për kryerjen e punimeve për objekte të cilat nuk përfshihen në këtë kategori aplikimi.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata, në lidhje me mosllogaritjen në mënyrën e duhur e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

Titulli i gjetjes: Mosllogaritja në mënyrën e duhur e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se për objektin “Strukturë akomoduese në funksion të turizmit”, për të cilën është marrë vendimi nr. LNM 311221, datë 14.02.2022, me zhvillues “E.Z.” ShPK, në qendër të qytetit, Tepelenë, përlllogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është bërë në mënyrën e duhur.

Në bazë të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, neni 27, taksë e ndikimit në infrastrukturë, llogaritet në bazë të çmimit për metër katror, duke ju referuar kostos së ndërtimit (jo çmimit të shitjes) meqenëse objekti nuk është ndërtuar për qëllim shitjeje.

Llogaritja sipas EKB me vlerë 32 614 leke/m², është: 5334 m² x 32 614 leke/m² x 2% =3,479,261 lekë.

Llogaritja sipas vlerës së preventivit është: 126,141,551 lekë x 2% = 2,522,831 lekë.

Llogaritja e vlerës sipas bashkisë është 3,290,950 lekë, me një diferencë prej 188,311 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, Ligji nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 46, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”.

Ndikimi/Efekti: Diferenca e konstatuar e vlerës së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 188,311 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë, si pasojë e përlllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z.T.P., me detyrë Kryetari i Bashkisë Tepelenë; z. L.B., me detyrë Drejtor i DPKZHT, nga periudha 01.11.2016 e në vijim; z. G.Sh., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Rural (DZHR), nga periudha 06.04.2016 e në vijim; z. M.Sh., me detyrë Specialist Pyje Kullota Mbrojtje tokash, Ujitje Kullimit DZHR, nga periudha 10.07.2019 e në vijim; znj. Xh.P., me detyrë Specialiste Pyjesh, nga periudha 11.03.2019 e në vijim; znj. B.Xh., me detyrë specialiste Mjedisi DZHT, nga periudha 17.04.2017 e në vijim; znj. Zh.M., me detyrë specialiste e jashtme, nga periudha 03.08.2020 e në vijim; znj. J.K., me detyrë Nënkryetare Bashkie/ Drejtoresë e Drejtorisë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative (DLSHO), nga periudha 13.12.2004 e në vijim.

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e administruar në KLSH me Nr.422/5 Prot., datë 18.08.2023 dhe me shkresën Nr. 1681, datë 16.08.2023, është observuar nga Kryetari i Bashkisë Tepelenë, z. T.P. dhe nga Drejtori i DPKZHT-së, z. L.B., si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjen e konstatuar për lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: “Strukturë akomoduese në funksion të turizmit”, për të cilën është marrë vendimi nr.LNM 311221, datë 14.02.2022, me zhvillues “E.Z.” ShPK, në qendër të qytetit, Tepelenë, përfaqësuesit e bashkisë shprehen se për këtë objekt nuk është kryer asnjë aplikim i ri për lejenë vitin 2022. Në vijim shprehen se: “Nuk është e nevojshme që të merret leje zhvillimi në një objekt ekzistues me leje ndërtimi të miratuar, në të cilën po vijonte kryerja e punimeve në referencë të lejes së miratuar. Meqenëse investitori u dëmtua për shkak se në planin e biznesit të tij si dhe shpenzimet e kryera për rikonstruksion ikën dëm, duhet që ne si Bashki ta dëmtonim edhe me shumë duke e penguar me kondicione në mënyrë që ai të largohej dhe ta linte objektin gërmadhë. Objekti ishte ekzistues dhe si i tillë do të zhvillohet pa më të voglin diskutim, sepse qëllimi i Bashkisë nuk është të bëhet pengese e investimeve të cilit do qoftë. Ka qenë vete Bashkia Tepelenë e cila ka këmbëngulur duke tërhequr investitorë që të kryejnë zhvillime në Bashki dhe është detyra jonë që të këtë zero artificia bllokuese. Sqarojmë se DPKZHT nuk është organ inspektimi dhe përgjegjëse për mos zbatimin të Lejes së Ndërtimit. Në një kantier punimi për të cilin është dorëzuar sheshi dhe është njoftuar dhe miratuar fillimi punimeve, çfarë efekti ka që të ri kryej serish njoftimi në sistem. Nga DPKZHT nuk ka pasur asnjë miratim të ndonjë akt-piketimi apo gjatë fazës së ndërtimit. Në rast se zhvilluesi ka shkelur Lejen, janë organet e inspektimit që e vlerësojnë zbatimin e projektit të miratuar. Nga DPKZHT nuk ka pasur asnjë miratim të ndonjë akt-piketimi apo gjatë fazës së zbatimit të punimeve në objekt. Është detyrim i Bashkisë që të krijojë kushtet për servitutin në pronë të çdo subjekti. Sqarohet se hyrja dhe pozicionimi i aksesit të katit nën tokë është i njëjtë me objektin ekzistues. Përpara shfrytëzimit (pajisjes me Certifikatë Përdorimi) të objektit, prona është e Bashkisë Tepelenë, pra që nuk ka cenime të pronave private dhe aksesit për në pronë/objekt do i jepet detyrimisht sikurse çdo servituti publik. Kjo është mënyra dhe fryma e zhvillimit që kemi zgjedhur për të tërhequr sa më shumë zhvillues dhe investime dhe jo duke keqpërdorur legjislacionin. Llogaritja është bërë 100% e saktë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore. Përderisa ligji e përcakton qartë dhe nuk lë vend për interpretim se për bazë do të merret “çmimi i shitjes” përcaktuar nga EKB.”

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në sistemin e-leje është miratuar leja e ndërtimit për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m², me anë të Vendimit të Kryetarit të Bashkisë me Nr. LNM 311221, Datë 14.02.2022, me objekt “Strukturë akomoduese në funksion të turizmit”, me zhvillues “E.Z.” ShPK, në qendër të qytetit, Tepelenë. Leja e ndërtimit është miratuar pas miratimit të lejes së ndërtimit për rikonstruksion dhe pas prishjes së objektit ekzistues.

Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 11, pika 1/ ç, përcakton se “nevojiten të pajiset me leje ndërtimi punimet që kanë si pasojë prishjen e objekteve, në rast se prishja nuk shoqërohet me ndërtim të ri. Nëse prishja shoqërohet me ndërtim të ri, leja për prishje është pjesë e lejes së ndërtimit dhe shënohet në kushtet e dokumentit të lejes.” Në rastin e mësipërm është miratuar leje rikonstruksioni për objektin ekzistues, me anë të vendimit Nr. EZ-LNSHNE191020, datë 11.11.2020, për objektin “Strukturë akomoduese në funksion të turizmit”. Pas ndryshimit të tipologjisë së lejes së ndërtimit dhe ndryshimit të ndërhyrjeve në objekt, duke prishur objektin ekzistues dhe ndërtimin e një objekti të ri, nevojitet të aplikohet për leje të re ndërtimi, në bazë të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 39, leja e ndërtimit dhe në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 14, pika 1, në kushtet për lëshimin e lejes së ndërtimit përcaktohet se: “Leja e ndërtimit lëshohet në përputhje me përcaktimet e lejes së zhvillimit, dokumenteve të planifikimit, të rregulloreve të zhvillimit e ndërtimit, si dhe dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë ndërtimore në Republikën e Shqipërisë.” Për sa më sipër, përpara miratimit të lejes së ndërtimit, nevojitet të miratohet leja e zhvillimit, në të cilën të përcaktohen parametrat e zhvillimit urban. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 9, pika 1 përcakton se: “Dokumenti i lejes së zhvillimit i paraprin lëshimit të lejes së ndërtimit për ndërtime të reja, nga autoritetet vendore autoritetet e zhvillimit, dhe përmban, në nivel njësie prone apo grup pronash”. Pas miratimit të lejes së ndërtimit për ndërtimin e objektit të ri, nevojitet të zhvillohet njoftim fillim punimesh dhe më pas të vijohet me zbatimin e punimeve në terren. Në bazë të Ligji nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 50 dhe neni 51, vëzhgimi i zhvillimit të territorit dhe në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/1, mbikqyrja e punimeve, nevojiten të mbahen aktet e kontrollit si: a) Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues; b) Piketimi i strukturës; c) Përfundimi i themeleve dhe kuota 0; ç) Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin; Në raport me aksesin në parkimin nëntokësorë, një nga kondicionet për miratimin e lejes së ndërtimit është ekzistenca e infrastrukturës dhe dokumentat që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës, e cila përfshin edhe aksesin në parkimin nëntokësorë, në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 14, pika 2 dhe në bazë të nenit 15, pika 1/b. Në raport me përlllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në bazë të ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, në bazë të Nenit 27, taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 1, përcakton se: “Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri.” Për arsye se sipërfaqja e ndërtimit është më e madhe se ajo e pasqyruar në tabelën e të dhënave të treguesve të zhvillimit, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është llogaritur në bazë të metrave katrorë dhe me vlerën e çmimit të ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave të vitit 2016. Nëse do të merrej si referencë çmimi i shitjes, do të bazohej në vendimin Nr. 168, datë 27.3.2019, për disa ndryshime në Vendimin Nr.132, Datë 7.3.2018, Të Këshillit Të Ministrave, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” dhe jo vlera e çmimit të shitjes të Entit Kombëtar të Banesave. Në observacionet e paraqitura nga ana juaj, nuk paraqiten fakte të reja apo kundërshtime të ndryshme të mbështetura ligjërisht, nga sa janë trajtuar gjatë mbajtjes së aktkonsatimeve dhe projekraportit të auditimit. Nisur nga sa më sipër, pretendimet e paraqitura nuk merren në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjen e konstatuar për lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: “Banesë dy katëshe + një kat podrum në progonat, Tepelenë”, për të cilën është marrë vendimi nr. AQ-LN100622, datë 21.11.2022, me zhvillues A.Q., në Progonat, Tepelenë, përfaqësuesit e bashkisë shprehën se: “Autoriteti Vendor Bashkia Tepelene ka miratuar, nëpërmjet miratimit të planit e vendosjes së objektit përfshirë kondicionet e tij si dhe Lejes së Ndërtimit, projektin teknik vetëm për sipërfaqen 250 m². Në rast të shkeljeve të kondicioneve është zhvilluesi dhe zbatuesi i punimeve që mbajnë përgjegjësi respektimin e kondicioneve të miratuara. Këto foto janë vënë në dispozicion nga IMT Tepelenë nëpërmjet Administratorit të Njësisë Kurvelesh dhe nuk vërtetohet që objekti është në shfrytëzim.”

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në shqyrtimin e lejes së ndërtimit dhe të dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, në projektin e ndërtimit sipërfaqja e ndërtimit është 280 m² dhe duhet të aplikohet në kategorinë e lejeve të ndërtimit me sipërfaqe mbi 250 m².

Në bazë të Ligji nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 50, vëzhgimi i zhvillimit të territorit, në pikën 1 dhe në pikën 2, përcaktohet që: “1.Çdo autoritet i planifikimit, në përputhje me sferën e tij të juridiksionit dhe të përgjegjësive, kryen vëzhgime për zhvillimet në territor, me qëllim studimin dhe vlerësimin e këtyre zhvillimeve, parashikimin e rreziqeve apo të tendencave, parandalimin e zhvillimeve të dëmshme apo për ndërmarrjen e politikave, miratimin e dokumenteve apo të kryerjes së veprimeve të përshtatshme për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit. 2.Autoritetet e planifikimit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimet ndërmjet tyre dhe bashkëveprojnë e shkëmbejnë informacione e të dhëna.”Përsa më sipër, për fillimin e punimeve dhe përdorimin e objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi është përgjegjësi e çdo autoriteti të planifikimit. Në observacionet e dërguara,nuk paraqiten fakte të reja apo kundërshtime të ndryshme të mbështetura ligjërish, nga sa janë trajtuar gjatë mbajtjes së aktkonsatimeve dhe projekraportit të auditimit. Nisur nga sa më sipër, pretendimet e paraqitura nuk merren në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjen e konstatuar në miratimin e lejes së zhvillimit me objekt: “Shtëpiza druri, kotec dhe ambiente për turizëm rural”, për të cilën është marrë vendimi për leje zhvillimi nr. LZH260422, datë 10.06.2022 dhe vendimi për deklaratën paraprake nr. DP011222, datë 02.12.2022, me zhvillues A.R., në fshatin Rexhinë, Tepelenë, përfaqësuesit e bashkisë shprehen se:“Se pari projekti i zhvillimit është miratuar nga Këshilli Bashkiak Tepelenë. Se dyti projekti i zhvillimit dhe zona në fjalë është e parashikuar për zhvillim në përputhje me draftin final të Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë. Së treti, si një projekt zhvillimi i mbështetur financiarisht nga shteti shqiptar nëpërmjet AZHBR, Bashkimit Evropian, të cilët i japin prioritet këtij lloj zhvillimi dhe e kanë shpallur fitues gjatë një konkurrence të niveleve më të mira Shqiptare.Së katërti, nuk mund të gjykojmë dhënien me nën qira përderisa ka një konfirmim të drejtorive përkatëse.Së pesti, deklarata paraprake është lëshuar me kusht vetëm për punime të cilat lejohen të kryhen nëpërmjet saj. Kjo si pasojë që investimi të mos digjej. Njëkohësisht subjekti kishte në proces dhe një aplikim për leje për të cilën për shkak të hakërrimit të sistemeve Shtetërore. Leja është miratuar në heshtje. Në mirëkuptim me zhvilluesin u ri krye aplikimi dhe me pas objekti u pajis me Lejen e Ndërtimit nr. AR-LNM110123, datë 16.01.2023, miratuar me Vendim LNM110123, datë 13.01.2023 (vendim me kusht).”

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në bazë të Vendimit nr. 373, datë 20.6.2018 për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit, pika vi. Afatet e dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit përcaktohet se: c) Deri në 99 vjet, kur: i. destinohen për krijim ullishtash; ii. destinohen për krijim pemëtoresh me drufrutorë, si kulturat arvore dhe specie të tjera, moshë biologjike e të cilave përkon me këtë kohëzgjatje; iii. veprimtaria sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, shoqërohet me investime për përpunimin e prodhimeve të marra nga toka e dhënë me qira. Gjithashtu edhe në kontratën e qirasë (kontrata bazë) të lidhur ndërmjet Bashkisë Tepelenë (Qiradhënësi) dhe personit fizik (Qiramarrësi), me datë 10.12.2021, në bazë të vendimit nr.18, datë 30.09.2021, në të cilën shpallet fitues i procedurës konkurrese të shpallur me ftesë për ofertë nr. 1549/1 prot., datë 30.08.2021, në lidhje me marrjen me qera të pasurisë tokë bujqësore e pandarë për 99 vjet, në planin e biznesit paraqitet qëllimi për kultivimin e pemëve arvore të llojit arë dhe jo për qëllim të zhvillimit të strukturave dhe ndërtimeve në funksion të agroturizmit. Kontrata e dytë e lidhur për dhënien me nënqira nuk përkon me qëllimin dhe kushtet e kontratës bazë. Gjithashtu kontrata e nënqirasë, në bazë të Nenit 2, të kontratës tip për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, në pikën vi përcaktohet që nuk lejohet dhënia me nënqira e tokës bujqësore, objekt i kësaj kontrate. Edhe në kushtet e kontratës përcaktohet se përdorimi i pasurisë duhet të zhvillohet në bazë të kritereve të mëposhtme: i. toka objekt i kësaj kontrate do të përdoret në përputhje me legjislacionin në fuqi për tokën bujqësore dhe vetëm për veprimtari bujqësore dhe blegtorale, që

përcaktohet në planin e biznesit të veprimtarisë, modeli i të cilit miratohet me udhëzim të ministrit. ii. do të ruajë funksionet natyrore që përmbush toka bujqësore si kategori resursi; iii. do të zbatojë një praktikë të mirë bujqësore të përcaktuar në nenin 16, të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar; iv. toka do të shfrytëzohet mbi të drejtën e përcaktuar në nenin 17, të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar. Në raport me miratimin e deklaratës paraprake pas miratimit të lejes së zhvillimit, në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 9, përcaktohet që leja e zhvillimit paraprin lejen e ndërtimit dhe nuk përfshin punime të cilat kryhen me deklaratë paraprake, sipas përcaktimeve të nenit 7, të VKM-së 408. Në observacionet e dërguara nuk paraqiten fakte të reja apo kundërshtime të ndryshme të mbështetura ligjërisht, nga sa janë trajtuar gjatë mbajtjes së aktkonsatimeve dhe projekraportit të auditimit. Nisur nga sa më sipër, pretendimet e paraqitura nuk merren në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjen e konstatuar në miratimin e certifikatës së përdorimit me objekt: “Bujtinë 2 kate + 1 kat nëntokë”, për të cilën është miratuar certifikata e përdorimit me vendimin nr.GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues G.A.” ShPK, në fshatin Dukaj, Tepelenë, përfaqësuesit e bashkisë shprehen se duhet të shqyrtohet vetëm procedura e pajisjes me Certificate përdorimi dhe nuk duhet të shqyrtohet leja e ndërtimit e miratuar përpara miratimit të certifikatës së përdorimit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në bazë të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 42, në pikën 3 përcaktohet që: “Certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes, sipas fazave dhe kritereve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit.” Realizimi i objektit “Bujtinë 2 kate + 1 kat nëntokë” nuk është në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar me Vendim Nr. LN220720, datë 07.10.2020 dhe me kushtet e lejes sipas legjislacionit në fuqi, ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar. Gjithashtu në bazë të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 42, në pikën 4 përcaktohet se: “Në rast se konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera me kërkesat, sipas pikës 3, autoriteti i planifikimit lëshon aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili jep sugjerimet dhe afatin kohor dhe, nëse afati kohor nuk respektohet, sanksionet për sigurimin e përputhshmërisë nga zhvilluesi.” Në observacionet e dërguara nuk paraqiten fakte të reja apo kundërshtime të ndryshme të mbështetura ligjërisht, nga sa janë trajtuar gjatë mbajtjes së aktkonsatimeve dhe projekraportit të auditimit. Nisur nga sa më sipër, pretendimet e paraqitura nuk merren në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjen e konstatuar në miratimin e certifikatës së përdorimit me objekt: “Objekt katër kate, me dy kate nën tokë, me destinacion bar-restorant dhe hoteleri”, për të cilën është miratuar certifikata e përdorimit me vendimin nr.GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues B.I.H., në zonën e ujit të ftohtë, Tepelenë, përfaqësuesit e bashkisë shprehen se duhet të shqyrtohet vetëm procedura e pajisjes me Certificate përdorimi dhe nuk duhet të shqyrtohet leja e ndërtimit e miratuar përpara miratimit të certifikatës së përdorimit. Në lidhje me aksesin në pronë dhe zhvillimin e hapësirave të parkimit jashtë, nga zhvilluesi është aplikuar në sistem për leje, aplikim i cili është refuzuar për mungesë të dokumentacionit. Sqarohet se DPKZHT nuk është organ inspektimi të punimeve të kundërligjshme.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në bazë të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 42, në pikën 3 përcaktohet që: “Certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes, sipas fazave dhe kritereve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit.” Realizimi i objektit : “Objekt katër kate, me dy kate nën tokë, me destinacion bar-restorant

dhe hoteleri” nuk është në përputhje me kushtet e lejes sipas legjislacionit në fuqi, ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar. Në observacionet e dërguara nuk paraqiten fakte të reja apo kundërshtime të ndryshme të mbështetura ligjërisht, nga sa janë trajtuar gjatë mbajtjes së aktkonsatimeve dhe projekraportit të auditimit. Nisur nga sa më sipër, pretendimet e paraqitura nuk merren në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)

2.6.1. *Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.*

2.6.2. *Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të paarkëtuara nga IMTV.*

2.6.3. *Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmerinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.*

➤ Në lidhje me plotësimin e kriterëve arsimore të punonjësve të IMT-së, sipas përcaktimeve të nenin 11 të Ligjit nr. 183/2014 datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit në ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat në lidhje me punonjësit e IVMT-së Tepelenë:

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni sipas strukturës	Lloji i arsimit/dega	Data emërimit në detyrë	Data e largimit nga puna ose ndryshim i pozicionit
1	E.L.	Inspektor	Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerëve	Nr. 36/2 datë 02.05.2018	Vijon ende në process pune
2	G.M.	Kryeinspektor	Diplomë në “Universitetin Politeknik”, në degën e ndërtimit	Urdhër nr. 16, datë 31.01.2022, i komanduar	I emëruar pranë Këshillit të Qarkut, nga data 09.03.2020

Burimi: Grupi i auditimit

Titulli i gjetjes: Mosplotësimi i kriterëve arsimore i punonjësve të IVMT-së.

Situata: Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga drejtoria e burimeve njerëzore të Bashkisë Tepelenë, z. E.L., me pozicion inspektor, ka përfunduar arsimin e lartë ushtarak dhe nuk ka kualifikimin e duhur për pozicionin e punës.

Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për Inspektimin Dhe Mbrojtjen E Territorit Nga Ndërtimet E Kundërligjshme”, i ndryshuar (me Ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014), neni 11, Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit;

Ndikimi/Efekti: Mungesa e formimit profesional të nevojshëm për pozicionin e punës, ndikon në zbatimin e detyrës si inspektor në Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e Bashkisë Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Titulli i gjetjes: Ushtrimi i detyrës si kryeinspektor, pa lidhur kontratën e punës për ushtrimin e detyrës së përcaktuar.

Situata: Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga drejtoria e burimeve njerëzore të Bashkisë Tepelenë, në pozicionin e kryeinspektorit të IVMT-së është komanduar nga Kryetari i Bashkisë, për periudhën 31.01.2022-31.12.2022, z. G.M., i punësuar me kohë të plotë pranë Këshillit të Qarkut, emëruar nga data 09.03.2020 e në vijim. Ushtrimi i detyrës si kryeinspektor nuk është në përputhje me ligjin, pasi nuk është i emëruar si pjesë e strukturës

së punonjësve të IVMT-së Tepelenë dhe nuk mund të ushtrojë detyrën si kryeinspektor duke qenë që është i punësuar në një institucion tjetër me kohë të plotë. Komandimi i tij në pozicionin e kryeinspektorit nuk mbështetet në një bazë ligjore dhe nuk ka lidhur një kontratë pune për të ushtruar detyrën si kryeinspektor.

Kriteri: Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 12, “Kontrata e punës”.

Ndikimi/Efekt: Ushtrimi i detyrës si kryeinspektor, pa lidhur kontratën e punës, ndikon në ushtrimin e detyrës jashtë kompetencave.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e Bashkisë Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për të lidhur kontratat e punës me punonjësit përpara ushtrimit të detyrës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

➤ Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IVMT.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Tepelenë, gjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, ka marrë 3 vendime për “Dënim me gjobë”, për shkeljen e afatit të lejes së ndërtimit dhe të afatit të përfundimit të punimeve, gjoba të cilat janë likujduar nga subjektet dhe janë arkëtuar.

Nr.	Emri i Subjektit	Vendimi	Vlera, lekë	Vjele	Ankimimi	Gjykatë	Përmbarimi
1	GG.A.	Nr. 02, datë 06.04.2022	100,000	Po	Jo	Jo	Jo
2	B.H. Bar-restorant dhe hoteleri	Nr. 03, datë 09.05.2022	400,000	Po	Jo	Jo	Jo
3	L.Sh.	Nr. 04, datë 27.12.2022	100,000	Po	Jo	Jo	Jo

Burimi: Grupi i auditimit

➤ Në raport me vendimet e marra nga IVMT për prishjen e objekteve pa leje dhe ekzekutimin e vendimeve të IVMT-së, janë pasqyruar më poshtë të dhënat e vendosura në dispozicion nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit.

Nr	Emërtimi	Nr i Vendimeve të marra
1	Numri total i vendimeve për prishje objekti të cilat rezultojnë të pa ekzekutuara.	Ska
2	Numri total i vendimeve që janë objekt shqyrtimi gjyqësor.	Ska
3	Numri total i vendimeve për të cilat është marrë masa e sigurimit total te padise.	Ska
4	Arsyet e mos ekzekutimit për vendimet e pa ekzekutuara.	Ska

Burimi: Grupi i auditimit

Titulli i gjetjes: Mungesa e inspektimit dhe kontrollit të vijueshëm në terren nga ana e IVMT-së Tepelenë, në përputhje me ushtrimin e detyrave funksionale të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

Situata: Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga IVMT-ja Tepelenë, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, nuk janë marrë vendime për prishje të ndërtimeve të cilat nuk janë pajisur me leje ndërtimi. Inspektorati i Ndërtimit të Territorit në Bashkinë Tepelenë nuk ka plotësuar detyrat funksionale, në mospërputhje me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5, “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, neni 12, “Ushtrimi i kontrollit” dhe Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, “Inspektimi”.

Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5, “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, neni 12, “Ushtrimi i kontrollit” dhe Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, “Inspektimi”.

Ndikimi/Efekt: Mungesa e inspektimeve për zhvillimin e territorit ndikon në zhvillimin informal të ndërtimeve, pa u pajisur me leje ndërtimi.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e IVMT Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga IVMT të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren për të konstatuar zhvillimet informale dhe ato që nuk janë në përputhje me lejet e ndërtimit të miratuara, duke marrë vendime për prishje dhe duke i ekzekutuar ato, në bazë të legjislacionit në fuqi.

➤ **Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IVMT** lidhur me zbatimin në terren të kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë etj, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Nga verifikimi në terren i realizimit të ndërtimeve dhe zhvillimit të territorit, u konstatua 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me zhvillimin e ndërtimit pa bërë njoftim fillim punimesh dhe pa u pajisur me çertifikatë përdorimi.

Titulli i Gjetjes: Zhvillimi i ndërtimit pa deklaruar njoftim fillim punimesh dhe pa u pajisur me çertifikatë përdorimi.

Situata: Nga verifikimi në terren i realizimit të ndërtimeve dhe zhvillimit të territorit, u evidentua se objekti i pajisur me leje ndërtimi me zhvillues z. A.Q., është ndërtuar pa deklaruar njoftim për fillim punimesh dhe është vënë në përdorim pa u pajisur me çertifikatë përdorimi, në mospërputhje me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, “Inspektimi”, neni 52, pika f, “Përdorimi i objektit pa lëshimin e çertifikatës së përdorimit”, Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5, “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, neni 12, “Ushtrimi i kontrollit”.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, “Inspektimi”, neni 52, pika f, “Përdorimi i objektit pa lëshimin e çertifikatës së përdorimit”, Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5, “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, neni 12, “Ushtrimi i kontrollit”.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e deklarimit të njoftim fillim punimesh ndikon në mosmbajtjen e akteve të kontrollit të nevojshme deri në përfundim të punimeve, të cilat japin konformitetin e realizimit të objektit në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar. Përdorimi i objektit pa u pajisur me çertifikatë përdorimi ndikon në mungesën e konformitetin të ndërtimit me lejen e ndërtimit të miratuar, në mungesën e certifikimit, sigurisë dhe qëndrueshmërisë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e IVMT Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime: Nga IVMT Tepelenë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të verifikojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe moslejimin e përdorimit të objektit pa u pajisur me çertifikatë përdorimi.

Nga verifikimi në terren i realizimit të ndërtimeve dhe zhvillimit të territorit, u konstatuan 4 praktika tek e cila pasqyrohej e njëjta situatë në lidhje me zhvillimin e ndërtimeve pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh.

Titulli i Gjetjes: Zhvillimi i ndërtimeve pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh.

Situata: Në bazë të verifikimeve për realizimin në terren të zhvillimit të territorit, u konstatuan 4 objekte të cilat janë ndërtuar pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh, si më më poshtë:

1. Pranë Urës së Bëncës në pronë shtet, u konstatua ndërtimi i një objekti me konstruksion metalik dhe bazament me blloqe betoni, ndërtim i cili nuk është pajisur me leje ndërtimi dhe as me deklaratë paraprake.

2. Nga verifikimi në terren dhe nga foto ajrore, u konstatua një shtëpi banimi dhe rrethimi perimetral ndërtuar në pronën e z. A.S., në fshatin Nivicë të Tepelenës, pa u pajisur me leje ndërtimi dhe certifikatë përdorimi.

3. Nga verifikimi në terren dhe nga foto ajrore, u konstatuan punime ndërtimi, në disa objekte dhe infrastrukturë të zhvilluara në fshatin Dragot, pranë urës së Dragotit, në pronë shtet, të cilat nuk janë pajisur me leje ndërtimi.

4. Nga verifikimi në terren dhe nga foto ajrore, u konstatua një shtëpi banimi e ndërtuar në pronë private nga z. J.Sh., në fshatin Hormovë, pa u pajisur me leje ndërtimi. Në bazë të informacionit që është vendosur në dispozicion, objekti është në proces legalizimi.

Sa më sipër, është në mospërputhje me Ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 51, "Inspektimi", Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar, neni 5, "Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës", neni 12, "Ushtrimi i kontrollit".

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 51, "Inspektimi", Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar, neni 5, "Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës", neni 12, "Ushtrimi i kontrollit".

Ndikimi/Efekti: Ndërtimi i objekteve pa u pajisur me leje ndërtimi, ndikon në mosrespektimin e kondicioneve urbane, në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si dhe në respektimin e distancave.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e IVMT Tepelenë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga IVMT Tepelenë të merren masa për të zhvilluar kontrole të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi.

Për sa më lart, mbajnë përgjegjësi: z.T.P., me detyrë Kryetari i Bashkisë Tepelenë; z. E.L., me pozicion Inspektor i IVMT Tepelenë, nga periudha 02.05.2018 e në vijim; z.G.M., me pozicion Kryeinspektor i IVMT Tepelenë, i komanduar nga periudha 31.01.2022-31.12.2022, sipas rasteve specifike.

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën Nr.988/13/1, datë 05.07.2023, është observuar nga inspektori i IVMT Tepelenë, z. E.L., si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjen e konstatuar për kualifikimin profesional të inspektorëve dhe kryeinspektorëve, përfaqësuesit e IVMT-së shprehen se: "Neni 11 te Ligjit nr. 183/2014, date 24.12.2014 nuk ka lidhje me arsimimin por me ndryshimin e Neni 9 te Ligjin nr. 9780, date 16.7.2007, ku citohet se: Neni 9 ndryshohet si me poshte: "Neni 9 Pergjegjesite e Inspektoratit Kombetar te Mbrojtjes se Territorit". Ne Akt Konstatimi, Inspektori i Mbrojtje se Territorit eshte ngaterruar me Inspektorin e mbrojtje se tokës. z. G.M. me profesion inxhinier ndertimi dhe qe eshte punesuar me kohe te pjesshme (vetem per rastet e vleresimit dhe vendosjes se gjobave), Pergjate vitit 2022 ka qene i punesuar me kohe te plote ne Zyren e Administrimit dhe Mbrojtjes se Tokes (ZAMT) Tepelene dhe jo Inspektor i Mbrojtjes se Territorit pranë Keshillit te Qarkut. Ne fagen 3, pika 4 e aktit, mbeshtetet tek Neni 10 "Detyrat e Inspektoratit Ndertimor e Urbanistik Kombetar", nderkohe qe ky Nen eshte shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, date 24.12.2014.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se baza ligjore është sipas përcaktimit të nenin 11, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për Inspektimin Dhe Mbrojtjen E Territorit Nga Ndërtimet E Kundërligjshme”, i ndryshuar me Ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014. Në observacionin e dërguar nuk paraqiten fakte të reja apo kundërshtime të ndryshme të mbështetura ligjërisht, nga sa janë trajtuar gjatë mbajtjes së aktkonsatimeve dhe projekraportit të auditimit. Nisur nga sa më sipër, pretendimet e paraqitura nuk merren në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara në bazë të verifikimeve për realizimin në terren të zhvillimit të territorit, përfaqësuesit e IVMT-së shprehën se: “Në lidhje me inspektimin e territorit nga ndërtimet e kunderligjshme, IMT Tepelene nuk është e vetmja strukture për monitorimin/kontrollin e tyre por është edhe IKMT si dhe me ndryshimet e legjislacionit, kjo pergjegjesi është edhe e Policisë së Shtetit.

Per rastin 1, faqe 3 "Konstruktion metalik me blloqe betoni" me vendndodhje ne prane ures se Bences, sqarojme se kjo zone është përcaktuar në PPV zone zhvillimi dhe të gjithë objektet (përveç thertores) do të prishen. Gjithsesi rasti do të verifikohet nga ana jone dhe do të merren masat përkatëse sic parashikohen ne legjislacion.

Per rastin 2, faqe 4 "Shtëpi banimi dhe rrethim perimetral" me vendndodhje fshatin Nivice, sqarojme se pari, ne kete vendndodhje ka pasur objekt ekzistues. Së dyti per personin A. S. nuk ka dokumente zyrtare qe është prone e tij. Kete person e kemi identifikuar ne nepermjet informacioneve jo zyrtare, por to njerezve sporadike to zones. Gjate bashkepunimit është informuar se nga informacionet e marra verbalisht nga ASHK Tepelene rezulton se ky objekt është ne proces legalizimi.

Per rastin 3, faqe 4 "objekt 3kat" me vendndodhje fshati Progonat, sqarojme se ne reference to citimit në (faqe 3) se "objektet Jane ne perdorim", mendojme se nuk ka asnje prove qe objekti to jete ne perdorim. Rasti do to verifikohet nga ana jone dhe do to merren masat përkatëse sic parashikohen ne legjislacion.

Per rastin 4, faqe 4 "Disa objekte dhe infrastruktura" me vendndodhje fshati Dragot prane ures se Dragotit, sqarojme se keto objekte jane kasolle per bageti me llamarina, ndersa infrastruktura ka qene ekzistuese para se to filloja pune ne IMT Tepelene. Gjithsesi, rasti do to verifikohet nga ana jone dhe do to merren masat përkatëse sic parashikohen ne legjislacion.

Per rastin 5, faqe 5 "Shtëpi banimi" me vendndodhje fshati Hormove, sqarojme se "ky objekt është ne proces legalizimi". Nga ana jone dhe do to merret masa menjehere ne rast to skualifikimit nga ky proces.

Theksojme se nga ana jone bashkepunimi me audituesen kane qene të shkelqyera dhe ne jemi vene ne dispozicion per to gjitha kerkesat e saj, pra duke is paraqitur to gjitha informacionet dhe fotografite e kerkuara.”

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në zbatim të nenit 15, të Ligjit Nr. 9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar me Ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014, përcaktohet se: "Veprimet ose mosveprimet e krye-inspektorëve/inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore dhe të inspektorëve të IKMT-së, që janë në kundërshtim me parashikimet e dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, të prodhimit dhe hedhjes në treg të produkteve të ndërtimit dhe kontrollit e disiplinimeve të punimeve në ndërtim, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale ose jo, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë." Në observacionet e dërguara nuk paraqiten fakte të reja apo kundërshtime të ndryshme të mbështetura ligjërisht, nga sa janë trajtuar gjatë mbajtjes së aktkonsatimeve dhe projekraportit të auditimit. Nisur nga sa më sipër, pretendimet e paraqitura nuk merren në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Përsa më sipër, pretendimet nuk merren në konsideratë.

2.7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

2.7.1. Hartimi i programit (Plan veprimi) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Tepelenë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 135, datë 29.07.2022 dhe dërguar në Bashkinë Tepelenë me shkresën nr. 261/11, datë 01.08.2022, protokolluar në Bashkinë Tepelenë me nr. 484 prot., datë 03.08.2022, u konstatua se nga Bashkia Tepelenë është raportuar në KLSH me shkresën nr. 484/22 prot., datë 09.08.2022 “Kthim-përgjigje për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit” (brenda afatit 20 ditë).

Raportimi është në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit”, germa “j”

Zbatuar në afat

2.7.2. Realizimi i programit (Plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.

Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit”, pika “2”, Bashkia Tepelenë ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 484/24 prot., datë 22.12.2022, duke respektuar afatin 6 mujor nga marrja e shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Zbatuar në afat

2.7.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Titulli i gjetjes: Bashkia Tepelenë nuk ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Situata: Në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronjat “a” dhe “b”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pazbatuara, për të cilat Bashkia Tepelenë ka detyrim zbatimin e tyre.

Nga KLSH janë lënë gjithsej 24 rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht dhe ecuria e zbatimit të tyre është si më poshtë:

e. 16 “Masa Organizative”, nga të cilat 7 masa janë në proces zbatimi, 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 8 masa janë pa zbatuar;

f. 2 “Masa për shpërblim dëmi”, në vlerën 438,362 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht dhe janë zbatuar.

g. 6 “Masa për eliminimin e efekteve negative të shkaktuara në administrimin e fondeve publike në përputhje me parimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit”, në vlerën 6,171,030 lekë, nga të cilat 1 masa është zbatuar pjesërisht, për vlerën 580,000 dhe 5 masa janë pa zbatuar;

h. Masa disiplinore, të cilat janë lënë në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë, i cili ka nxjerrë urdhërin nr. 43 prot., datë 02.03.2023 “Për ngritje të Komisionit të disiplinës”. Nga auditimi rezulton se nuk ka marë asnjë masë tjetër sipas parashikimeve të rekomandimit.

i. Për punonjësit e atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të cilët vlerësohen për masa disiplinore, është lënë detyrë njoftimi i Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Për shkak të mosmarrjes së masave, këto institucione nuk janë njoftuar.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi, Kryetari i Bashkisë z. T.P. dhe Drejtori i Financës, z. S.K..

Statuasi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Tepelenë:

Masat	Rekomanduar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pazbatuar	Vlera e arkëtuar
Masa organizative	16	-	1	7	8	-
Masa për shpërbllim dëmi	2	2	-	-	-	438,362
Masa për eliminimin e efekteve negative	6	-	1	-	5	580,000
Totali	24	2	2	7	13	
Totali në %	100%	8.3 %	8.3%	29.1 %	54 %	15.4 %

Burimi: Grupi i auditimit

Trajtuar gjerësisht në Akt Verifikimin nr. 1, datë 27.06.2023

Kriteri: Ligji nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma j, neni 30, pika 2; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Shkresa nr. 484/24 prot., datë 22.12.2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Tepelenë”;

Ndikimi/Efekti: Moszbatimi i Rekomandimeve, ndikon në uljen e efektivitetit të shërbimeve institucionale dhe pengon për përmirësimin e tyre në dobi të komunitetit, në mospërdorimin me efikasitet të fondeve të saj si dhe në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Tepelenë.

Shkaku: Mosndjekja e gjitha procedurave nga ana e njëjësive përgjegjëse të Bashkisë Tepelenë, për të mundur zbatimin e rekomandimeve të lëna në përgjithësi dhe ato me efekte financiare në lidhje me parimin e “Efikasitetit, Ekonomicitetit dhe Efikasitetit” për vlerën 6,171,030 lekë në veçanti.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Tepelenë, Drejtoria ligjore dhe Drejtoria e menaxhimit financiar të vazhdojë ndjekja me përgjegjësi e procedurave ligjore, për eliminimin e efekteve negative të konsideruara në proces zbatimi, me qëllim arkëtimin e vlerës në buxhetin e bashkisë. Për këtë të ndiqen të gjitha rrugët e mundshme ligjore deri në hapjen e proceseve gjyqësore. Për masat organizative dhe të tjera, nga titullari të monitorohet zbatimi i planit të veprimtimit dhe personat përgjegjës për zbatimin e tij.

Nga sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH-së, rikërkon si më poshtë vijon:

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë, duhet të marrë masa të menjëhershme, për koordinimin e punës midis sektorëve, bashkëpunimin me struktura të tjera si QKB, Drejtoria e Tatimeve Gjyrokastër, Zyrat e Gjendjes Civile, DRSHTRR, etj. me qëllim:

1. Kryerjen e rakordimeve me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjyrokastër, (në cilësinë e agjentit tatimor) për numrin e subjekteve që duhet të paguajnë, si dhe të ardhurat që ato kanë realizuar brenda një viti ushtrimor, si dhe kryerjen e rekomandimeve 6-mujore mbi realizimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;

2. Marrjen e të dhënave mbi bizneset në QKB, që në fazën e planifikimit, mbi numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit ushtrimor mbyllën ose regjistruan, dhe bazën e të dhënave për subjektet, të cilët në bazë të aktivitetit dhe xhiros vjetore, do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;

3. Marrjen e masave për evidentimin e resurseve, analizimin dhe planifikimin e të ardhurave nga taksat kombëtare;

4. Marrjen e masave për kryerjen e rakordimeve me Zyrën e Gjendjes Civile nga ana e Sektorit të Tatim Taksave Vendore, për të nxjerrë numrin real të familjeve në Bashkinë Tepelenë, si dhe marrjen e masave për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Përsa i përket pikës 1 të rekomandimit 1.1 është mbajtur koherencë çdo muaj elektronikisht. Është kërkuar bashkëpunim për subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike të peregjistruar në QKB, me shkresën nr. 3059 prot., datë , 20.12.2022 Drejtorisë Rajonale të Tatimeve. Paketa Fiskale nr. 06 prot., datë 31.03.2023, përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë me shkresën nr. 76/1 prot., datë 21.02.2023, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional. Akt-marrëveshje me Shoqërinë Rajonale të Ujësjetllës kanalizime Gjyrokastër si agjent tatimor, nr. 174 prot., datë 23.01.2023. Njoftim për paketën fiskale drejtuar Njësisë Administrative nr. 2246 prot., datë 28.09.2022.

Statusi:

Në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Tepelenë të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **31.886.454 lekë**, dhe të ndjek veprimet e mëposhtme:

-Të vazhdoj më tej procedurat për të dërguar shkresa për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, në Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

-Gjithashtu për të vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve dhe në kallëzim penal sipas kërkesave të nenit 89,90,91 dhe 93, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” Për Procedurat tatimore në R.SH” ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

Afati i zbatimit:

Brenda muajit dhjetor 2022

Nga verifikimi rezultoi se: Janë marrë masat si më poshtë:

Urdhër bllokimi të llogarive bankare “Bankave të nivelit të dytë”, shkresa nr. 3056 prot., datë 20.12.2022, “Urdhër bllokim të veprimeve me mjete transporti të personave fizikë e subjekteve debitorë”, Shkresë Drejtorisë Rajonale të Transportit rrugor nr. 3055 prot., datë 20.12.2022, Njoftim për pagesë të taksave dhe tarifave të konsumatorëve familjarë, drejtuar SHA “UK Tepelenë” nr. 2211/1 prot., datë 28.09.2022, Akt - rakordimi bashkëlidhur.

Statusi:

Në proces zbatimi

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa për të miratuar programe pune për kryerjen e monitorimeve nga njësisia e inspektimit në terren lidhur me zbatimin e termave kontraktor si: mbjelljet e kulturave sipas llojit të përcaktuar në planet e biznesit dhe respektimit të afatit kohorë të mbjelljeve shoqëruar me kontrollin e shlyerjes së detyrimeve financiare për secilën kontratë.

-Bashkia Tepelenë në rastet e dhënies me qira të aseteve të aplikoj në kontratë në mënyrë eksplicite penalitetet e mos respektimit të termave kontraktor nga palët.

-Në rastet e mos respektimit të termave kontraktual, Bashkia Tepelenë të dërgojë njoftim të zgjidhjes së njëanshme të kontratës së qiradhënies së aseteve në pronësi të saj.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Janë marrë masat si më poshtë:

1. Urdhër nr. 42 prot., datë 22.02.2023 “Për kryerje të monitorimeve në terren lidhur me zbatimin e termave kontraktore si mbjellje e kulturave sipas llojit të përcaktuar në plane biznesi dhe respektimin të afateve kohore të mbjelljeve të shoqëruar me kontrollin e detyrimeve financiare për secilin kontratë” 2. Plan veprimi “Vlerësim i plotë dhe i saktë i veprimtarisë në Njësitë Administrative”

Statusi:

Në proces zbatimi

4.1. Rekomandim: Titullari Bashkisë Tepelenë, në cilësinë edhe të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, duhet të marrë masa që në të ardhmen, të nxjerrë urdhëra të specifikuar për Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, me qëllim hartimin e detyrave të projektimit si dhe në rast të mungesave të burimeve njerëzore, duhet të marrë masa për kryerjen e këtij shërbimi nga të tretë, me qëllim vënien e tyre në dispozicion të projektuesve.

Afati i zbatimit:

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga strukturat e bashkisë Tepelenë pas pyetësorit lidhur me zbatimin e rekomandimeve janë përgjigjur lidhur me rekomandimin nr. 4.1 është hartuar rregullorja e brendshme nr. 08., datë 27.01.2023, gjë e cila nuk ka lidhje me atë që përcaktohet në rekomandim. Si rezultat rekomandimi mbetet i pazbatuar pasi nuk disponohet asnjë dokument justifikues lidhur me natyrën e rekomandimit.

Statusi:

Pa zbatuar

5.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë, të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive, si dhe me qëllim shmangien e rasteve të tilla, të marrë masa për hartimin e gjurmës së auditimit/hartës së proceseve, për “Përcaktimin dhe miratimin e procedurave mbi marrjen e oponencave teknike” për objektet që do të ndërtohen në vazhdimësi, ku të përcaktohen qartë, strukturat përgjegjëse, grupet apo specialistët përkatës që do të kryejnë këtë proces, si dhe të përcaktohen qartë periodha kohore mbi kërkesën dhe marrjen e këtij shërbimi, nga të tretët.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e strukturave të Bashkisë Tepelenë nuk është marrë asnjë masë lidhur me zbatimin e rekomandimit 5.1.

Statusi:

Pa zbatuar

6.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues dhe Kryetarit të Grupit të Menaxhimit Strategjik, me qëllim përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit dhe specifikisht 5 komponentëve të tij, të marrë masa për:

Mbledhjen e GMS, të paktën 4 herë në vit, me qëllim identifikimin, monitorimin, rishikimin e risqeve dhe marrjen e masave për minimizimin e tyre, duke hartuar dhe miratuar aktivitetet kontrolli shtesë.

Ngritjen e një grupi pune me qëllim hartimin e gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve, për aktivitetet kryesore të veprimtarisë, ku do të veçonim, identifikimin e subjekteve taksapaguese, përlogaritjen e detyrimeve, monitorimin dhe vjeljen e tyre.

Miratimin e formateve dhe informacionit që struktura të ndryshme të Bashkisë, duhet të përgatisin dhe raportojnë, në lidhje me përmbushjen e objektivave strategjike dhe vjetorë, ku të jetë përcaktuar: lënda, indikatorë të matshëm, afatet, strukturat përgjegjëse, realizuese dhe monitoruese.

Vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet kontrollit drejtues dhe menaxherial, si kontroll parandalues, si dhe nëpërmjet strukturës së Auditit të Brendshëm në Bashki, si kontroll pas faktit.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e strukturave të Bashkisë Tepelenë është përgatitur pyetësori i vetëvlerësimit gjithashtu është dërguar shkresë me nr. 397/1 prot., datë 02.03.2023 njësisë së harmonizimit.

Statusi:

Zbatuar pjesërisht

7.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë dhe Sektori i Auditit të Brendshëm, duhet të marrin masa që në të ardhmen të korrigjojë mangësitë e mësipërme, si dhe të raportojë në mënyrë të saktë dhe transparente, mbi aktivitetin vjetor, në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e strukturave të bashkisë Tepelenë ka filluar procesi lidhur me rekomandimin duke vijuar si më poshtë:

Plani i veprimit të realizimit të rekomandimeve të adresuara në Raportin përfundimtar të vlerësimit. 2 Shkresën për Njësinë e Harmonizimit nr. 329 prot., datë 09.02.2023.

Statusi:

Në proces zbatimi

8.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të kontratave me objekt qiradhënien e aseteve, me qëllim sigurimin e

zbatimit të këtyre kontratave si dhe sigurimin e vjeljes së të ardhurave të programuara nga ky zë i të ardhurave vendore.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Ka dalë urdhëri nr. 42/1 prot., datë 22.02.2023 “Për përmirësimin e kushteve të kontratave me objekt qiradhënie të aseteve”.

Statusi:

Në proces zbatimi

9.1. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues, në Pasqyrat Financiare të vitit 2022, të përfshihet sistemimi në kontabilitet, mbi regjistrimin e pjesëmarrjes, sipas përqindjes së përcaktuar në aktet ligjore, në kapitalin aksionar të “Ujësjellës Kanalizime Tepelenë” SHA, me vlerë kontabël 510,086,359 lekë.

Afati i zbatimit:

Me mbylljen e Pasqyrave financiare të vitit 2022

Nga verifikimi rezultoi se: Rekomandimi nuk është zbatuar shkak krijimi i shoqërisë së re sipas VKB nr. 48, datë 15.06.2022 “Për pjesëmarrje të bashkisë Tepelenë në subjekte me kompetenca të përbashkëta me qëllim kryerje të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe trajtimit të ujërave të ndotura”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë nr. 653/1prot., datë 21.06.2022. (VKM nr. 302, datë 11.05.2022).

Statusi:

Pa zbatuar

10.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë të marrë masa për nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së së Aktiveve Afatgjata Materiale për llogari të Bashkisë Tepelenë.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana drejtorit të menaxhimit financiar janë dërguar listat pranë ASHK për regjistrimin e aktiveve afatgjata.

Statusi:

Në proces zbatimi

11.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që gjatë zbatimit të këtyre kontratave, nëpërmjet mbikëqyrësit të punimeve, të ndjekë me rigorozitet zbatimin e tyre, me qëllim shmangien e problematikave eventuale si në zbatimin e afateve, po ashtu dhe të cilësisë së punimeve.

Afati i zbatimit:

Në vijimësi përgjatë zbatimit të kontratave

Nga verifikimi rezultoi se: Ka dalë urdhëri nr. 176, datë 20.10.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve...” për secilin rekomandim, por nga ana e strukturave të Bashkisë nuk është vënë në dispozicion asnjë dokument tjetër i cili vërteton fillimin e një procedure lidhur me rekomandimin 11.1.

Statusi:

Pa zbatuar

12.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Njësia e Prokurimit dhe Grupet e Punës të ngritura për përcaktimin e specifikimeve teknike, apo kritereve të veçanta për kualifikim, të marrin masa, që të sigurojë përcaktim të kritereve kualifikuese, në përputhje me objektin dhe madhësinë e kontratës, me qëllim mos diskriminimin e operatorëve ekonomikë potencialë në garë dhe rritje të pjesëmarrësve në garë.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Ka dalë urdhëri nr. 176 prot., datë 20.10.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve...” për secilin rekomandim, por nga ana e strukturave të Bashkisë nuk është vënë në dispozicion asnjë dokument tjetër i cili vërteton fillimin e një procedure lidhur me rekomandimin 12.1.

Statusi:

Pa zbatuar

13.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Tepelenë të merren masa për të mos pranuar nga aplikuesit për leje ndërtimi, plan vendosje pa të gjithë elementet e nevojshëm.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Ka dalë urdhëri nr. 176 prot., datë 20.10.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve...” për secilin rekomandim, por nga ana e strukturave të Bashkisë nuk është

vënë në dispozicion asnjë dokument tjetër i cili vërteton fillimin e një procedure lidhur me rekomandimin 13.1.

Statusi:

Pa zbatuar

14.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Tepelenë, të merren masa të menjëhershme për mos lëshimin e lejeve të ndërtimit, pa u pajisur fillimisht me Vërtetim për Riskun dhe për të mos pranuar nga aplikuesit për leje ndërtimi, plan vendosje pa të gjithë elementet e nevojshëm.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Ka dalë urdhëri nr. 176 prot., datë 20.10.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve...” për secilin rekomandim, por nga ana e strukturave të Bashkisë nuk është vënë në dispozicion asnjë dokument tjetër i cili vërteton fillimin e një procedure lidhur me rekomandimin 14.1.

Statusi:

Pa zbatuar

15.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa të menjëhershme për realizimin e kolaudimit për investimin me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonat” dhe “Rikonstruksioni i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmbjan, Bashkia Tepelenë.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e strukturave të Bashkisë Tepelenë me shkresën nr. 903/1prot., datë 03.05.2023 “Monitorimi i problematikës referuar shkresës drejtuar AKU dhe Bashkisë Tepelenë për objektin “Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonat” dhe “Rikonstruksioni i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmbjan, Bashkia Tepelenë”.

Statusi:

Në proces Zbatimi

16.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë në proces zbatimi, si dhe të raportojë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, mbi nivelin e zbatimit të tyre.

Afati i zbatimit:

Brenda 3 muajsh

Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e titullarit nuk është marrë asnjë masë lidhur me rekomandimin 16.1

Statusi:

Pa zbatuar

C. 1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave për arkëtimin e shumës **286,820 lekë** pa TVSH, nga BOE “B.I.” SHPK, “E.C.C.” SHPK dhe “S.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit sipas kontratës nr. 1958/1, datë 18.12.2020, me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonat dhe “Rikonstruksioni i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmbjan, Bashkia Tepelenë”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: 1. Nga strukturat e Bashkisë Tepelenë me shkresën nr. 2029 prot., datë 12.09.2022 “Dërguar njoftim për shpërblim dëmi” 2. Me mandat arkëtimin nr. 021370, datë 22.11.2022 është arkëtuar shuma 286.820 lekë nga E.C..

Statusi:

Zbatuar

2.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave me qëllim arkëtimin e diferencës së vlerës së pa paguar të kontratës me qiramarrësin I. SHPK, në shumën **151, 542 lekë**.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: 1. Nga strukturat e Bashkisë Tepelenë me shkresën nr. 2028 prot., datë 12.09.2022 “Dërgohet njoftim për shpërblim dëmi” 2. Me mandat arkëtimin nr. 20220914, datë 14.09.2022 është arkëtuar shuma 151,542 lekë nga I..

Statusi:

Zbatuar

C.2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tepelenë, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë nga ana e KVO-së, të operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në DT, për përmbushjen e “Kritereve të veçanta për kualifikim”, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të cilat janë në kundërshtim me aktet rregullative të fushës, si dhe me pasojë në përmbushjen me cilësi të kontratës në këto investime, për shkak të mos përmbushjes së kritereve të vendosura në DT.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Ka dalë Urdhëri nr. 176 prot., datë 20.10.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve...” për secilin rekomandim, por nga ana e strukturave të Bashkisë nuk është vënë në dispozicion asnjë dokument tjetër i cili vërteton fillimin e një procedure lidhur me rekomandimin 1.1.

Statusi:

Pa zbatuar

2.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej **3,930,000 lekë**, për 6 subjektet që tregtojnë karburant me pakicë dhe që janë të pa pajisur me autorizim/licencë, për tregtimin e karburanteve kundrejt tarifës së përcaktuar në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Janë marrë masat duke hartuar shkresat si më poshtë:

1. Shkresa nr. 2056 prot., datë 14. 09.2022 “Dërguar njoftim për pagesën e tarifës (autorizim për tregtim të karburanteve) subjekti S.G. me NIPT K04004205V” i cili nuk ka arkëtuar.
2. Shkresa nr. 2057 prot., datë 14. 09.2022 “Dërguar njoftim për pagesën e tarifës (autorizim për tregtim të karburanteve) subjektit K. Sh.p.k me Nipt K29009512N” i cili nuk ka arkëtuar.
3. Shkresa nr. 2059 prot., datë 14. 09.2022 “Dërguar njoftim për pagesën e tarifës (autorizim për tregtim të karburanteve) subjekti O. Sh.p.k me Nipt J63423463P” i cili ka arkëtuar me mandat arkëtimin nr. p220922aepaop14, datë 22.09.2022 , shuma 380,000 lekë, vlerë likuiduar plotësisht.
4. Shkresa nr. 2055 prot., datë 14. 09.2022 “Dërguar njoftim për pagesën e tarifës (autorizim për tregtim të karburanteve) subjektit A., me Nipt K78731511B” i cili ka arkëtuar me mandat arkëtimin nr. p220714agxoop14, datë 14.07.2022 , shuma 200,000 lekë.
5. “Dërguar njoftim për pagesën e tarifës (autorizim për tregtim të karburanteve) subjekti B. Shpk Nipt J63112670P”, i cili nuk ka arkëtuar.
6. Subjekti K. Shpk, Nipt J61813529P është paguar plotësisht.

Statusi:

Zbatuar Pjesërisht

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej **984,000 lekë**, referuar kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues, për subjektet e ndërtimit, të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike, për periudhën 2020-2021 dhe që nuk janë ngarkuar me detyrimet për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 88 datë 28.12.2019 dhe Vendimit nr. 74 datë 28.12.2018 “Për Miratimin e taksave dhe Tarifave Vendore”.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Nga strukturat e Bashkisë Tepelenë nuk disponohet asnjë dokument i cili vërteton fillimin e një procedure lidhur me përcaktimet e rekomandimit 3.1

Statusi:

Pa zbatuar

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Kontrollit Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Policinë Bashkiake, të marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtoria Rajonale Gjirokastrë për vlerën debitore në shumën **587,070 lekë**, në mbështetje të Ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, dhe Vendimin e Këshillit të VKB nr. 26, datë 30.04.2020, me Vendim nr. 88 datë 28.12.2019, për disa ndryshime në VKB nr. 74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”.

Afati i zbatimit:

Brenda muajit dhjetor 2022

Nga verifikimi rezultoi se: Ka dalë urdhëri nr. 176 prot., datë 20.10.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve...” për secilin rekomandim, por nga ana e strukturave të Bashkisë nuk është vënë në dispozicion asnjë dokument tjetër i cili vërteton fillimin e një procedure lidhur me rekomandimin 4.1.

Statusi:

Pa zbatuar

5.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa për zbatimin e të gjitha procedurave me qëllim arkëtimin e detyrimit prej **394,372 lekë**, nga subjektet debitorë, të cilësuar si detyrimeve kontraktore të shfrytëzimit me qira të aseteve të bashkisë.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Ka dalë urdhëri nr. 176 prot., datë 20.10.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve...” për secilin rekomandim, por nga ana e strukturave të Bashkisë nuk është vënë në dispozicion asnjë dokument tjetër i cili vërteton fillimin e një procedure lidhur me rekomandimin 5.1.

Statusi:

Pa zbatuar

6.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë, të nxjerrë përgjegjësitë, mbi përdorimin e fondeve pa efektivitet të shumës 275,588 lekë, si dhe të marrë masa për eliminimin e shkeljeve dhe mangësive, të cilat shkaktojnë me përdorim pa efektivitet të fondeve të bashkisë.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Ka dalë urdhëri nr. 176 prot., datë 20.10.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve...” për secilin rekomandim, por nga ana e strukturave të Bashkisë nuk është vënë në dispozicion asnjë dokument tjetër i cili vërteton fillimin e një procedure lidhur me rekomandimin 4.1.

Statusi:

Pa zbatuar

D. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 59, pika 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, që në vlerësim të shkeljeve, të konsideruara nga ana jonë, sipas pikës 1 shkronja “a” dhe “b” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës të atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara sipas nenit 58, shkronja “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”. Nisur nga fakti që dhënia e masave disiplinore është lënë në kompetencë të titullarit të institucionit, KLSH në auditimin pasardhës ose në auditimin e zbatimit të rekomandimeve (mbas afatit 20-ditësh dhe/ose 6-muaj), do të auditojë zbatimin rigoroz, transparent dhe jo selektiv të këtij procesi.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga strukturat e Bashkisë Tepelenë ka dalë urdhëri me nr. 43prot., datë 02.03.2023 “Për ngritje të Komisionit të disiplinës” Nga auditimi rezulton se nuk ka marrë asnjë masë tjetër sipas parashikimeve të rekomandimit.

Statusi:

Pa zbatuar

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit e atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të cilët vlerësohen për masa disiplinore sa më sipër, Bashkia Tepelenë, Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Tepelenë nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit.

Statusi:

Pa zbatuar

2.8. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit

Në datën 24.05.2023, nga grupi i auditimit të KLSH-së, me shërbim në Bashkinë Tepelenë, është administruar ankesa e z. M.C., dërguar me email në KLSH në datën 11.04.2023, ora 9:19 AM, administruar në KLSH me nr. 347 prot., datë 11.04.2023.

Në ankesë pretendohet moskryerja e pagesës nga Bashkia Tepelenë, konkretisht nga z. S.K., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik/Nëpunës Zbatues, si dhe aludohet për përvetësim të sasisë së pretenduar të vlerës përkatëse monetare.

Nga grupi i auditimit, u shqyrtua dokumentacioni:

- Librat e protokollit për korrespondencën;
- Vendimet e Këshillit Bashkiak;
- Urdhër Shpenzimet;
- Urdhër Pagesat;
- Kontratat e lidhura për financime të ndryshme të Bashkisë Tepelenë.
- Korrespondenca e zhvilluar nga Bashkia Tepelenë me KLSH-në;
- Kërkesa e z. M.C. drejtuar Bashkisë Tepelenë;
- Kontrata e z. M.C. me Kryegjyshatën Botërore Bektashiane;
- Synops, për punën artistike të realizuar/që do të realizohej;
- Preventivi;
- Ankesa e z. M.C. drejtuar KLSH-së;
- Dokumente të tjera të disponueshme në Bashkinë Tepelenë.

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se:

- Me kërkesën datë 03.07.2017, z. M.C. i ka kërkuar Bashkisë Tepelenë financimin e një produksioni televiziv, për personin “B. S.M.”, bashkëlidhur kontratën nr. 299/1 prot., datë 06.06.2017 (nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane) për vlerën 900,000 lekë, synopsis

dhe preventivin përkatës, protokolluar në Bashkinë Tepelenë me nr. 848 prot., datë 05.07.2017;

- Kërkesa është siglur nga Kryetari i Bashkisë Tepelenë, z. T.P. në datën 05.07.2017;
- Kontrata është nënshkruar nga z. M.C. dhe Kryegjyshi i Kryegjyshit Botërore Bektashiane, Baba E.B.;
- Sinopsi mban emrin e z. P.R., z. M.C. dhe nënshkruar nga z. M.C.;
- Preventivi mban emrin e z. S.B., Administrator i filmit dhe z. M.C., Regjisor, i panënshkruar nga asnjë prej të sipërpërmendurve.

Konkluzion:

- Siglimi i Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, z. T.P. në kërkesë, në datën 05.07.2017, është pjesë e procedurës administrative dhe tregon vetëm që ai është njohur me kërkesën dhe nuk e ka deleguar te asnjë nga drejtoritë e varësisë për kompetencë. Pra, titullari nuk ka ngarkuar një person për trajtimin e kërkesës, qoftë për miratimin apo refuzimin e saj dhe për t'i kthyer përgjigje personit të interesuar, brenda afateve të përcaktuara me ligj;
- Bashkia Tepelenë, Këshilli Bashkiak, Kryetari dhe asnjë element i këtij institucioni, nuk ka lidhur asnjëherë, asnjë lloj kontrate, aktmarrëveshje apo akt të ndonjë forme tjetër me z. M.C. apo me persona të tjerë për asnjë lloj dokumentari apo produksioni televiziv të lidhur me Kryegjyshitën Botërore Bektashiane;
- Gjithashtu, nga Bashkia Tepelenë nuk është prokuruar asnjëherë një shërbim/punë apo blerje malli për objektin/projektin/produksionin/dokumentarin në fjalë;
- Nuk ka asnjë përvetësim nga askush të vlerës monetare të pretenduar;
- Në korrespondencën e zhvilluar ndërmjet z. M.C. dhe Bashkisë Tepelenë nuk ka asnjë nga dokumentet e pretenduar në ankesën drejtuar KLSH-së me email;
- Pretendimi i z. M.C. për mbështetjen financiare nuk qëndron, pasi nuk është i bazuar në asnjë fakt të dokumentuar shkresërisht.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm, u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

Mjedisi i kontrollit: Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga auditimi rezulton se GMS nuk ka kryer detyrat si: Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e komisioneve të përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë, në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

Menaxhimi i Riskut: Mungon Urdhëri për përcaktimin e grupit të punës për riskun. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë në arritjen e objektivave dhe pengojnë marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe të vendoset kuadri i përgjithshëm i procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t'u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar.

Aktivitetet e Kontrollit: Bashkia Tepelenë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (*back-up*) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të IT si instalimin e softuerit, programimin e testimit etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të IT të miratuar nga Kryetari, si dhe nuk ka qenë fushë drejtimi auditimi nga AB.

Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme.

Informimi dhe komunikimi: Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë.

Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Nga Bashkia Tepelenë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por mungon dokumentimi i konsultimit publik.

Monitorimi: Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Në Bashkinë Tepelenë aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualin e MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 12-24 të Projektraportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, me atributet e Kryetarit të GMS, si dhe Nëpunësit Autorizues dhe Koordinatorit të Riskut, të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryhen investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryhen procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimesh për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherë të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Të vendoset një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm nuk është e plotë, pasi aktualisht funksionon me një auditues/përgjegjës sektori. Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga NjAB, u konstatua se anekset “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “Vetëvlerësimi periodik” nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve në pikën 7.1.1. të Kapitullit VII të MAB, si dhe mungon komponenti i tretë “Reagimet e subjektit të audituar”. Pyetësori i reagimit ndaj angazhimit nuk i është dërguar zyrtarisht subjekteve të audituara me dërgimin e Raportit Përfundimtar, kështu që pyetësori nuk është kthyer i plotësuar dhe nuk gjendet si pjesë e inventarit të çdo dosjeje.

Në programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë, nuk janë përcaktuar indikatorët e matjes së performancës, gjë që ka pamundësuar hartimin e raporteve specifike të vlerësimit të performancës dhe si rrjedhim adresimin e rekomandimeve për përmirësim, duke munguar raportimi tek Titullari për këtë procedurë.

Në raportet e auditimit duhet të zinte më shumë vend analizimi i secilit komponent të kontrollit të brendshëm për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të qenë më të qarta rekomandimet për të ardhmen dhe të përfshihej opinioni i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm (referuar dosjeve të shqyrtuara). Audituesit e Brendshëm nuk kanë dhënë asnjë opinion mbi funksionimin dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe nuk kanë kryer vlerësimin dhe analizën e riskut për fushat e veprimtarisë së institucionit, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projektraportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim).

Në shumicën e rasteve rekomandimet e dhëna i referohen bazës ligjore, pra “në zbatim të akteve ligjore”, duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem. Për rekomandimet e adresuara nuk ka përcaktuar afatin e zbatimit të tyre dhe nivelin e rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët).

Nuk dokumentohet që NjAB, pas përfundimit të çdo angazhimi të auditimit, të ketë njoftuar zyrtarisht subjektin e audituar për reagimin ndaj projekt rekomandimeve të adresuara, konform

detyrimet të përcaktuar në pikën 4.1.12 të MAB. Në formulimin e gjetjeve ka mangësi, pasi në të shumtën e rasteve situata e përshkruar nuk ka të përcaktuar periudhën e audituar, kujt viti i referohet, si dhe nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i mospërputhshmërisë apo standardet e kontabilitetit për problematikën e konstatuar nga auditimi, në kundërshtim me pikën 2.4.1 “*Auditimi i përputhshmërisë*” dhe 2.4.2. Mbulimi me auditim i aktivitetit të Bashkisë Tepelenë është i pamjaftueshëm vetëm me një punonjës në strukturën e kësaj drejtorie dhe si për pasojë puna e bërë nuk arrin rezultatet e duhura.

Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, të tilla si prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, asetet, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të Ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”.

Sa më sipër, është në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, të MAB të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të MF “*Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik*”, kapitulli IV, pika 4.1.1 “*Planifikimi i një angazhimi auditimi*”, kapitulli VI “*Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese*”, pika 6.1.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 12-24 të Projektraportit të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të merren masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse t’i jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. Nga kryetari i Bashkisë Tepelenë, të merren masa për të plotësuar strukturën e sektorit të auditimit të brendshëm.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2022 u konstatua se:

a. Buxheti për vitin 2022 është realizuar **486,649** mijë lekë nga **512,088** mijë lekë të planifikuara, ose në masën 95%. Në nivel zëri shpenzimesh me realizim më të ulët rezulton zëri 602 “Shpenzime operative” në masën 89%, ndërsa zëri 230-231 “Shpenzime për investime”, pavarësisht se është realizuar si fonde në masën 93% në nivel projektësh nga 19 projekte të planifikuara nuk janë prokuruar, kontraktuar dhe realizuar 4 projekte investimesh.

b. Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën **26,173,384** lekë ose në masën 6.94% të shpenzimeve të planifikuara, të cilat janë ulur krahasuar me fundvitin 2021, që ishin në shumë të konsiderueshme prej **39,180,517** lekë. Detyrimet e krijuara vetëm në vitin 2022 janë në vlerën 1,205,133 lekë. Detyrimet e papaguara rakordojnë me raportimin në MFE të vitit 2022, ndërsa me gjendjen prej 28,229,661 lekë të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të bilancit të vitit 2022 nuk rakordon për shumën 2,056,277 lekë, diferencë që përfaqëson detyrimet ndaj të treteve të krijuara në dhjetor të vitit ushtrimor 2022, që nuk u ka kaluar afati 30 ditor i pagesës.

c. Gjithashtu konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën më të madhe prej 88.7% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar dhe transferta e kushtëzuar e transferta specifike) dhe 11.3% nga të ardhurat e veta, pasi të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifatat vendore janë nivel të ulët në krahasim me të ardhurat që siguron njësia vendore nga burime të tjera.

Sa më sipër, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 43, paragrafi 4, nenet 47, 48, 52; Ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, neni 40, germa h, neni 42;

UMFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 24-40 të Projektraportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Tepelenë, nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe në bashkëpunim me Menaxherët e Programeve, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent të jenë sa më të argumentuara, si dhe të kujdesen për realizimin e projekteve të investimeve të planifikuara. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të palikuiduara të prapambetura dhe të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, u konstatua se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Vlera progresive e detyrimit që subjektet e biznesit dhe familjarët debitorë kanë ndaj Bashkisë Tepelenë për taksat dhe tarifavat vendore në datën 31.12.2021 është 17,431,036 lekë. Vlera e këtij detyrimi e krijuar vetëm gjatë vitit 2022 është 1,733,167 lekë. Në mënyrë progresive gjendja e debitorëve më 31.12.2022 ka vlerën 20,381,313 lekë, e përbërë nga:

- Taksa e Tarifa vendore për Biznesin e Vogël në vlerën 8,836,111 lekë;
- Taksa e Tarifa vendore për Biznesin e Madh në vlerën 10,922,734 lekë;
- Taksa e Tarifa vendore për Institucione Shtetërore në vlerën 622,468 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.3, neni 35, Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106, “Për sistemin e taksave vendore”, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreu XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 89, 90, 91, 93 dhe 94, Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshime, neni 181, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 24-40 të Projektraportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Tepelenë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifavat vendore në fund të vitit 2022, në vlerën 20,381,313 lekë.

Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Tepelenë, për moskalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Tepelenë aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, por nuk është hartuar regjistri i taksapaguesve familjarë. Sektori i Tatimeve nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e

pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve, që janë debitore ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet nuk ngarkohen për taksat dhe tarifatat e tjera vendore të miratuara me VKB, si taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifa e gjelbërimit. Bashkia Tepelenë ka si Agjent Tatimor për arkëtimin e tarifës së pastrimit dhe taksën e ndërtesës ShA Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë, e cila sipas aktrakordimit me Bashkinë Tepelenë për të ardhurat, rezulton se deri në fund të vitit 2022 ka mbetur pa u derdhur Bashkisë vlerën progresive prej 16,397,158 lekë nga vlera e deklaruar e maturimit prej 18,091,147 lekë. Ndërsa vetëm për vitin 2022 nga ShA Ujësjellës Kanalizime Tepelenë janë arkëtuar detyrime për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit në vlerën 4,169,582 lekë, e cila nuk është derdhur për llogari të Bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr. 74, datë 28.12.2018, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tepelenë” i ndryshuar, me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 24-40 të Projektraportit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë nëpërmjet Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe NJA, të marrë masa për krijimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e kategorisë “familjare” me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore, që ju linden familjeve referuar paketës fiskale të Bashkisë Tepelenë. Bashkia Tepelenë, bazuar në kontratën dypalëshe me agjentin tatimor UK Tepelenë SHA, të kërkojë prej këtij të fundit xhirimin e vlerës 16,397,158 lekë, në llogarinë përkatëse në degën e thesarit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se **taksa mbi tokën bujqësore** është realizuar në vlerën 566 mijë lekë nga 721 mijë lekë e planifikuar ose në masën 78%. Për taksën mbi tokën bujqësore nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta për planifikimin e saj mbi baza reale. Në Bashkinë Tepelenë, familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore si dhe Sektori i Tatimeve nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve, që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqen e tokës bujqësore, që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet edhe kjo taksë. Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore, janë rastet kur qytetarët paraqiten në bashki në mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifatat vendore apo për të marrë shërbime, ku nga Sektori i Taksave dhe Tarifave ju mbahet edhe taksa e tokës me vlerë 1,100 lekë/ha/vit për tokë të kategorisë VII-X.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, Aneksi 1 dhe VKB nr. 74 datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, pika 4/4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 24-40 të Projektraportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë, të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve që ju linden këtyre familjeve, referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Tepelenë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit financiar të pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, rezultoi se në Bashkinë Tepelenë ka detyrime të

papaguara për objekte, të legalizuara që nga viti 2015 deri në 31.12.2021, në vlerën 1,942,139 lekë për 64 objekte. Nga korespondenca zyrtare e Bashkisë Tepelenë me ASHK për periudhën objekt auditimi, rezultoi se për vitin 2022 janë kryer 15 legalizime me vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë të përllogaritur 545,206 lekë, ku janë debitorë 6 individë në vlerën 136,798 lekë, ndërsa deri në 31.12.2022 vlera progresive debitore për këtë taksë është 2,078,937 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, VKB nr. 74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, pika 2/b.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 24-40 të Projektraportit të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Tepelenë të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 70 debitorë në vlerën 10,620,347 lekë, si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Tepelenë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Bashkia Tepelenë për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorimin dhe krijimin e të ardhurave prej tyre, ka lidhur 30 kontrata për dhënie me qira të tyre. Nga të dhënat e nxjerra nga dokumentacioni i dosjeve dhe ai financiar, rezulton se në fund të vitit 2022 paraqiten 16 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në vlerën 3,708,676 lekë të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë. Detyrimi i krjuar i papaguar vetëm për vitin 2022 është 2,874,456 lekë. Gjithashtu, për qiramarrësit debitorë nuk janë përllogaritur dhe nuk janë aplikuar kamatëvonesa prej 0.01% për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës. Nga strukturat e Bashkisë nuk janë kryer veprime të mjaftueshme për evidentimin e problematikave dhe ndërmarrjen e hapave për negociime me qiramarrësit debitorë për pagesat me këste apo marrjen e masave për anulimin e kontratave. Këto veprime janë në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkëtesë, neni 5 “Pagesa e tarifës së qirasë”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 24-40 të Projektraportit të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Tepelenë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës 3,708,676 lekë (principal dhe kamatëvonesa), e cila lind nga mospagesa e kontratave të qirasë për 16 subjekte qiramarrës, referuar kushteve të kontratave.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, rezultoi se Bashkia Tepelenë ka pajisur rast pas rasti me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe ka hartuar akt marrëveshje me to lidhur me pagesën e detyrimit për autorizimin. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Në territorin e

Bashkisë Tepelenë për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitetet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 6 subjekte nga të cilat 4 subjekte konstatohet se kanë detyrime të papaguara në vlerën 2,280,000 lekë, ku në 3 raste nuk kanë paguar në vlerë të plotë detyrimin e përcaktuar në dispozitat ligjore dhe në 1 rast (subjekti B. ShPK) nuk është pajisur me autorizim. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, nenet 4, 15 dhe 20 pikat 2 dhe 11 dhe me VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, Kreu II, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 24-40 të Projektraportit të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin e subjektit B. ShPK dhe të marrë masa që ky subjekt të pajiset menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur prej 1,000,000 lekë ndaj Bashkisë Tepelenë për 5 vjet, që nga data e mbarimit në vitin 2022. Gjithashtu, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë rregullisht pagesat periodike dhe të prapambetura të autorizimeve për të gjithë subjektet: B. Shpk në vlerën 100,000 lekë, O. Shpk në vlerën 380,000 lekë dhe S.G. Shpk në vlerën 800,000 lekë, me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se ka kontrata që kanë përfunduar si punime, por likuidimi është shtrirë në 2-3 vite ushtrimore, për të cilat janë kryer pagesa pjesore sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Nga auditimi i kontabilizimeve të veprimeve ekonomike për kontratat e investimeve me shtrirje kohore likuidimi përtej vitit ushtrimor, rezulton se llogaria 231 “Shpenzime për investime në proces” është debituar dhe kredituar për vlera pjesore të paguara, duke e mbyllur këtë llogari në mënyrë të gabuar pa u kapitalizuar aktivi deri në vlerë të plotë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, pasi në fund të vitit 2022, konstatohet se 11 kontrata investimesh kanë mbetur pa u financuar për vlerën 190,841,000 lekë, ndërsa vlera pjesore prej 245,018,000 lekë e financuar për këto projekte, duhet t’i përkiste gjendjes debitore të llogarisë 231 “Shpenzime për investime në proces”, në datën 31.12.2022.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Aneksi 1, Pika 2, Klasa 2, si dhe Kreu I, pika 8, Kreu II, pika 15/a, b, c, 18/a, b, Kreu III, pika 32.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 40-53 të Projektraportit të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë, të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet t’i evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 111,655,654 lekë, e cila nuk rakordon për vlerën 898,083 lekë me gjendjen e debitorëve në llogaritë e klasës 4 në aktiv të bilancit në vlerën 110,757,571 lekë. Vlera prej 898,083 lekë nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson dhe i ka fillesat

që në konsolidimin e PF të Bashkisë me Ish-Komunat nga Reforma administrative territoriale. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu II, pika 15/b, 59/a, Kreu III, pika 32, Aneksi 1, pika 3.3., “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”, nënpika 8. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 40-53 të Projektraportit të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë, të shqyrtojë veprimet kontabël të kryera në librat e kontabilitetit, për nxjerrjen e shkakut të deviacionit në vlerën 898,083 lekë të veprimeve ekonomike të ndodhura me debitorët në vite dhe më pas të kryhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet në llogaritë e klasës 4, duke i reflektuar përfundimisht në pasqyrat financiare të vitit 2023.

Brenda datës 31.03.2024

12. Gjetje nga auditimi: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se, në 99 raste në vlerën 30,089,049 lekë, janë kryer pagesa të faturave për mallra, punë apo shërbime jashtë afatit 30 ditor nga momenti i mbërritjes së faturës, ku për 92 raste në vlerën 24,718,349 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura mallrash dhe shërbimesh në llogarinë 602 “Shpenzime operative” dhe në 7 raste në vlerën 5,370,700 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për investime në llogarinë 231 “Investime”, të cilat në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mbërritje me vonesë e faturave apo realizim me vonesë i punimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52 dhe Ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 44 “Kontrolli i shpenzimeve”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 40-53 të Projektraportit të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përfshirë kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim moskrijim borxhi për fatura të palikuiduara dhe krijimin e vështirësisë në aftësinë paguese.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se gjatë vitit 2022 janë realizuar gjithsej 72 procedura prokurimi me fond limit 70,669.4 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 63,149 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 7,520.4 mijë lekë ose 10.6%.

Këto procedura prokurimi kanë qenë të llojit: 1 procedurë “e hapur”, 4 procedura “e hapur e thjeshtuar” dhe 68 procedura “blerje e vogël”.

Sipas llojit të aktivitetit, u konstatua se në fushën e ndërtimit (investime), është 1 procedurë me fond limit 13,122 mijë lekë ose 18.6% e kontratave të lidhura dhe kjo me fonde të deleguara nga buxheti i shtetit.

1. Nga auditimi i 5 procedurave të llojit “e hapur” dhe “e hapur e thjeshtuar”, të zhvilluara gjatë vitit 2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar.

2. Nga auditimi i procedurave si më sipër, janë konstatuar në shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, gjithsej në 3 procedura, ku OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DT të miratuara nga AK, në vlerën 23,910,718 lekë pa TVSH, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3 dhe neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 53-73 të Projektraportit të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen e OE fitues të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për realizimin me sukses të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për objektin “*Strukturë akomoduese në funksion të turizmit*”, për të cilin është marrë vendimi nr. LNM 311221, datë 14.02.2022, me zhvillues “E.Z.” ShPK, në qendër të qytetit Tepelenë, u konstatua se:

- Leja e ndërtimit është miratuar pa miratuar më parë një leje zhvillimi për ndërtimin e një objekti të ri dhe në përputhje me parametrat urbanë të lejuar.
- Fillimisht është miratuar një leje rikonstruksioni me Vendimin nr. EZ-LNSHNE191020, datë 11.11.2020 dhe është zhvilluar njoftim për fillim punimesh nr. EZ-NJFP030421, datë 03.04.2021. Pas fillimit të punimeve me anë të një procesverbali janë pezulluar punimet për arsye të qëndrueshmërisë së konstruksionit dhe kostos së rindërtimit. Pas saj, objekti ekzistues është prishur dhe është vijuar me ndërtimin e karabinasë.
- Në planvendosjen e miratuar nuk paraqitet mënyra e aksesit në parkimin nëntokësor dhe mënyra e vetme e aksesimit është duke kaluar nëpërmjet pronave kufizuese, jashtë pronësisë në të cilën zhvillohet.
- Distanca minimale ndërmjet objekteve është 3 metra.

Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për “*Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar, neni 38, “*Leja e zhvillimit*”, neni 39, pika 4, neni 40, pika 1, VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 9, “*Leja e zhvillimit*”, pika 1, neni 14, “*Kushtet për lëshimin e lejes së ndërtimit*”, pika 1, neni 15, pika 1, gërma b, neni 27/1, “*Mbikëqyrja e punimeve*”, pika 1 dhe neni 34, “*Distanca minimale midis ndërtimeve*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 73-83 të Projektraportit të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa që:

- Të mos miratohen leje ndërtimi pa miratuar më parë lejen e zhvillimit dhe përcaktimin e kushteve zhvillimore.
- Lejet e ndërtimit të miratohen përpara fillimit të punimeve të ndërtimit, të zhvillohet njoftimi i fillimit të punimeve dhe të mbahen aktkontrollat për fazat e ndërtimit që vijnë pas njoftimit të fillimit të punimeve, duke verifikuar konformitetin e tyre gjatë ndërtimit.
- Lejet e ndërtimit të mos miratohen pa verifikuar paraprakisht mënyrën e aksesit në objektin që do të zhvillohet, gjurma e objektit të zhvillohet brenda kufirit të pronësisë për të cilën është zhvilluar aplikimi dhe në përputhje me dokumentacionet që vërtetojnë të drejtat pasurore të zhvilluesit.
- Lejet e ndërtimit të miratuara, të jenë në përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara midis ndërtimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për objektin “*Shtëpiza druri, kotec dhe ambiente për turizëm rural*”, për të cilën është marrë vendimi nr. LZH260422 për leje zhvillimi, datë 10.06.2022 dhe vendimi për deklaratën paraprake nr. DP011222, datë 02.12.2022, me zhvillues A.R., në fshatin Rexhinë, Tepelenë, u konstatua se:

- Leja e zhvillimit nuk është në përputhje me kushtet bazë të kontratës së marrë me qera për zhvillimin e parcelës, pasi parcela mbi të cilën është miratuar leja e zhvillimit është pasuri

shtetërore në përdorim të bashkisë, me statusin arë. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar, VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, në kushtet e kontratës tip për dhënien me qera të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, neni 2, pika vi.

- Pas miratimit të lejes së zhvillimit është aplikuar për deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 39, “Lejet e ndërtimit”, VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 11, “Lejet e ndërtimit” dhe neni 7, “Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 73-83 të Projektraportit të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të ruajtur dhe mbrojtur tokën bujqësore nga ndërtimet që nuk janë në përputhshmëri me kushtet e kontratës dhe planin e biznesit të miratuar në dhënien me qera të tokës bujqësore të pandarë.

15.2. Rekomandimi: Pas miratimit të lejes së zhvillimit, DPZHT Tepelenë të marrë masa për të vijuar me ndjekjen e fazave të tjera për aplikimin e lejes së ndërtimit dhe të mos miratojë deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve për objekte të cilat nuk përfshihen në këtë kategori aplikimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për objektet e mëposhtme nuk janë respektuar distancat ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës sipas kriterëve të Rregullores së Zhvillimit të Territorit:

1. “Strukturë akomoduese në funksion të turizmit”, për të cilën është marrë vendimi nr. LNM 311221, datë 14.02.2022, me zhvillues “E.Z.” ShPK, në qendër të qytetit Tepelenë.

2. “Banesë dy katëshe + një kat podrum në Progonat, Tepelenë”, për të cilën është marrë vendimi nr. AQ-LN100622, datë 21.11.2022, me zhvillues A.Q., në Progonat, Tepelenë.

3. “Bujtinë 2 kate + 1 kat nëntokë”, për të cilën është miratuar çertifikata e përdorimit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues “G.A.” ShPK, në fshatin Dukaj, Tepelenë.

4. “Objekt katër kate, me dy kate nën tokë, me destinacion bar-restorant dhe hoteleri”, për të cilën është miratuar çertifikata e përdorimit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues B.I.H., në zonën e Ujit të ftohtë, Tepelenë.

Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 35, “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 73-83 të Projektraportit të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për objektet e mëposhtme në planvendosje dhe në lejen e ndërtimit të miratuar, nuk pasqyrohej saktë numri i kateve dhe lartësia e objektit sipas projektit të ndërtimit:

1. “Banesë dy katëshe + një kat podrum në Progonat, Tepelenë”, për të cilën është marrë vendimi nr. AQ-LN100622, datë 21.11.2022, me zhvillues A.Q., në Progonat, Tepelenë.

2. “Bujtinë 2 kate + 1 kat nëntokë”, për të cilën është miratuar çertifikata e përdorimit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues “G.A.” ShPK, në fshatin Dukaj, Tepelenë.

3. “Objekt katër kate, me dy kate nën tokë, me destinacion bar-restorant dhe hoteleri”, për të cilën është miratuar çertifikata e përdorimit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues B.I.H., në zonën e ujit të ftohtë, Tepelenë.

Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM-në datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 37, “Lartësia e ndërtimeve”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 73-83 të Projektraportit të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje të dhënat e paraqitura në planvendosje, në mënyrë që të jenë në përputhje me projektin e ndërtimit dhe të përcaktohet saktë lartësia dhe numri i kateve të objektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për objektin “Banesë dy katëshe + një kat podrum në Progonat, Tepelenë”, për të cilën është marrë vendimi nr. AQ-LN100622, datë 21.11.2022, me zhvillues A.Q., në Progonat, Tepelenë u konstatua se:

- Leja e ndërtimit është miratuar në kategorinë për objekte deri në 250 m², duke shmangur e thjeshtësuar disa kriteret e tjera të cilat duhet të plotësohen për miratimin e lejes së ndërtimit sipas legjislacionit në fuqi. Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 15, “Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi”.

- Pas miratimit të lejes së ndërtimit dhe nga evidentimi në terren, u evidentua se objekti është ndërtuar pa deklaruar njoftim për fillim punimesh dhe është vënë në përdorim pa u pajisur me çertifikatë përdorimi. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 50, neni 51, “Inspektimi”, neni 52, pika g dhe f, “Përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit”, VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/2, “Mbikëqyrja e punimeve” dhe Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5, “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, neni 12, “Ushtrimi i kontrollit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikat 2.5., faqe 73-83 dhe 2.6., faqe 83-87 të Projektraportit të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Pas miratimit të lejes së ndërtimit DPZHT Tepelenë të marrë masa për të zhvilluar mbikëqyrjen e punimeve dhe verifikime në terren të ndërtimit të objektit, për të verifikuar mbajtjen e akteve të kontrollit dhe të mos lejohet përdorimin e objektit pa u pajisur me çertifikatë përdorimi.

18.2. Rekomandimi: Nga IVMT Tepelenë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të verifikojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe moslejimin e përdorimit të objektit pa u pajisur me çertifikatë përdorimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për objektin “Bujtinë 2 kate + 1 kat nëntokë”, për të cilën është miratuar çertifikata e përdorimit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues “G.A.” ShPK, në fshatin Dukaj, Tepelenë, në bazë të lejes së ndërtimit të miratuar me Vendimin nr. LN220720, datë 07.10.2020 dhe ndryshuar me Vendimin nr. LNP290521, datë 08.06.2021, Leja e parë e ndërtimit është miratuar për realizimin e një objekti me funksionin e bujtinës në lartësinë e dy kateve dhe 1 kati nëntokë. Pas fillimit të punimeve të ndërtimit është aplikuar për ndryshim projekti. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 42, “Çertifikata e përdorimit”, VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për

miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 17, pika e dhe nenet 27 dhe 27/1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 73-83 të Projektraportit të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të mos pajisur me çertifikatë përdorimi dhe miratuar ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit pa verifikuar më parë masën e ndryshimit të sipërfaqeve ndërtimore në projekt dhe duke verifikuar realizimin e zbatimit të punimeve në përputhje me projektin e ndërtimit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për objektin “Objekt katër kate, me dy kate nën tokë, me destinacion bar-restorant dhe hoteleri”, për të cilin çertifikata e përdorimit është miratuar pas realizimit të sistemimit të jashtëm të objektit me vendimin nr. GA-CP011122, datë 07.11.2022, me zhvillues B.I.H., në zonën e Ujit të ftohtë, Tepelenë, në planvendosjen e miratuar në lejen e ndërtimit nuk pasqyrohet mënyra e aksesit në parcelën që është zhvilluar ndërtimi. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 42, “Çertifikata e përdorimit”, Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”, neni 12, VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 27/1, pika 1, gërma dh, “Përfundimi i sistemimit të jashtëm”, neni 14, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 73-83 të Projektraportit të Auditimit).

20.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të mos pajisur me çertifikatë përdorimi dhe miratuar leje ndërtimi pa konfirmuar më parë mënyrën e aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga drejtoria e burimeve njerëzore të Bashkisë Tepelenë, z. E.L., me pozicion inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, ka përfunduar arsimin e lartë ushtarak dhe nuk ka kualifikimin e duhur për pozicionin e punës, jo në përputhje me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar me Ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014, neni 11.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 83-87 të Projektraportit të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Nga Bashkisë Tepelenë të merren masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga drejtoria e burimeve njerëzore të Bashkisë Tepelenë, në pozicionin e kryeinspektorit të IVMT-së është komanduar nga Kryetari i Bashkisë, për periudhën 31.01.2022-31.12.2022, z. G.M. i punësuar me kohë të plotë pranë Këshillit të Qarkut. Ushtrimi i detyrës si kryeinspektor, pa lidhur kontratën e punës për ushtrimin e detyrës së përcaktuar, nuk është në përputhje me Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 12, “Kontrata e punës”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 83-87 të Projektraportit të Auditimit).

22.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për të lidhur kontratat e punës me punonjësit përpara ushtrimit të detyrës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga IVMT-ja Tepelenë, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, nuk janë marrë vendime për prishje të ndërtimeve të cilat nuk janë pajisur me leje ndërtimi. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit

Vendor në Bashkinë Tepelenë nuk ka plotësuar detyrat funksionale, në mospërputhje me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5, “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, neni 12, “Ushtrimi i kontrollit” dhe Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, “Inspektimi”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 83-87 të Projektraportit të Auditimit).

23.1. Rekomandimi: Nga IVMT të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren për të konstatuar ndërtimet informale dhe ato që nuk janë në përputhje me lejet e ndërtimit të miratuara, duke marrë vendime për prishje dhe duke i ekzekutuar ato, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Në bazë të verifikimeve për realizimin në terren të zhvillimit të territorit, u konstatuan 4 objekte të cilat janë ndërtuar pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh. Sa më sipër, është në mospërputhje me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, “Inspektimi”, Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5, “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, neni 12, “Ushtrimi i kontrollit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 104-109 të Projektraportit të Auditimit).

24.1. Rekomandimi: Nga IVMT Tepelenë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronjat “a” dhe “b”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pazbatuara, për të cilat Bashkia Tepelenë ka detyrim zbatimin e tyre.

Nga KLSH janë lënë gjithsej 24 rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht dhe ecuria e zbatimit të tyre është si më poshtë:

j. 16 “Masa Organizative”, nga të cilat 7 masa janë në proces zbatimi, 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 8 masa janë pa zbatuar;

k. 2 “Masa për shpërblim dëmi”, në vlerën 438,362 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht dhe janë zbatuar.

l. 6 “Masa për eliminimin e efekteve negative të shkaktuara në administrimin e fondeve publike në përputhje me parimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit”, në vlerën 6,171,030 lekë, nga të cilat 1 masa është zbatuar pjesërisht, për vlerën 580,000 dhe 5 masa janë pa zbatuar;

m. Masa disiplinore, të cilat janë lënë në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë, i cili ka nxjerrë urdhërin nr. 43 prot., datë 02.03.2023 “Për ngritje të Komisionit të disiplinës”. Nga auditimi rezulton se nuk ka marrë asnjë masë tjetër sipas parashikimeve të rekomandimit.

Për punonjësit e atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të cilët vlerësohen për masa disiplinore, është lënë detyrë njoftimi i Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Për shkak të mosmarrjes së masave, këto institucione nuk janë njoftuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7., faqe 87-96 të Projektraportit të Auditimit).

25.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshejtimin e atyre në proces, si më poshtë:

B. Masa organizative:

4.1. Rekomandim: Titullari Bashkisë Tepelenë, në cilësinë edhe të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, duhet të marrë masa që në të ardhmen, të nxjerrë urdhëra të specifikuar për Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, me qëllim hartimin e detyrave të projektimit si dhe në rast të mungesave të burimeve njerëzore, duhet të marrë masa për kryerjen e këtij shërbimi nga të tretë, me qëllim vënien e tyre në dispozicion të projektuesve.

Në vijimësi

5.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë, të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjëseve, si dhe me qëllim shmangien e rasteve të tilla, të marrë masa për hartimin e gjurmës së auditimit/hartës së proceseve, për “Përcaktimin dhe miratimin e procedurave mbi marrjen e oponencave teknike” për objektet që do të ndërtohen në vazhdimësi, ku të përcaktohen qartë, strukturat përgjegjëse, grupet apo specialistët përkatës që do të kryejnë këtë proces, si dhe të përcaktohen qartë periudha kohore mbi kërkesën dhe marrjen e këtij shërbimi, nga të tretët.

Menjëherë

6.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues dhe Kryetarit të Grupit të Menaxhimit Strategjik, me qëllim përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit dhe specifikisht 5 komponentëve të tij, të marrë masa për:

Mbledhjen e GMS, të paktën 4 herë në vit, me qëllim identifikimin, monitorimin, rishikimin e risqeve dhe marrjen e masave për minimizimin e tyre, duke hartuar dhe miratuar aktivitete kontrolli shtesë.

Ngritjen e një grupi pune me qëllim hartimin e gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve, për aktivitetet kryesore të veprimtarisë, ku do të veçonim, identifikimin e subjekteve taksapaguese, përllogaritjen e detyrimeve, monitorimin dhe vjeljen e tyre.

Miratimin e formateve dhe informacionit që struktura të ndryshme të Bashkisë, duhet të përgatisin dhe raportojnë, në lidhje me përmbushjen e objektivave strategjike dhe vjetorë, ku të jetë përcaktuar: lënda, indikatorë të matshëm, afatet, strukturat përgjegjëse, realizuese dhe monitoruese.

Vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet kontrollit drejtues dhe menaxherial, si kontroll parandalues, si dhe nëpërmjet strukturës së Auditit të Brendshëm në Bashki, si kontroll pas faktit.

Menjëherë

9.1. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues, në Pasqyrat Financiare të vitit 2022, të përfshihet sistemimi në kontabilitet, mbi regjistrimin e pjesëmarrjes, sipas përqindjes së përcaktuar në aktet ligjore, në kapitalin aksionar të “Ujësjellës Kanalizime Tepelenë” SHA, me vlerë kontabël 510,086,359 lekë.

Me mbylljen e Pasqyrave financiare të vitit 2022

11.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që gjatë zbatimit të këtyre kontratave, nëpërmjet mbikëqyrësit të punimeve, të ndjekë me rigorozitet zbatimin e tyre, me qëllim shmangien e problematikave eventuale si në zbatimin e afateve, po ashtu dhe të cilësisë së punimeve.

Në vijimësi përgjatë zbatimit të kontratave

12.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Njësia e Prokurimit dhe Grupet e Punës të ngritura për përcaktimin e specifikimeve teknike, apo kritereve të veçanta për kualifikim, të marrin masa, që të sigurojë përcaktim të kritereve kualifikuese, në përputhje me objektin dhe madhësinë e kontratës, me qëllim mos diskriminimin e operatorëve ekonomikë potencialë në garë dhe rritje të pjesëmarrësve në garë.

Menjëherë

13.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Tepelenë të merren masa për të mos pranuar nga aplikuesit për leje ndërtimi, plan vendosje pa të gjithë elementet e nevojshëm.

Menjëherë

14.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Tepelenë, të merren masa të menjëhershme për mos lëshimin e lejeve të ndërtimit, pa u pajisur fillimisht me Vërtetim për Riskun dhe për të mos pranuar nga aplikuesit për leje ndërtimi, plan vendosje pa të gjithë elementet e nevojshëm.

Menjëherë

16.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë në proces zbatimi, si dhe të raportojë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, mbi nivelin e zbatimit të tyre.

Brenda 3 muajsh

C.2. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike.

1.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tepelenë, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë nga ana e KVO-së, të operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në DT, për përmbushjen e “*Kritereve të veçanta për kualifikim*”, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të cilat janë në kundërshtim me aktet rregullative të fushës, si dhe me pasojë në përmbushjen me cilësi të kontratës në këto investime, për shkak të mos përmbushjes së kritereve të vendosura në DT.

Menjëherë

2.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej **3,930,000 lekë**, për 6 subjektet që tregtojnë karburant me pakicë dhe që janë të pa pajisur me autorizim/licencë, për tregtimin e karburanteve kundrejt tarifës së përcaktuar në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017.

Menjëherë

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej **984,000 lekë**, referuar kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues, për subjektet e ndërtimit, të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike, për periudhën 2020-2021 dhe që nuk janë ngarkuar me detyrimet për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 88 datë 28.12.2019 dhe Vendimit nr. 74 datë 28.12.2018 “*Për Miratimin e taksave dhe Tarifave Vendore*”.

Menjëherë

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Kontrollit Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Policinë Bashkiake, të marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtoria Rajonale Gjirokastrë për vlerën debitorë në shumën **587,070 lekë**, në mbështetje të Ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*” i ndryshuar, neni 23, dhe Vendimin e Këshillit të VKB nr. 26, datë 30.04.2020, me Vendim nr. 88 datë 28.12.2019, për disa ndryshime në VKB nr. 74, datë 28.12.2018 “*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore*”.

Brenda muajit dhjetor 2022

5.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa për zbatimin e të gjitha procedurave me qëllim arkëtimin e detyrimit prej **394,372 lekë**, nga subjektet debitorë, të cilësuar si detyrimeve kontraktore të shfrytëzimit me qira të aseteve të bashkisë.

Menjëherë

6.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë, të nxjerrë përgjegjësitë, mbi përdorimin e fondeve pa efektivitet të shumës 275,588 lekë, si dhe të marrë masa për eliminimin e shkeljeve dhe mangësive, të cilat shkaktojnë me përdorim pa efektivitet të fondeve të bashkisë.

Menjëherë

D. Masa disiplinore

Mbështetur në nenin 59, pika 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, që në vlerësim të shkeljeve, të konsideruara nga ana jonë, sipas pikës 1 shkronja “a” dhe “b” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës të atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara sipas nenit 58, shkronja “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”. Nisur nga fakti që dhënia e masave disiplinore është lënë në kompetencë të titullarit të institucionit, KLSH në auditimin pasardhës ose në auditimin e zbatimit të rekomandimeve (mbas afatit 20-ditësh dhe/ose 6-muaj), do të auditojë zbatimin rigoroz, transparent dhe jo selektiv të këtij procesi.

E. Njoftimi i departamentit të administratës publike dhe Komisionerit të Mbikëqyrjes të Shërbimit Civil

Për punonjësit e atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të cilët vlerësohen për masa disiplinore sa më sipër, Bashkia Tepelenë, Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për objektin “Strukturë akomoduese në funksion të turizmit”, për të cilën është marrë vendimi nr. LNM 311221, datë 14.02.2022, me zhvillues “E.Z.” ShPK, në qendër të qytetit, Tepelenë, metodologjia e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është e saktë, duke sjellë që kjo taksë të llogaritet më pak në vlerën 188,311 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, Ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 46, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 73-83 të Projektraportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 188,311 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë, si pasojë e përlllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

C. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave disiplinore”, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, t’i kërkojë komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet për punonjësit:

1. **Z. L.B.**, me detyrë Drejtor i DPKZHT Tepelenë, nga periudha 01.11.2016 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”.

2. **Znj. J.K.**, me detyrë Nënkyetare Bashkie/Drejtoresë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative (DLSHO), nga periudha 13.12.2004 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar, me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”, si dhe për mangësi në zbatimin e përgjegjësisë të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Vërejtje për punonjësit:

1. **Z. S.K.**, me detyrë Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, për mangësi në zbatimin e përgjegjësisë të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 06.11.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin publik”, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualit të auditimit të brendshëm” i miratuar me urdhërin e ministrit të financave me nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Për mangësi në zbatimin e përgjegjësisë të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016;

2. Z. M.Sh., me pozicion Specialist Pyje Kullota Mbrojtje tokash, Ujitje Kullimit DZHR, nga periudha 10.07.2019 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”;

3. Znj. B.Xh., me pozicion specialiste Mjedisi DZHT, nga periudha 17.04.2017 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 1 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”;

4. Znj. Xh.P., me pozicion Specialiste Pyjesh, nga periudha 11.03.2019 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”.

C. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “Masat Disiplinore” dhe në kontratën individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

Vërejtje për punonjësit:

1. Z. G.Sh., me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Rural (DZHR), nga periudha 06.04.2016 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr.373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”, si dhe për mosmarrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të krijuara nga mospagesa nga 16 subjekteve të tarifave të qirave në vlerën 3,708,676 lekë, duke sjellë të ardhura të munguar për bashkinë, mangësi këto në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, me Ligjin nr.

139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkatëse neni 5 “Pagesa e tarifës së qirasë”;

2. Znj. Zh.M., me pozicion specialiste e jashtme, nga periudha 03.08.2020 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”;

3. Z. E.L., me pozicion Inspektor i IVMT Tepelenë, nga periudha 02.05.2018 e në vijim; për parregullsitë e konstatuara në 5 raste të zhvillimit të ndërtimeve në terren, të ndërtuara pa u pajisur me leje ndërtimi, pa deklaratë për njoftim fillim punimesh pa u pajisur me certifikatë përdorimi, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar me Ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014;

4. Z. K.N., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm, për mangësi në zbatimin e përgjegjësisë të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015 datë 06.11.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin publik”, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualit të auditimit të brendshëm” i miratuar me urdhërin e ministrit të financave me nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Për mangësi në zbatimin e përgjegjësisë të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016;

5. Z. G.G. me detyrë Inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe

6. Z. R.H. me detyrë Inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore,

Për mangësitë e konstatuara:

- Mosplanifikim i të ardhurave mbi bazë reale, duke mos pasqyruar saktë bazën e tatueshme dhe burimin e të ardhurave, proces i cili sjell ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore

- Për mos zbatimin e kërkesave të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 89, 90, 91,93,94 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe VKB nr. 74, datë 28.12.2018, e ndryshuar, për paketën fiskale, duke krijuar gjatë vitit 2022 vlerë debitorë prej 1,733,167 lekë për taksat dhe tarifave vendore, duke mos realizuar mbledhjen e detyrimeve tatimore në vlerën 20,381,313 lekë në fund të vitit 2022.

- Mos mbajtje të regjistrave të plotë, planifikim jo i saktë dhe mos marrje masash për arkëtim të taksës së ndërtesës e truallit dhe tarifave pastrim-ndriçim-gjelbërimit nga taksapaguesit të kategorisë “Familjar” dhe mos identifikimi i plotë i familjeve, që kanë detyrim për këto taksat dhe tarifa, pa llogaritur detyrimin e pa derdhur Bashkisë prej 16,397,158 lekë deri në fund të vitit 2022 për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, mangësi këto në kundërshtim me VKB nr. 74, datë 28.12.2018, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tepelenë” i

ndryshuar, me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me Ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me Ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117.

- Për mosdisponim të dhënash të plota dhe të sakta për planifikimin e taksës bujqësore mbi baza reale, ku familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore, pasi Sektori i Tatimeve nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve, që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore, që familjet zotërojnë në përdorim dhe me AMTP, mangësi këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 pika 1, Aneksi 1 dhe me VKB nr. 74 datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore” i ndryshuar pika 4/4.

- Për mos marrjen e masave për arkëtimin e vlerës debitoare progresive prej 2,078,937 lekë, të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet deri në fund të vitit 2022.

7. Z. H.Z., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, Mbrojtjes së Tokës dhe Ujrave, për mosmarrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të krijuara nga mospagesa nga 16 subjekteve të tarifave të qirave në vlerën 3,708,676 lekë, duke sjellë të ardhura të munguar për bashkinë, mangësi këto në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkatëse neni 5 “Pagesa e tarifës së qirasë”.

D. NJOFTIM PËR DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIN PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Tepelenë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.